

sondazh i opinionit publik

2021

BESIMI NË QEVERISJE



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



Sondazh i opinionit publik

BESIMI në QEVERISJE 2021

Raporti i sondazhit



Institute for Democracy and Mediation
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

With funding from

 Austrian
Development
Cooperation



Sondazh i opinionit publik 2021: Besimi në qeverisje

Raporti i sondazhit

Autorët:

Irma Semini, autore kryesore
Iliada Korçari, bashkautore

Kontribuoi:

Ines Stasa

Koordinatorë të punës në terren:

Dior Angjeli, Sheila Hafizi

Përktheu në shqip:

Durim Tabaku

Dizajn dhe layout:

Eduart Cani

© 2022 nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM)
Adresa: Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1
1017 Tirana, Albania
E-mail: info@idmalbania.org
www.idmalbania.org

Ky raport është përgatitur në kuadër të Projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri” (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, i cili zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribues kryesor, bashkë me UNDP-në. Brendia e raportit është përgjegjësi e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht politikën ose qëndrimin zyrtar të qeverisë shqiptare, UNDP-së, apo ADC-së.

Besimi në qeverisje 2021 përmbledhje

Në vitin e tij të nëntë, “Sondazhi i opinionit publik: Besimi në qeverisje” u realizua nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në nëntor 2021 në të 61 bashkitë e vendit, duke përdorur një kampion përfaqësues kombëtar prej 2,500 personash të zgjedhur në mënyrë rastësore. Pandemia COVID-19 vazhdoi të shkaktojë kufizime të konsiderueshme në të gjitha aspektet e jetës në vend, përfshirë qeverisjen, angazhimin qytetar dhe ofrimin e shërbimeve publike. Perceptimet dhe qëndrimet e publikut për çështjet në fjalë të trajtuara nga ky sondazh, u ndikuan edhe nga kombinimi i një sërë faktorësh si fushata intensive e zgjedhjeve parlamentare të muajit prill 2021, zhvillimet politike të periudhës së pas zgjedhjeve, programi në vazhdim i rindërtimit të zonave të dëmtuara nga tërmeti shkatërrimtar i vitit 2019 dhe dështimi i BE-së për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Gjetjet grupohen në nëntë kapituj kryesorë dhe përmbledhen si më poshtë:



Besimi në institucione

- Organizatat si NATO (73.2%), OKB (71.4%), dhe BE (71.3%) e ruajtën renditjen e tyre si institucionet më të besuara në Shqipëri, pavarësisht një rënieje krahasuar me vitin 2020.
- Qytetarët shqiptarë vazhduan t'i perceptonin institucionet fetare (67%) si institucionet më të besuara në vend, pasuar nga institucionet arsimore (57.1%), forcat e armatosura (54.6%) dhe organizatat e shoqërisë civile (52.6%).
- Presidenti (23.5%), partitë politike (26.4%), gjykatat (27.7%) dhe prokuroria (28.4%) ishin institucionet më pak të besuara në 2021.
- Rreth 35% e të anketuarve besonin se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi dhe 57% besonin se reforma do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Të dy këto shifra patën një rritje me 6 dhe 4 pikë përqindjeje (pp) përkatësisht, krahasuar me 2020.
- Televizioni (54%) mbetet burimi mediatik më popullor, veçanërisht tek njerëzit që jetojnë në zonat rurale (60%), edhe pse mediave sociale (29%) dhe portaleve online (10%) po u rritet popullariteti si burimi kryesor për informimin për të rejat dhe aktualitetin.
- Gjatë vitit 2021, një në katër qytetarë besonte se informacioni që jepej nga mediat në Shqipëri ishte i saktë/vërtetë.



Transparenca dhe llogaridhënia

- Më shumë se gjysma e të anketuarve i konsideronin qeverinë qendrore (57.4%) dhe bashkitë (58.2%) si jo transparente, edhe pse perceptimi për transparencën është rritur krahasuar me 2020, duke shënuar kështu përmirësime për vitin e dytë radhazi.
- Në 2021, shumica e shqiptarëve (62.2%) ishin të ndërgjegjësuar se e drejta për informim garantohej me ligj.
- 37.5% e shqiptarëve e konsideronin qeverinë qendrore si të përgjegjshme dhe 38.6% e konsideronin pushtetin vendor si të tillë; duke shënuar një rritje për të dyja nivelet e qeverisjes, për të dytin vit radhazi.
- Ndërgjegjësimi për mekanizmat që mundësojnë llogaridhënien e qeverisë u rrit për të gjitha institucionet e listuara në 2021. Në përgjithësi, shqiptarët besojnë se organizatat ndërkombëtare (77%) i kërkojnë llogari qeverisë shumë më tepër se sa institucionet vendase.
- Tre institucionet e perceptuara si mekanizmat më efikase për llogaridhënien në vend janë Kontrolli i Lartë i Shtetit (71.1%), ndjekur nga Parlamenti (63.9%) dhe media (61.5%).



Korrupsioni dhe institucionet publike

- 83.1% e shqiptarëve e perceptojnë korrupsionin e nivelit të ulët si të përhapur ose shumë të përhapur, ndërkohë që 83.7% e perceptojnë korrupsionin e madh apo të nivelit të lartë me një përhapje të tillë.
- Pesë institucionet që u renditën si më të korruptuarat në 2021 ishin gjyqësori, ndjekur nga institucionet e kujdesit shëndetësor, administrata publike, institucionet vendore dhe policia.
- 68.4% e qytetarëve nuk kishin besim te ndjekja penale e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, ndërkohë që 59.3% nuk kishin besim në ndjekjen efektive penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët.
- 11% e të anketuarve kishin qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel qeverisjeje qendrore dhe 18.5% në qeverisjen vendore.
- 29.4% e qytetarëve që kishin marrë një shërbim nga qeveria vendore në 2021 (N=1672) raportuan se i kishin paguar ryshfet një zyrtari publik të këtij niveli.
- 34.6% e qytetarëve që kishin marrë një shërbim nga qeveria qendrore në 2021 (N=973), raportuan se i kishin paguar ryshfet një zyrtari publik të këtij niveli.



Ndikimi i interesave politike

- Prokuroria (48.3%) dhe gjykatat (49.1%) konsiderohen si institucionet më shumë të ndikuara politikisht.
- Institucionet fetare (11%) perceptohen si institucionet më pak të ndikuara politikisht.




Pjesëmarrja qytetare

- Interesi i qytetarëve shqiptarë për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes të institucioneve publike vijoi të bjerë në 2021, në 43.5% krahasuar me 49% në 2020 dhe 56.5% në 2019.
- Shumica e qytetarëve shqiptarë (72.2%) raportuan se nuk kanë mjaftueshëm mundësi për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes së institucioneve publike.
- Një përqindje më e madhe e të anketuarve (38.1%) raportuan se kanë pasur mundësi të marrin pjesë në vendimmarrjen vendore në krahasim me atë të qeverisë qendrore (27.8%).
- 16.6% e qytetarëve të anketuar kanë përdorur portalin online www.konsultimipublik.gov.al për t'u informuar, apo për të dhënë mendime për projektligje apo projekt-strategji/ plane veprimi në nivel qendror.
- Shumica e qytetarëve shqiptarë (71.7%) ishin të bindur se qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse vendimet e qeverisë janë të mira apo të këqija.
- Shumica e të anketuarve (63.2%) i konsideronin dëgjесat publike vendore si ngjarje formale, ndërsa 40.3% besonin se institucionet publike i marrin në konsideratë sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile.
- 38.8% e shqiptarëve qenë të mendimit se këshillat bashkiak përfaqësojnë komunitetin dhe 33% mendonin se prioritetet e qytetarëve janë marrë parasysh në buxhetin e njërive të qeverisjes vendore.
- Një numër më i madh qytetarësh (27.1%) morën pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në 2021, krahasuar me 2020 (22%).
- 65.1% e qytetarëve qenë të gatshëm të angazhohen në punë vullnetare. Brezi i ri, studentët dhe të anketuarit e punësuar në sektorin publik ishin më të prirur për të bërë punë vullnetare në të mirë të komunitetit.
- Në 2021, 41% e qytetarëve shqiptarë deshën të largohen drejt një vendi tjetër.



Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike

- Niveli i kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve publike pati përmirësime për pjesën më të madhe të shërbimeve publike bazë dhe administrative që maten nga ky sondazh, krahasuar me vitin 2020.
- Më shumë qytetarë shqiptarë (41.9%) qenë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë, krahasuar me 2020 (38%). Shërbimet e arsimit publik (53.3%), të pastrimit (48.3%) dhe urgjencës mjekësore (46%) u raportuan si të kënaqshme më shpesh se shërbimi i policisë (37.4%), transporti publik (32.6%) dhe shërbimet gjyqësore (27.2%).
- 54% e qytetarëve shqiptarë që patën përdorur një shërbim administrativ në 2021 qenë të kënaqur apo shumë të kënaqur me shërbimin, veçanërisht kur bëhej fjalë për gjendjen civile (72%), sigurimet shoqërore (64%) dhe transportin rrugor (60%).
- Në 2021, 15.1% e të anketuarve bënë një ankesë tek institucioni publik që e ofronte shërbimin publik.
- Në 2021, 16.1% e qytetarëve shqiptarë përdorën platformën online www.shqiperiaqeduam.al për të bërë një ankesë.
- 26.2% e të anketuarve besonin se institucionet i trajtonin siç duhet ankesat e qytetarëve.
- Një përqindje më e madhe e qytetarëve (36.9%) raportuan se patën vizituar një sportel shërbimi të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 (29.4%). Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimit u rrit në 76.9% në vitin 2021, nga 73% që ishte në 2020.
- 71.6% e shqiptarëve të anketuar nuk ndihen të sigurt në jetën e përditshme. Nxitësit kryesorë të ndjenjës së pasigurisë përfshinin kriminalitetin, problemet e shëndetit, padrejtësinë, nivelin e papunësisë dhe fatkeqësitë natyrore.




Fatkeqësitë natyrore

- Më shumë se gjysma e qytetarëve qenë të pakënaqur me nivelin e transparencës së vendimmarrjes së qeverisë qendrore (52.1%) dhe asaj vendore (52.9%) gjatë periudhës së pandemisë COVID-19.
- 47.3% e shqiptarëve qenë të pakënaqur me ofrimin e shërbimeve online si alternativë për marrjen e shërbimeve gjatë pandemisë. Po ashtu, 52.6% qenë të pakënaqur me respektin e treguar nga institucionet për të drejtat dhe liritë e njeriut gjatë po kësaj periudhe.
- Rreth gjysma e popullatës në vend qe e pakënaqur me zbatimin e programeve të rindërtimit pas tërmetit të 2019 nga qeverisja qendrore (49.2%) dhe bashkitë (50.8%).



Përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)

- 59.7% e të anketuarve qenë në dijeni se bashkia e tyre ka një faqe interneti. 40.7% e tyre e kishte përdorur faqen e internetit të bashkisë.
- 89.4% e shqiptarëve qenë në dijeni se administrata shtetërore ofron shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania. 80.1% e tyre kishin marrë shërbime nëpërmjet portalit e-Albania (74% në 2020).
- 92.6% e përdoruesve të shërbimeve elektronike i konsideronin ato si funksionale dhe 90% besonin se portali e-Albania kishte përmirësuar shpejtësinë e shërbimit.



Gjinia dhe përfshirja sociale

- 60.6% e shqiptarëve deklaruan se janë dakord që në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave, me një rritje nga 45% në 2020.
- 74.8% e qytetarëve besonin se burrat dhe gratë kanë akses të barabartë tek shërbimet publike.
- Pjesa më e madhe e qytetarëve (76.6%) besonin se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.
- Shumica e shqiptarëve (81.8%) mendonin se burrat dhe gratë janë njësoj të aftë për të mbajtur çdo post publik.
- 1 në 8 shqiptarë raportoi se qe trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, statusit me aftësi të kufizuar, apo për arsye të tjera, e njëjta përqindje si në vitin 2020.
- 6 në 10 shqiptarë mendonin se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore.

Përmbajtja

1. HYRJE	18
2. METODOLOGJIA	19
2.1 METODOLOGJIA STATISTIKORE DHE PËRSHKRIMI STATISTIKOR I KAMPIONIT	19
2.2 INSTRUMENTI I SONDAZHIT	20
2.3 MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE	21
2.4 ANALIZIMI I TË DHËNAVE	21
2.5 FOKUS GRUPET	21
2.6 KUFIZIMET	21
3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT	22
4. REZULTATET E SONDAZHIT	26
4.1 BESIMI NË INSTITUCIONE	26
4.2 TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA	38
4.3 KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE	49
4.4 NDIKIMI POLITIK	57
4.5 PJESËMARRJA QYTETARE	61
4.6 KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE	75
4.7 FATKEQËSITË NATYRORE	90
4.8 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT	94
4.9 PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE	99
5. SHTOJCA 1: KARAKTERISTIKAT E KAMPIONIT (2013–2021)	107

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe 1 janar 2021 dhe madhësia e kampionit për secilin qark	19
Tabela 2: Grupmoshat	23
Tabela 3: Statusi i punësimit	23
Tabela 4: A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	25
Tabela 5: Besimi në institucione (2015–2021)	29
Tabela 6: Ndarja demografike e besimit ('kam shumë besim' dhe 'kam besim')	35
Tabela 7: Ndarja demografike e reformës në drejtësi	36
Tabela 8: Ndarja demografike e përdorimit të mediave	37
Tabela 9: Perceptimi i efektivitetit të mekanizmave të llogaridhënies (2016–2021)	46
Tabela 10: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien	47
Tabela 11: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale	48
Tabela 12: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2017–2021)	50
Tabela 13: Arsyet e pagimit të ryshfetit 2021	56
Tabela 14: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika (2016–2021)	59
Tabela 15: Ndarja demografike e institucioneve të ndikuara shumë ose jashtëzakonisht shumë 2021	60
Tabela 16: Arsyet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2021	65
Tabela 17: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje 2021	71
Tabela 18: Ndarja demografike e proceseve të konsultimeve në 2021	72
Tabela 19: Ndarja demografike e pohimeve për pjesëmarrjen/angazhimin qytetar në 2021	73
Tabela 20: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative 2021	78
Tabela 21: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike (2016–2021)	80
Tabela 22: Faktorët për ndjenjën e pasigurisë (2016–2021)	87
Tabela 23: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë sipas karakteristikave demografike 2021	88
Tabela 24: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative sipas karakteristikave demografike 2021	89
Tabela 25: Ndarja demografike e kënaqshmërisë me qeverisjen gjatë fatkeqësive natyrore 2021	93
Tabela 26: Arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë 2021	96
Tabela 27: Diskriminimi nga institucioni 2021	104

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Përfaqësimi gjinor	22
Figura 2: Përfaqësimi gjeografik	22
Figura 3: Niveli i arsimit të përfunduar	23
Figura 4: Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto):	24
Figura 5: Besimi në institucione 2021	27
Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi 2021	30
Figura 7: ‘Ndikimi pozitiv’ apo ‘zbatimi me korrektësi’ i reformës në drejtësi, përçindja e atyre që thanë ‘po’ në 2016–2021	31
Figura 8: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin	32
Figura 9: Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatik 2021	33
Figura 10: Saktësia e mediave (2016–2021)	33
Figura 11: Kënaqësia me donatorët e huaj në Shqipëri	34
Figura 12: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore 2021	39
Figura 13: Ndryshimi në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2021	40
Figura 14: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit në 2021	41
Figura 15: Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore në 2021	42
Figura 16: Ndryshimi për perceptimin e llogaridhënies (2016–2021)	43
Figura 17: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale 2021	44
Figura 18: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale 2021	45
Figura 19: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 2021	49
Figura 20: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit 2021	51
Figura 21: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2017–2021)	52
Figura 22: Përvoja personale me korrupsionin 2021	53
Figura 23: Përvoja personale me korrupsionin në nivel qendror e vendor (2015–2021)	54
Figura 24: Shërbimet e marra në nivel qendror 2021	55
Figura 25: Ryshfet i paguar në nivel qendror 2021	55

Figura 26: Shërbimet e marra në nivel vendor 2021	55
Figura 27: Ryshfet i paguar në nivel vendor 2021	55
Figura 28: Përhapja e ryshfetit (2016–2021)	56
Figura 29: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në agjendën e institucioneve 2021	57
Figura 30: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse së institucioneve publike 2021	61
Figura 31: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike 2021	62
Figura 32: Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2016–2021)	63
Figura 33: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016–2021)	64
Figura 34: Pjesëmarrja në takime konsultimi 2021	64
Figura 35: Përdorimi i portalit “konsultimipublik.gov.al” 2021	65
Figura 36: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar 2021	67
Figura 37: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrim i një peticioni në 2021	68
Figura 38: Gatishmëria për t’u angazhuar në punë vullnetare 2021	69
Figura 39: Largimi nga vendbanimi aktual 2021	70
Figura 40: Kënaqshmëria me shërbimet publike bazë 2021	76
Figura 41: Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative 2021	77
Figura 42: Marrja e shërbimeve publike administrative 2021	81
Figura 43: Përqindja e të anketuarve që kishin paraqitur ankesë tek institucionet (2016–2021)	82
Figura 44: A keni bërë ndonjë ankesë tek platforma e bashkëqeverisjes ‘www.shqiperiaqeduam.al’? 2021?	83
Figura 45: Institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve 2016-2021	84
Figura 46: Të anketuarit që kanë vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2021	85
Figura 47: Kënaqshmëria me sportelet e shërbimit ADISA në 2021 (%)	85
Figura 48: Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme (2016–2021)	86
Figura 49: Kënaqshmëria e qytetarëve me trajtimin e krizave dhe qeverisjen gjatë pandemisë COVID-19 2021	90
Figura 50: Kënaqshmëria e qytetarëve me zbatimin nga ana e qeverisë të programit të rindërtimit të pas tërmetit 2021	92

Figura 51: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? 2021	94
Figura 52: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? (2015–2021)	95
Figura 53: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë 2021	95
Figura 54: Dijenia për portalin e-Albania 2021	97
Figura 55: A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania? 2021	97
Figura 56: Cilësia e vlerësimit të shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania 2021	98
Figura 57: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare 2021	100
Figura 58: ‘Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare’ (2016–2021)	100
Figura 59: ‘Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike’ 2021	101
Figura 60: ‘Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike’ (2016–2021)	102
Figura 61: ‘Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave’ 2021	103
Figura 62: ‘Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave’ (2016–2021)	103
Figura 63: ‘Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik’ (2016–2021)	105
Figura 64: ‘Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik’, 2021	105
Figura 65: ‘Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë’ (2016–2021)	106

1. HYRJE

Shqipëria është zyrtarisht kandidate për anëtarësim në Bashkimin Evropian që nga qershori i vitit 2014. Funksionimi i institucioneve demokratike, reforma në administratën publike, shteti ligjor dhe zhvillimi ekonomik jo vetëm që janë në zemër të procesit të anëtarësimit,¹ por ato janë edhe themelore për procesin e demokratizimit të vetë vendit. Perceptimi i publikut për demokracinë dhe cilësinë e qeverisjes në Shqipëri janë tregues të rëndësishëm të zbatimit të duhur të reformave nga institucionet shtetërore, të mbështetjes ndaj rolit që luajnë këta agjentë të ndryshëm në shoqëri dhe progresit drejt anëtarësimit në BE.

Sondazhi i Opinionit ‘Besimi në qeverisje’ është një ushtrim i përvitshëm që përdoret për të matur besimin e qytetarëve tek institucionet publike. Ai është një instrument sasior i krijuar për të shqyrtuar perceptimet dhe qëndrimet e publikut për çështje të tilla si besimi në institucionet publike; transparenca dhe llogaridhënia institucionale; përhapja e korrupsionit në institucionet shtetërore; niveli i angazhimit të qytetarëve në politikëbërje dhe vendimmarrje; kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike; dhe zbatimi i ligjeve dhe politikave jodiskriminuese. Çdo vit sondazhi i opinionit siguron të dhëna që ndihmojnë në përmirësimin e reformave madhore që lidhen me qeverisjen e mirë, antikorrupsionin, reformën në gjyqësor dhe çështjet që ndikojnë tek të gjithë sektorët, siç janë barazia gjinore dhe përfshirja sociale.

Në këtë raport prezantohen gjetjet nga Sondazhi i Opinionit realizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) gjatë periudhës 6-21 nëntor 2021 në të 61 bashkitë e vendit. Ky është viti i nëntë radhazi që realizohet ky sondazh (2013-2021) ku përdoret i njëjti instrument vëzhgimi dhe të njëjtat pyetje bazë. Botimi i vitit 2021 është i dyti që financohet në kuadër të Projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri” (CSDA), një fond i përbashkët donatorësh, i cili zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribues kryesor, bashkë me UNDP-në.

Raporti fillon me një përshkrim të metodologjisë dhe karakteristikave social-demografike të të anketuarve dhe më pas ndiqet nga gjetjet e sondazhit të grupuara në nëntë seksione kryesore: besimi në institucione; transparenca dhe llogaridhënia; korrupsioni dhe institucionet publike; ndikimi i interesave politikë; pjesëmarrja qytetare; kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike; performanca e qeverisë përballë fatkeqësive natyrore; përdorimi i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK); dhe përfshirja gjinore dhe sociale.



1 Institucionet demokratike, reforma në administratën publike, shteti ligjor, zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria konsiderohen si “bazat” e *acquis* nga Komisioni Evropian.

2. METODOLOGJIA

2.1 METODOLOGJIA STATISTIKORE DHE PËRSHKRIMI STATISTIKOR I KAMPIONIT

Për Sondazhin e Opinioneve Publik 'Besimi në qeverisje 2021' u përdor një kampion përfaqësues i popullatës shqiptare në të cilin të anketuarit u përzgjedhën nga të gjitha bashkitë e vendit dhe njësitë administrative përkatëse. Përdorimi i një kampioni përfaqësues kombëtar të ponderuar na bën të mundur të përgjithësojmë dhe t'i aplikojmë gjetjet e sondazhit tek e gjithë popullata si një e tërë. Kështu, niveli i vlefshmërisë statistikore të kampionit përshkruhet si vijon: për popullsinë në moshë madhore prej 2,220,569 banorësh, me madhësi kampioni prej 2,500 të anketuarish, për nivel besimi prej 95%, marzhi i gabimit është ± 1.96 ; për nivel besimi prej 99%, marzhi i gabimit është ± 2.58 .

Për të përcaktuar madhësinë e kampionit për secilin qark, të dhëna për popullsinë u morën nga regjistri civil, ndërsa numri i banorëve për secilin qark më 1 janar 2021 u mor nga Instituti i Statistikave (INSTAT). Duke qenë se numri i banorëve të moshës mbi 18 vjeç ka ndryshuar me vetëm 0.31% gjatë viteve 2019-2021, ky ndryshim nuk pati ndikim statistikor në madhësinë e kampionit sipas qarqeve apo në nivelin e besimit të përmendur më sipër. Kështu, ashtu si në dy edicionet e fundit, për të llogaritur madhësinë e kampionit për secilën bashki dhe, për më shumë detaje, për secilën njësi administrative brenda bashkisë u përdorën të dhënat sasiore nga regjistri civil i datës 1 janar 2019. Kampioni prej 2,500 të anketuarish u shpërnda në të 61 bashkitë nga 12 qarqet e vendit.

Më pas, shpërndarja sipas qarqeve u përshtat për të zgjedhur vetëm popullsinë në moshë madhore (të moshës 18 vjeç e lart) dhe për të përdorur kontrolle të kuotave sipas gjinisë. Meqenëse INSTAT nuk përcakton grupmoshat nën 18 vjeç dhe mbi 18 vjeç, u përdor një teknikë lineare interpolimi.

Koeficienti i përfaqësimit të popullsisë për meshkujt shqiptarë të moshës mbi 18 vjeç që nga 1 janari 2019 u përcaktua në 0.779325197 dhe për femrat mbi 18 vjeç në 0.790087789. Koeficienti i përgjithshëm i përfaqësimit të popullsisë për shqiptarët mbi 18 vjeç ishte 0.78472508614746. Për të ilustruar këtë, në Tabelën 1 jepen shpërndarja sipas qarkut të popullatës rezidente shqiptare të moshës mbi 18 vjeç dhe madhësia e kampionit për secilin qark.

Tabela 1: Popullsia rezidente në 1 janar 2019 dhe 1 janar 2021 dhe madhësia e kampionit për secilin qark

Qarku	Popullsia rezidente 2019	Popullsia e moshës mbi 18 vjeç, 2019	Popullsia e moshës mbi 18 vjeç, 2021	Madhësia e kampionit për çdo qark		
				Burra	Gra	Gjithsej
Berat	125,157	96,788	93,735	54	55	109
Dibër	118,948	91,986	89,210	54	50	104
Durrës	290,126	224,364	229,163	127	126	253
Elbasan	274,982	212,653	208,929	119	121	240
Fier	294,747	227,938	224,433	130	127	257
Gjirokastrë	61,423	47,500	45,538	26	28	54

Qarku	Popullsia rezidente 2019	Popullsia e moshës mbi 18 vjeç, 2019	Popullsia e moshës mbi 18 vjeç, 2021	Madhësia e kampionit për çdo qark		
				Burra	Gra	Gjithsej
Korçë	207,889	160,767	158,666	90	92	182
Kukës	76,594	59,233	58,374	34	33	67
Lezhë	125,195	96,817	94,699	54	55	109
Shkodër	202,895	156,905	154,730	86	91	177
Tiranë	895,160	692,257	715,818	384	399	783
Vlorë	189,311	146,400	147,273	82	83	165
Gjithsej	2,862,427	2,213,610	2,220,569	1,240	1,260	2,500

2.2 INSTRUMENTI I SONDAZHIT

Për të nëntin vit radhazi, ky raport mbështetet në të dhënat parësore të mbledhura si çdo vit me anë të një pyetësi të përsëritur që i bën të mundur hulumtuesve të bëjnë krahasime dhe të matin ndryshimet gjatë viteve.² Prandaj, që nga viti 2013 instrumenti ‘Besimi në qeverisje’ përfshin të njëjtat pyetje bazë për sa i përket besimit në qeverisje, transparencës dhe llogaridhënies, korrupsionit, pjesëmarrjes qytetare dhe përdorimi i TIK. Megjithatë, për të ruajtur ritmin me zhvillimet dhe tendencat e fundit në Shqipëri, përmbajtja e pyetësorit rishikohet çdo vit për të marrë parasysh këto zhvillime e tendenca dhe ndryshoret (variablat) e reja futen vetëm nëse është e nevojshme dhe pa ndikuar në krahasueshmërinë e të dhënave.

Në 2021, si rezultat i rishikimeve nga paneli dhe pas konsultimeve me partnerët e zhvillimit e atyre qeveritarë, sondazhi pësoi disa ndryshime. Kështu pra u shtuan dy pyetje të reja dhe disa opsione për përgjigje, ndërkohë që u hoq një pyetje, duke bërë që numri i faqeve të pyetësorit të mos ndryshonte.

Më konkretisht, në Kapitullin I – Besimi në institucione, në pyetjen një (P1) ku vlerësohet besimi i publikut tek institucionet publike u përfshinë dy kategori të reja - “Bashkia (Administrata)” dhe “Këshilli bashkiak” krahas opsionit “Qeveria vendore”.

Në Kapitullin V – TIK (përdorimi i teknologjisë), në P3 u shtua “Marr informacion për buxhetin e bashkisë” si seksion i rëndësishëm në faqen e bashkisë. E njëjta logjikë u përdor edhe për shtimin e një opsioni tjetër në P6, për të vlerësuar më mirë shërbimet elektronike. Duke pasur parasysh rritjen e përpjekjeve të digjitalizimit në Shqipëri, u shtua një pyetje për të matur nivelin e aftësisë së qytetarëve për të përdorur shërbimet elektronike (P7).

Në Kapitullin VI – Ofrimi i shërbimeve publike, u shtua një pyetje e re (P1.2) për të vlerësuar lehtësinë e marrjes së shërbimeve administrative publike nga qytetarët, ndërkohë që pyetja që vlerëson shërbimet sociale të qeverisjes vendore u hoq duke pasur parasysh se kategoria e asistencës sociale u vendos në shërbimet publike bazë në P1. Nën këtë pyetje, shërbimi i emergjencës u nda në “Shërbimet e emergjencave: ambulanca” dhe “Shërbimet e emergjencave:



2 Pyetësorët e përsëritur u bëjnë të njëjtat pyetje kampionëve të ndryshëm të njerëzve.

zjarrfikësja”, duke mundësuar kështu një vlerësim të veçantë për secilin prej tyre; dhe në kategorinë “shërbimi i pastrimit” u shtua një referencë tjetër “mbledhja e plehrave”, që ishte kthyer në problem të madh për komunitete të ndryshme vendore gjatë 2021.

Edhe Kapitulli VII u përditësua për të reflektuar ngjarjet e vitit të kaluar, përfshirë pandeminë COVID-19 dhe programin e rindërtimit për pasojat e tërmetit të nëntorit 2019. Në P1 u shtua një opsion për të matur sa i kënaqur është publiku me transparencën e vendimmarrjes së qeverisjes vendore. Ndërsa në P2 fokusi u zhvendos nga vlerësimi i reagimit të parë të bashkive, në shqyrtimin e perspektivave të qytetarëve në lidhje me zbatimin e programeve të qeverisë për rindërtimin pas tërmetit.

Së fundi, në Kapitullin “Demografia”, të ardhurat e rregullta mujore u përshtatën në përputhje me shkallën e pagës minimale që hyri në fuqi në 1 janar 2021.

2.3 MBLEDHJA DHE PËRPUNIMI I TË DHËNAVE

Për mbledhjen e të dhënave u përdorën intervistat ballë për ballë. Para fillimit të punës në terren, u paratestua pyetësi dhe u trajnuan intervistuesit.

Procesi i intervistimit u realizua gjatë periudhës 6-21 nëntor 2021 në të 61 bashkitë e vendit me një mesatare prej 50 minutash për intervistë. Për mbledhjen e të dhënave u angazhuan gjithsej 43 intervistues me përvojë dhe në fund të punës në terren u kryen verifikime për kontrollin e cilësisë së të dhënave të mbledhura para hedhjes së tyre në sistem për përpunim.

2.4 ANALIZIMI I TË DHËNAVE

Të gjitha të dhënat e mbledhura u hodhën në një bazë të dhënash në Excel dhe iu nënshtuan procesit të pastrimit dhe kodimit për tu transferuar më pas në programin statistikor ‘Paketë Statistike për Shkencat Sociale - SPSS’. Të dhënat u analizuan duke përdorur statistikat përshkruese dhe inferenciale të cilat mundësuan krahasimet midis grupeve. Gjatë analizimit të të dhënave synimi ka qenë të reflektoheshin perceptimet e qytetarëve të anketuar pa tentuar interpretimin e tyre.

2.5 FOKUS GRUPET

Për shkak të pandemisë dhe përkushtimit tonë për distancimin social me qëllim parandalimin e përhapjes së SARS-CoV-2, ky edicion i Sondazhit të Opinioneve Publikë “Besimi në qeverisje”, ashtu si edhe ai i vitit të kaluar, nuk përfshiu diskutime në fokus grupe.


2.6 KUFIZIME TË METODOLOGJISË

Ky është viti i tretë që në sondazhin e opinionit publik përdoret kampioni përfaqësues për të gjithë popullatën në Shqipëri dhe jo kampion me kuota që u përdor në periudhën 2013-2018. Kjo do të thotë se rezultatet e sondazheve të opinionit publik 2021, 2020 dhe 2019 mund të përgjithësohen për të gjithë popullsinë duke përdorur ponderimet e përfaqësimit të kampionit statistikor për të gjithë popullatën. Megjithatë, krahasimi i rezultateve statistikore të viteve 2021, 2020 dhe 2019 me vitet e mëparshme (2013-2018) mund të sjellin një nivel pasigurie statistikore.

3. DEMOGRAFIA E KAMPIONIT


Për Sondazhin e Opinionit Publik “Besimi në qeverisje” 2021 në të gjithë vendin u anketuan në total 2,500 individ të moshës 18 vjeç e sipër. Nga 2,500 të anketuar, 50.6% ishin femra dhe 49.3% meshkuj dhe dy të anketuar zgjodhën alternativën “tjetër”.³ Shpërndarja gjeografike ishte 70.7% banorë të zonave urbane dhe 29.3% të zonave rurale.

Figura 1: Përfaqësimi gjinor



Baza: N=2500

Figura 2: Përfaqësimi gjeografik



Baza: N=2500

Për sa i përket shpërndarjes moshore, të gjithë të anketuarit ishin të paktën në moshën për të votuar, teksa në sondazh u përfshinë njerëz të moshës 18 vjeç e sipër. I anketuari më i moshuar ishte 84 vjeç. Pjesa më e madhe (62.4%) ishin të moshës 18 deri në 45 vjeç: 15.2% ishin 18-25 vjeç, 25.4% të grupmoshës 26-35 vjeç, dhe 21.9% të grupmoshës 36-45 vjeç. Një tjetër përqindje, 37.6%, e të anketuarve ishin të grupmoshës 46-84 vjeç, siç tregohet në Tabelën 2.

Tabela 2: Grupmoshat

Grup moshë	Përqindja (%)
18-25 vjeç	15.2%
26-35 vjeç	25.4%
36-45 vjeç	21.9%
46-55 vjeç	17%
56-65 vjeç	12.5%
Mbi 66 vjeç	8.1%
Gjithsej	100%


Baza: N=2500



3 Duke pasur parasysh numrin e vogël të të anketuarve (dy) që zgjodhën alternativën “tjetër” si përgjigje, ata nuk u përfshinë në analizat e kryera për dallimet mes gjinive.

Shumica e të anketuarve (78%) kishin mbaruar shkollën e mesme ose kishin diplomë universitare apo pasuniversitare. Plot 42.5% kishin përfunduar arsimin e mesëm (d.m.th., kishin diplomë të shkollës së mesme); ndërkohë që 35.5% ose kishin përfunduar arsimin universitar apo pasuniversitar. Plot 21.1% e të anketuarve kishin përfunduar arsimin e mesëm; 17% kishin ndjekur arsimin e detyrueshëm 8/9-vjeçar dhe vetëm 4.1% nuk kishin fare arsim ose kishin përfunduar vetëm atë fillor (4/5 vjet).

Figura 3: Niveli i arsimit të përfunduar



Baza: N=2500

Për sa i përket statusit të punësimit, në kohën që u realizua ky sondazh, më shumë se gjysma e të anketuarve (56.8%) raportuan se ishin të punësuar, 20.6% ishin të papunë, 11.5% ishin pensionistë, dhe 7% ishin studentë. 3.2% e të anketuarve (N=79 vetë) raportuan një status të ndryshëm punësimi, për shembull, u deklaruan shtëpiakë, apo të regjistruar me aftësi të kufizuara, apo se punonin jashtë shtetit (p.sh., në punë sezonale). Shumica e të anketuarve në marrëdhënie pune (68.9%) ishin të punësuar në sektorin privat, 27.7% në sektorin publik dhe 3.4% zgjedhën alternativën “tjetër”.⁴

Tabela 3: Statusi i punësimit dhe sektori

Statusi i punësimit*	N	%
Të punësuar	1420	56.8%
<i>Spektori publik</i>	424	27.7%
<i>Spektori privat</i>	1055	68.9%
<i>Tjetër</i>	53	3.4%
<i>Gjithsej</i>	1532**	100%
I/E papunë	514	20.6%
Student	174	7%
Pensionist	287	11.5%
Tjetër	79	3.2%
Refuzim	26	1%
Gjithsej	2500	100%

*Të dhënat në shenja të trasha vijnë nga P4: Statusi i punësimit. Baza: N= 2500.

**Të dhënat në itallike vijnë nga P5: Sektori i punësimit. Baza: N = 1532.




4 Të dhënat cilësore të mbledhura mes pyetjeve të hapura sugjerojnë se kjo përkon me të anketuarit e vetëpunësuar.

Në grafikun e mëposhtëm (Figura 4) jepet shpërndarja e të ardhurave mujore individuale të të anketuarve. Në kohën e realizimit të intervistës, 24.7% thanë se nuk kishin të ardhura të rregullta mujore, ndërsa 27.4% raportuan të ardhura neto deri në 30,000 lekë në muaj (që është edhe paga minimale⁵). Plot 25.7% merrnin 30,001-50,000 lekë në muaj, 13.9% fitonin 50,001-70,000 lekë në muaj dhe 2.5% e kampionit kishin të ardhura të rregullta individuale mujore mbi 70,001 lekë. 5.8% refuzuan të deklaronin të ardhurat e tyre mujore.

Për sa i përket dallimeve të të ardhurave mes të anketuarve meshkuj dhe femra, vihen re dallime të mëdha në lidhje me të ardhurat e rregullta mujore. Të anketuarat femra prireshin më shumë të raportonin të ardhura të rregullta mujore (57.9%) në krahasim me të anketuarit meshkuj (42.1%). Pothuajse e njëjta përqindje meshkujsh dhe femrash deklaronin të ardhura të rregullta mujore deri në pagën minimale (30,000 lekë), ku përqindjet ishin 50.9% për femrat dhe 49.1% për të anketuarit meshkuj. Rezultatet tregojnë se të anketuarit meshkuj prireshin më shumë për të raportuar të ardhura më të mëdha mujore sesa femrat në alternativat e mbi 30,001 lekë: përkatësisht 52.7% për 30,001–50,000 lekë; 51.9% për 50,001–70,000 lekë; dhe 58.7% për mbi 70,001 lekë.

Figura 4: Të ardhurat e rregullta individuale mujore (neto):



Baza: N=2500

Të pyetur nëse e konsiderojnë veten me aftësi të kufizuara, vetëm 6.5% e të anketuarve vetë-raportuan se janë me aftësi të kufizuara (N = 161).

Në fund, të anketuarit u pyetën nëse i përkasin ndonjë pakice kombëtare. 5.8% e të anketuarve deklaruan se i përkasin një pakice. Nga kjo përqindje, 30.5% u identifikuan si romë, 24.8% si grekë, 14.9% si egjiptianë, 14.2% si maqedonas, dhe 2.1% si boshnjakë. Një tjetër përqindje 8.5% e të anketuarve që thanë se janë anëtarë të një pakice kombëtare nuk e deklaruan se cilit grup pakice i përkasin.



5 Paga minimale ishte 24,000 lekë/muaj në 2015–2020, dhe u bë 30,000 lekë/muaj në 2021.

Në Tabelën 4 jepen përgjigjet e të anketuarve për këtë pyetje. Për shkak të përqindjes së vogël të të anketuarve që raportojnë se i përkasin një pakice kombëtare, kjo karakteristikë demografike përfshihet vetëm në analizën e rezultateve të sondazhit, kur ka lidhje të drejtpërdrejtë me pyetjen përkatëse (p.sh. diskriminimi ose pyetjet që lidhen me sigurinë).

Tabela 4: A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?

A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?	N	%
Po	143	5.8%
<i>Greke</i>	35	1.4%
<i>Maqedonase</i>	20	0.8%
<i>Arumune</i>	3	0.1%
<i>Rome</i>	43	1.7%
<i>Egjiptiane</i>	21	0.8%
<i>Malazeze</i>	3	0.1%
<i>Boshnjake</i>	3	0.1%
<i>Serbe</i>	0	0%
<i>Bullgare</i>	1	<0.1%
<i>Refuzim/pakicë tjetër</i>	14	0.5%
Jo	2305	92.8%
Refuzim	37	1.5%
Gjithsej	2485	100%

Baza: N=2485

4. REZULTATET E SONDAZHIT

4.1 BESIMI NË INSTITUCIONE

Besimi tek institucionet përfaqëson një nga shtyllat kryesore të Sondazhit të Opinionit Publik “Besimi në Qeverisje”. Besimi në institucione interpretohet si besimi i qytetarëve tek organizmat shtetërorë. Këtu përfshihen parlamenti, qeveria, policia, gjykatat, institucionet publike të pavarura. Duke marrë në konsideratë rolin e tyre në qeverisjen e vendit, në sondazh shqyrtohet besimi i publikut edhe tek organizatat jo-shtetërore si media, organizatat fetare dhe ato joqeveritare.⁶

Në këtë pjesë të sondazhit, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej katër pikësh nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim) se sa i besojnë 19 aktorëve kryesorë shtetërorë dhe institucioneve publike, përfshirë, për herë të parë në këtë edicion, administratën bashkiake dhe këshillin bashkiak. Supozimi bazë këtu është se shkalla e besimit në institucione të caktuara që tregohet nga të anketuarit në këtë sondazh të opinionit publik buron nga kombinimi i faktorëve në nivel makro dhe mikro. Implikimi këtu është se të anketuarit tregojnë shkallën e besimit të tyre si qytetarë bazuar në perceptimin e përgjithshëm dhe përvojat që kanë me institucionet e përmendura pa pasur nevojë të kenë njohuri dhe informacion për krijimin dhe/ose funksionimin e institucioneve përkatëse.



Besimi në institucione, rezultatet e 2021

Në 2021, organizatat ndërkombëtare si NATO (73.2%), OKB (71.4%), dhe BE (71.3%), renditen si institucionet më të besuara. Qytetarët shqiptarë vazhduan t'i konsideronin institucionet fetare (67%) si më të besuarat, pasuar nga institucionet arsimore (57.1%), forcat e armatosura (54.6%) dhe organizatat e shoqërisë civile (52.6%). Presidenti (23.5%), partitë politike (26.4%), gjykatat (27.7%), prokuroria (28.4%) dhe parlamenti (33.2%) ishin institucionet me vlerësimin më të ulët në rezultatet e vitit 2021.

Rezultatet e sondazhit tregojnë se 4 nga 16 institucionet dhe aktorët kryesorë politikë në vend morën një vlerësim pozitiv besimi ('kam shumë besim' ose 'kam besim') nga më shumë se gjysma e të anketuarve. Këto institucione janë institucionet fetare (67%), ndjekur nga institucionet arsimore (57.1%), forcat e armatosura (54.6%), dhe organizatat e shoqërisë civile (OSHC) (52.6%). Më konkretisht, institucionet fetare u renditën si institucionet më të besuara në vend, me 22.5% e të anketuarve që thanë se kanë shumë besim dhe 44.5% që thanë se kanë besim te këto institucione; ndërkohë, 29.3% e të anketuarve thanë se në përgjithësi nuk kanë besim tek institucionet fetare apo nuk kanë aspak besim te to. Institucionet e dyta më të besuara, institucionet arsimore, kishin besimin më të madh të 10.6% të të anketuarve dhe besimin e 46.6% pjesëmarrësve në sondazh; ndërsa 41.7% e të anketuarve thanë se në përgjithësi nuk i besojnë ose nuk i besojnë aspak institucioneve arsimore.



6 Eurofound (2018), Ndryshimet në shoqëri dhe besimi në institucione, Zyra e Publikimeve e Bashkimit Evropian, Luksemburg. Vizitoni <https://www.eurofound.europa.eu/publications/report/2018/social-change-and-trust-in-institutions>


Nga ana tjetër, institucionet kombëtare dhe aktorët kryesorë që morën vlerësimet më të ulëta për nivelin e besimit ishin presidenti (23.5%), partitë politike (26.4%), gjykatat (27.7%), prokuroria (28.4%), dhe parlamenti (33.2%). Për presidentin, 42.3% e të anketuarve treguan se përgjithësisht nuk i besojnë këtij institucioni dhe 32.4% thanë se nuk i besojnë aspak atij. Për sa i përket partive politike, 39.6% e të anketuarve thanë se nuk kanë besim tek to dhe 32.6% deklaruan se nuk u besojnë aspak atyre. Po ashtu, 31.3% e të anketuarve në këtë sondazh thanë se nuk kishin aspak besim tek gjykatat, 30.6% deklaruan të njëjtën gjë për prokurorinë dhe 27.4% për parlamentin.

Të dhënat e vitit 2021 tregojnë se qeveria qendrore dhe vendore gëzojnë nivel më të lartë besimi sesa pushteti legjislativ dhe gjyqësor. 44.7% e të anketuarve thanë se kanë besim te qeveria qendrore, ku 9% e tyre thanë se kishin shumë besim dhe 35.8% thanë se kishin pak besim.

Për sa i përket pushtetit vendor, 44% e të anketuarve thanë se kanë besim te ky institucion, ku 8% deklarojnë se kanë shumë besim dhe 36% se kanë besim. 44.4% e të anketuarve raportojnë se i besojnë administratës bashkiake, me 7.3% që kanë shumë besim dhe 37.2% se kanë besim. Ndërsa sa i përket këshillit bashkiak, 38.4% e të anketuarve kanë thënë se i besojnë këtij institucioni, ku 6.7% deklaruan se kanë shumë besim dhe 31.7% thonë se kanë besim në të. Të dhënat tregojnë se administrata bashkiake gëzon një nivel më të madh besimi sesa këshilli bashkiak. Po ashtu, niveli i besimit për administratën bashkiake është pak a shumë i njëjtë me besimin e raportuar për pushtetin vendor në përgjithësi.

Në 2021, organizatat ndërkombëtare si NATO (73.2%), OKB (71.4%), dhe BE (71.3%), renditen si institucionet më të besuara.

Figura 5: Besimi në institucione 2021 (%)



Baza: N=2500 për të gjitha institucionet

Krahasimi social-demografik i besimit në institucione

Të anketuarit që punojnë në sektorin publik raportuan nivele të larta besimi për 17 nga 19 institucionet e shqyrtuara. Ata me të ardhura mbi 50,001 lekë raportuan, po ashtu, nivele të larta besimi për pjesën më të madhe të institucioneve të vlerësuara në këtë sondazh, për 13 nga 19. Ndërsa të anketuarit pa të ardhura të rregullta mujore raportuan nivele të ulëta besimi për 18 nga 19 institucionet e vlerësuara.

Krahasimet midis variablave demografike evidentuan dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarit, nivelit arsimor, statusit të punësimit ose vendbanimit. Të anketuarat femra kishin më shumë gjasa të pohonin se i besonin administratës së bashkisë (48%), këshillit bashkiak (42%), forcave të armatosura (56%) dhe institucioneve të kujdesit shëndetësor (51%) në krahasim me meshkujt (përkatësisht 41%, 35%, 53% dhe 43%). Të anketuarit e moshës 66 vjeç e lart raportuan nivele më të larta besimi se grupmoshat e tjera për pushtetin vendor (54%), administratën bashkiake (53%) dhe forcat e armatosura (63%). Ndërkohë, studentët raportuan nivel të lartë besimi për presidentin (28%), gjykatat (28%), BE- në (72%) dhe OKB-në (74%). Kur i shohim nga niveli i arsimit, të anketuarit me diplomë universitare kishin më shumë gjasa të raportonin nivel të lartë besimi për qeverinë qendrore (48%), administratën bashkiake (49%), këshillin bashkiak (43%), prokurorinë (32%), gjykatat (31%), policinë (51%), BE-në (74%) dhe NATO-n (76%). Pensionistët e pyetur në këtë sondazh raportuan një nivel më të lartë besimi krahasuar me grupet e tjera demografike kur bëhej fjalë për forcat e armatosura (62%), partitë politike (34%), institucionet e kujdesit shëndetësor (51%), institucionet arsimore (60%), mediat (54%)) dhe NATO-n (73%). Të anketuarit me të ardhura mbi 50,001 lekë në muaj raportuan nivele më të larta besimi për pjesën më të madhe të institucioneve të vlerësuara, 13 nga 19. Edhe të anketuarit që punojnë në sektorin publik raportuan nivele më të larta besimi për 17 nga 19 institucionet e vlerësuara.

Rezultatet tregojnë se ka disa dallime të konsiderueshme mes të anketuarve që jetojnë në zonat urbane dhe atyre që banojnë në zonat rurale. Më konkretisht, qytetarët nga zonat urbane raportuan nivele më të larta besimi në krahasim me ata të zonave rurale për forcat e armatosura (56%), institucionet fetare (68%), OSHC-të (54%) dhe OKB-në (73%). Nga ana tjetër, të anketuarit që jetojnë në zonat rurale raportuan nivele më të larta besimi sesa ata të zonave urbane vetëm për institucionet e kujdesit shëndetësor (50%). *Shih Tabelën 6 në fund të këtij kapitulli për të dhëna mbi ndarjen socio-demografike të besimit në institucione.*

Besimi tek institucionet në vite

Në 2021, u rrit besimi tek qeveria qendrore (9 pp), parlamenti (9 pp), dhe partitë politike (6 pp), ndërsa ra besimi tek institucionet fetare (3 pp), krahasuar me 2020. Ndërkohë, edhe pse në përgjithësi janë më të besuarat, besimi për organizatat ndërkombëtare ka rënë, përkatësisht OKB (5 pp), BE (4 pp), dhe NATO (3 pp).

Duke e analizuar trendin që nga viti 2019, të dhënat për vitin 2021 tregojnë një rritje të besimit veçanërisht për qeverinë qendrore (4 pp në krahasim me 2019 dhe 9 pp në vitin 2020), për parlamentin (5 pp në krahasim me 2019 dhe 9 pp në 2020) dhe partitë politike (3 pp krahasuar me 2019 dhe 6 pp me 2020), duke kapërcyer rënien e dukshme në 2020. Në 2021, niveli i besimit u rrit me 4 pp edhe për prokurorinë dhe gjykatat krahasuar me 2020, pjesë e një tendence në rritje që nga viti 2019. Në përgjithësi, krahasuar me 2020, të gjitha institucionet në vend të shqyrtuara në këtë sondazh e kanë përmirësuar nivelin e besimit tek to në vitin 2021, me përjashtim të OSHC-ve

dhe presidentit, të cilët mbetën në të njëjtin nivel, dhe institucioneve fetare, besimi tek të cilat ra me 3 pp (ndonëse ishte ende më e lartë me 1 pp marginale krahasuar me 2019). Nga ana tjetër, ndonëse janë të vetmet institucione që regjistrojnë shifra mbi 70%, u vu re një rënie e besimit tek organizatat ndërkombëtare në vitin 2021 krahasuar si me 2020 ashtu edhe me 2019; OKB (5 pp dhe 4 pp përkatësisht), NATO (3 pp dhe 5 pp) dhe BE (4 pp dhe 2 pp).

Tabela 5: Besimi në institucione (2015–2021)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Qeveria qendrore	34%	44%	47%	42%	41%	36%	45%
Qeveria vendore	X	49%	49%	47%	42%	42%	44%
Administrata bashkiake**	X	X	X	X	X	X	44%
Këshilli bashkiak**	X	X	X	X	X	X	38%
Presidenti	29%	36%	33%	30%	28%	24%	24%
Parlamenti	22%	27%	34%	30%	28%	24%	33%
Gjyqësori*	17%	23%	X	X	X	X	X
Prokuroria	X	X	22%	28%	27%	24%	28%
Gjykatat	X	X	21%	28%	27%	24%	28%
Policia	46%	61%	53%	58%	55%	43%	46%
Forcat e armatosura	46%	55%	63%	63%	59%	54%	55%
Partitë politike	15%	23%	21%	22%	23%	20%	26%
Institucionet e shëndetit publik	27%	50%	53%	54%	51%	45%	47%
Sistemi arsimor	33%	59%	63%	64%	57%	54%	57%
Media	39%	58%	54%	56%	51%	45%	48%
Institucionet fetare	52%	58%	76%	73%	66%	70%	67%
Shoqëria civile	38%	46%	57%	57%	56%	53%	53%
BE	72%	80%	85%	80%	73%	75%	71%
OKB	X	80%	85%	79%	75%	76%	71%
NATO	74%	79%	84%	81%	78%	76%	73%

Baza: N= 2500 in 2021; N=2488-2499 in 2020; N=2499 in 2019; N=1647 in 2018, 2017, 2016.

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

* Nga viti 2017 e më tej, 'Gjyqësori' është ndarë në 'Prokurori' dhe 'Gjykata'.

** Administrata bashkiake dhe Këshilli bashkiak u shtuan në edicionin e 2021.


Reforma në Drejtësi

35% e të anketuarve në këtë sondazh beson se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi dhe 57% e të anketuarve besojnë se reforma do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Në 2021, përqindja e të anketuarve që mendojnë se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi u rrit me 6 pp krahasuar me 2020. Po ashtu, përqindja e të anketuarve që mendojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e Shqipërisë u rrit me 4 pp vitin e kaluar.

Reforma në drejtësi në Shqipëri nisi në vitin 2016, duke synuar të luftojë korrupsionin e përhapur dhe ndikimin politik në procesin gjyqësor. Është një nga programet më të mëdha dhe më komplekse të reformës institucionale që po ndërmerret në vend, që konsiston ndër të tjera në vetingun e gjyqtarëve dhe prokurorëve, dhe krijimin e institucioneve të reja si Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK).

Në 2021, 35.2% e të anketuarve besonin se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi, ndërsa 47% e të anketuarve nuk janë të mendimit se kjo reformë po zbatohet me korrektësi. Më shumë se gjysma e të anketuarve (57%) besojnë se reforma do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit. Vetëm 26.2% thanë se kjo reformë nuk do të kenë ndikim pozitiv dhe 16.7% nuk dhanë përgjigje.

Figura 6: Ndikimi i perceptuar dhe zbatimi i reformës në drejtësi 2021




Baza: Zbatimi me korrektësi i reformës në drejtësi (N=2500); Ndikimi i reformës (N=2500)

Rezultatet tregojnë se dallimet sipas gjinisë, grupmoshës, arsimit dhe statusit të punësimit të të anketuarve ishin të rëndësishme nga pikëpamja statistikore. Më konkretisht, femrat e intervistuar ishin më të prirura të mendonin se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi (38%) dhe se do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e Shqipërisë (60%), në krahasim me meshkujt (33% dhe 54% respektivisht). Të anketuarit e grupmoshës 18 deri në 25 vjeç prireshin më pak të mendonin se reforma në drejtësi zbatohet me korrektësi (31%) ose se kjo reformë do të kishte ndikim pozitiv (55%). Nga ana tjetër, të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç ishin më të prirur të perceptonin se reforma po zbatohet me korrektësi (45%) dhe se do të ketë ndikim pozitiv (63%). Të anketuarit me diplomë universitare prireshin më shumë të deklarorin se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi (38%) dhe se do të kishte ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit (63%), kur krahasimi bëhet sipas nivelit të arsimit. Për sa i përket sektorit të punësimit, të anketuarit që punojnë në sektorin privat ishin më pak të prirur të perceptonin se reforma në drejtësi zbatohet me korrektësi (31%) apo që reforma do të ketë ndikim pozitiv (56%) krahasuar me ata që punojnë në sektorin publik, (56% dhe 72% respektivisht). Të anketuarit pa të ardhura të rregullta mujore prireshin më pak të mendonin se reforma po zbatohet në mënyrë korrekte (26%) dhe se do të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit (48%). Po ashtu, të anketuarit që i përkisnin një pakice kombëtare ishin më pak të prirur ta perceptonin reformën në drejtësi se po zbatohet me korrektësi (30%), ndërsa të anketuarit me aftësi të kufizuara (47%) prireshin më shumë të besonin se reforma do të kishte ndikim pozitiv në zhvillimin e Shqipërisë. *Shihni Tabelën 7 në fund të këtij kapitulli për një ndarje të plotë social-demografike të përgjigjeve për reformën në drejtësi.*

Duke analizuar trendin që nga viti 2019, të dhënat në 2021 tregojnë një rritje të perceptimit se reforma në drejtësi po zbatohet me korrektësi; 3 pp rritje në krahasim me 2019 dhe 6 pp krahasuar me 2020. Po ashtu, përqindja e të anketuarve që besojnë se reforma do të ketë ndikim pozitiv në zhvillimin e vendit është rritur me 4 pp çdo vit, në periudhën 2019-2021. Pavarësisht kësaj, perceptimet e publikut kanë rënë paksa që nga fillimi i reformës në vitin 2016, ku 35% e të anketuarve në 2021 mendojnë se reforma po zbatohet me korrektësi krahasuar me 46% në 2016. Po e njëjta gjë vihet re me perceptimin e të anketuarve që mendojnë se reforma në drejtësi do të ketë ndikim pozitiv, përqindje që ka rënë në 57% krahasuar me 71% në vitin 2016.

Figura 7: ‘Ndikimi pozitiv’ apo ‘zbatimi me korrektësi’ i reformës në drejtësi, përqindja e atyre që thanë ‘po’ në 2016–2021



Baza: Për ndikimin e reformës në drejtësi, 2016 (N=1639); 2017 (N=1644); 2018 (N=1642); 2019 (N=2494); 2020 (N=2493); 2021 (N=2500). Për zbatimin e reformës në drejtësi, 2016 (N=1641); 2017 (N=1646); 2018 (N=1645); 2019 (N=2498); 2020 (N=2494); 2021 (N=2500).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.




Media

Edhe pse mediat sociale (28.9%) dhe portalet (10.3%) po bëhen përherë e më shumë popullore për shqiptarët si burimi mediatic për marrjen e të reja me të fundit për aktualitetin, televizioni (54%) mbetet burimi mediatic më popullor, veçanërisht për banorët e zonave rurale (60%). Mediat sociale janë më popullore tek brezat në moshë të re, 18–25 vjeç (58%) dhe 26–35 vjeç (45%); studentët (61%); të anketuarit me arsim universitar (44%) dhe tek ata me të ardhura të rregullta mujore mbi 70,000 lekë (44%).

Në sondazhin e opinionit 2021, më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) raportuan se përdornin televizionin si burimin kryesor për marrjen e të reja me të fundit për aktualitetin, pasuar nga mediat sociale (28.9%), portalet (10.3%), gazetatat (5%), dhe radio (1.7%).

Figura 8: Mediat më të përdorura për marrjen e informacionit për aktualitetin



Baza: N =2481

*Shënim: Disa të anketuar zgjedhën më shumë se një alternativë; përqindjet nuk plotësojnë totalin prej 100%.

Rezultatet tregojnë se gjinia e të anketuarve nuk e ndikon perceptimin e tyre për llojin e medias së preferuar. Dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore u vunë re sipas grupmoshave, nivelit të arsimit, statusit të punësimit dhe vendbanimit. Të anketuarit e rinj, veçanërisht ata të grupmoshës 18-25 vjeç janë më shumë të prirur të zgjedhin mediat sociale si median e tyre të preferuar (58%) dhe priren më pak të përdorin TV si burimin e tyre kryesor (22%). Nga ana tjetër, të anketuarit e grupmoshës mbi 56 vjeç raportojnë se kanë televizionin si burimin kryesor të informacionit (80%) dhe janë shumë më pak të prirur të përdorin portalet (2%) dhe mediat sociale (4%). Dallime të rëndësishme u vunë re edhe sipas vendbanimit ku të anketuarit që banojnë në zonat rurale (60%) kanë më shumë gjasa të thonë se TV është burimi i tyre kryesor i informacionit dhe janë më pak të prirur të përdorin mediat sociale (24%). Për më tepër, të dhënat tregojnë se mediat sociale kanë më shumë gjasa të përdoren si burim kryesor informacioni nga të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë/muaj (44%). *Për një analizë të plotë të të dhënave sipas ndarjeve demografike, shih Tabelën 8 në fund të këtij kapitulli.*


Edhe pse televizioni mbetet burimi më i përdorur për informim për aktualitetin te të anketuarit, në vitin 2021 kjo shifër (54%) ka rënë me 3 pp që nga viti 2019 (57%) dhe 4 pp nga 2020 (58%). Përdorimi i mediave sociale ra me 7 pp që nga viti 2020 (36%), ndonëse pati një rritje kumulative prej 4 pp krahasuar me vitin 2019 (25%).

Saktësia e mediave

Në 2021, 38.8% e të anketuarve besojnë se informacioni i dhënë nga media në Shqipëri është i saktë/i vërtetë. Shqiptarët që përdorin televizionin (42%) ose portalet (40%) si burimin e tyre kryesor të informacionit për lajmet për aktualitetin priren më shumë të besojnë se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare është i saktë dhe/ ose i vërtetë.

38.8% e të anketuarve besojnë se informacioni i dhënë nga media në Shqipëri është i saktë/i vërtetë, ndërsa 34.9% mendojnë se është i pasaktë/pavërtetë dhe 26.3% nuk ishin të sigurt (nuk e dinin). Përdoruesit e TV priren më shumë të besojnë se informacioni i dhënë nga mediat shqiptare është i saktë dhe/ ose i vërtetë (41.9%), ndjekur nga ata që përdorin portalet si burimin e tyre kryesor të informacionit (39.6%). Nga ana tjetër, të anketuarit që evidentuan radion si burimin më të përdorur për të rejtat nga aktualiteti ishin më skeptikë për saktësinë e informacionit, ku vetëm 31.7% e tyre thanë se informacioni që jepet nga mediat në Shqipëri është i saktë/vërtetë.


Figura 9: Perceptimi për saktësinë e informacionit të dhënë nga burimi më i përdorur mediatik 2021



Baza: N = 2478

Në 2021, përqindja e të anketuarve që mendonin se informacioni që jepet nga mediat shqiptare është i saktë arriti të njëjtin nivel si në 2019 (39%), duke kapërcyer rënien e vitit 2020.

Figura 10: Saktësia e mediave (2016–2021)



Baza: 2016 (N=1639); 2017 (N=1646); 2018 (N=1643); 2019 (N=2496); 2020 (N=2491); 2021 (N=2500)

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


Mbështetja e donatorëve të huaj

50.6% e popullsisë shqiptare ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj në Shqipëri. Nga ana tjetër, 21.5% e të anketuarve thanë se nuk ishin të sigurt (nuk e dinin).

Gjysma e kampionit të intervistuar (50.6%) ishin të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj (donatorët) në Shqipëri: 12.1% ishin shumë të kënaqur dhe 38.5% ishin të kënaqur. Nga ana tjetër, 27.9% ishin të pakënaqur dhe një tjetër 21.5% e të anketuarve thanë se nuk e dinin.

Nuk u vunë re dallime të rëndësishme në perceptim sipas gjinisë së të anketuarve (femra 52% dhe meshkuj 48%), sipas grupmoshës ose vendbanimit. 57% e të anketuarve me të ardhura nga 30,001-70,000 lekë kanë deklaruar se janë të kënaqur me ndihmën e huaj. Punonjësit e sektorit publik (62%) ishin më shumë të prirur të shpreheshin të kënaqur me ndikimin e donatorëve të huaja, ndërsa studentët (42%) ishin më pak të kënaqur. Më pak se gjysma e të anketuarve që i përkasin një pakice kombëtare (40.6%) dhe atyre me aftësi të kufizuara (43%) deklaruan se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e ndihmës së donatorëve të huaj në Shqipëri.

Figura 11: Kënaqësia me donatorët e huaj në Shqipëri



Baza: N = 2500

Në 2021, ashtu si në vitin e kaluar, të dhënat tregojnë se të anketuarit që besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë janë më shumë të prirur të jenë disi të kënaqur me asistencën e donatorëve të huaj në Shqipëri.⁷ 55.5% e tyre thanë se ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ndikimin e asistencës së huaj në Shqipëri krahasuar me 34.6% e të anketuarve që nuk besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë.

7 Shih kapitullin 4.2 “Transparenca dhe llogaridhënia”, pyetjen “Sipas jush, cila prej të mëposhtëmv e bën qeverinë më të përgjegjshme për veprimet/mosveprimet e saj?”

Tabela 6: Ndarja demografike e besimit ('kam shumë besim' dhe 'kam besim')

	GJITHSEJ (% e besimit)	45%	44%	44%	38%	24%	33%	28%	28%	Gjykatat	46%	55%	26%	Partitë politike	Inst. shëndetësore	57%	48%	Media	Inst. fetare	53%	71%	BE	71%	OKB	71%	NATO	73%
		43%	41%	47%	35%	22%	31%	28%	27%	27%	48%	53%	25%	43%	53%	65%	45%	49%	67%	49%	68%	67%	71%			71%	
		47%	47%	47%	42%	25%	35%	29%	28%	28%	44%	56%	27%	51%	61%	69%	50%	56%	75%	56%	75%	75%	75%			76%	
		40%	37%	40%	36%	27%	29%	25%	25%	43%	52%	52%	22%	42%	55%	66%	48%	48%	66%	54%	72%	72%	72%			70%	
		45%	45%	43%	38%	23%	33%	31%	30%	48%	55%	57%	27%	49%	57%	68%	45%	45%	68%	56%	73%	73%	72%			75%	
		43%	47%	43%	40%	23%	34%	30%	29%	47%	56%	57%	28%	47%	57%	67%	49%	49%	67%	51%	70%	70%	69%			72%	
		46%	45%	45%	38%	20%	32%	25%	28%	44%	51%	58%	26%	47%	58%	66%	47%	47%	66%	52%	72%	72%	73%			75%	
		46%	44%	44%	37%	25%	34%	27%	23%	46%	55%	58%	27%	44%	58%	66%	48%	48%	66%	51%	71%	71%	71%			72%	
		53%	53%	54%	43%	23%	39%	30%	27%	50%	63%	60%	30%	52%	60%	70%	52%	52%	70%	49%	71%	71%	72%			76%	
		41%	40%	41%	34%	24%	31%	27%	26%	44%	52%	55%	27%	46%	55%	64%	44%	44%	64%	50%	68%	68%	69%			69%	
		44%	43%	43%	37%	22%	32%	27%	26%	44%	53%	56%	25%	45%	56%	69%	49%	49%	69%	53%	71%	71%	72%			73%	
		48%	48%	48%	43%	25%	36%	32%	31%	51%	58%	59%	28%	50%	59%	67%	49%	49%	67%	54%	74%	74%	73%			76%	
		49%	48%	48%	42%	25%	37%	31%	30%	50%	59%	63%	29%	50%	63%	70%	49%	49%	70%	54%	73%	73%	74%			76%	
		70%	70%	70%	63%	30%	55%	43%	42%	66%	74%	73%	39%	64%	73%	81%	55%	55%	73%	63%	81%	81%	81%			84%	
		40%	39%	39%	33%	22%	29%	26%	25%	44%	52%	58%	24%	45%	58%	67%	46%	46%	67%	51%	70%	70%	71%			73%	
		33%	31%	31%	29%	20%	23%	21%	22%	36%	42%	49%	18%	37%	44%	62%	44%	44%	62%	49%	68%	68%	65%			67%	
		43%	43%	43%	37%	28%	30%	26%	28%	43%	54%	63%	25%	42%	52%	63%	43%	43%	63%	55%	72%	72%	74%			72%	
		53%	53%	53%	45%	26%	40%	32%	28%	50%	62%	60%	34%	51%	60%	69%	54%	54%	69%	51%	71%	71%	71%			73%	
		45%	44%	44%	39%	24%	33%	28%	28%	47%	56%	57%	26%	45%	57%	68%	49%	49%	68%	54%	73%	73%	74%			74%	
		45%	44%	44%	38%	22%	33%	28%	26%	45%	52%	58%	27%	50%	58%	64%	45%	45%	64%	48%	67%	67%	69%			70%	
		35%	34%	34%	30%	21%	24%	21%	22%	36%	45%	46%	20%	37%	46%	62%	44%	44%	62%	51%	68%	68%	67%			67%	
		44%	45%	45%	37%	22%	32%	26%	25%	46%	56%	58%	27%	46%	58%	70%	49%	49%	70%	53%	71%	71%	72%			73%	
		50%	50%	50%	44%	27%	38%	34%	33%	50%	60%	64%	31%	51%	64%	72%	52%	52%	72%	58%	76%	76%	76%			79%	
		52%	51%	51%	47%	26%	43%	35%	32%	56%	61%	65%	32%	55%	65%	66%	47%	47%	66%	51%	72%	72%	73%			76%	
		43%	38%	38%	44%	24%	35%	29%	32%	57%	59%	61%	33%	49%	57%	71%	49%	49%	71%	56%	79%	79%	76%			81%	

Shënimi: Ngjyrat përfaqësojnë raste kur dallimet që vihen re mes rregresve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p \leq 0.05$).
Shënimi: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim filor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyrues (8/9-vjeçar).

Tabela 7: Ndarja demografike e reformës në drejtësi

		Ndikimi pozitiv i reformës në drejtësi (% po)	Zbatimi me korrektësi i reformës në drejtësi (% po)
Gjithsej		57%	35%
Gjinia			
Meshkuj		54%	33%
Femra		60%	38%
Grupmosha			
18–25 vjeç		55%	31%
26–35 vjeç		57%	36%
36–45 vjeç		58%	36%
46–55 vjeç		57%	34%
56–65 vjeç		55%	32%
66 vjeç e sipër		63%	45%
Niveli arsimor			
Me arsim deri 8/9-vjeçar		52%	32%
Me arsim të mesëm		55%	34%
Me arsim universitar		63%	38%
Statusi i punësimit			
I/E punësuar	Gjithsej	61%	39%
	Spektori publik	72%	56%
	Spektori privat	56%	31%
I/e papunë		45%	24%
Studentë		56%	34%
Pensionist		61%	41%
Niveli i të ardhurave			
Pa të ardhura		48%	26%
Deri në 30,000 lekë		56%	36%
30,001 – 50,000 lekë		63%	40%
50,001–70,000 lekë		63%	42%
Mbi 70,001 lekë		67%	35%
Vendbanimi			
Urban		58%	36%
Rural		56%	34%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square , $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 8: Ndarja demografike e përdorimit të mediave

		Burimi mediatik më i përdorur				
		TV	Radio	Gazeta	Portalet	Mediat sociale
Gjithsej		54%	2%	5%	10%	29%
Gjinia						
Meshkuj		55%	2%	4%	10%	31%
Femra		54%	2%	6%	10%	27%
Grupmosha						
18–25 vjeç		22%	1%	3%	16%	58%
26–35 vjeç		32%	2%	3%	17%	45%
36–45 vjeç		60%	2%	4%	10%	25%
46–55 vjeç		76%	1%	6%	6%	11%
56–65 vjeç		80%	2%	8%	2%	8%
66 vjeç e sipër		80%	2%	11%	2%	4%
Niveli arsimor						
Me arsim deri 8/9-vjeçar		75%	2%	7%	5%	10%
Me arsim të mesëm		59%	2%	5%	8%	26%
Me arsim universitar		35%	1%	4%	16%	44%
Statusi i punësimit						
Të punë- suar	Gjithsej	50%	2%	4%	12%	32%
	Sektori publik	49%	1%	5%	14%	30%
	Sektori privat	51%	2%	4%	11%	33%
I/E papunë		58%	1%	6%	10%	25%
Student		20%	0%	2%	17%	61%
Pensionist		81%	3%	9%	2%	5%
Niveli i të ardhurave						
Pa të ardhura		51%	1%	4%	11%	33%
Deri në 30,000 lekë		69%	2%	8%	6%	15%
30,001–50,000 lekë		51%	1%	3%	10%	34%
50,001–70,000 lekë		40%	2%	4%	16%	37%
Mbi 70,001 lekë		37%	2%	2%	16%	44%
Vendbanimi						
Urban		52%	1%	5%	12%	31%
Rural		60%	2%	6%	7%	24%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.2 TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA

Transparenca dhe llogaridhënia konsiderohen si elementët bazë që lidhen me funksionimin e duhur të sistemit të demokracisë. Ato forcojnë njëra-tjetrën dhe në të njëjtën kohë u bëjnë të mundur qytetarëve të ndikojnë në procesin vendimmarrës dhe t'u kërkojnë llogari pushtetarëve. Prandaj, krijimi i institucioneve të përgjegjshme dhe transparente është pjesë e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së; në mënyrë më specifike 'Objektivi 16: Promovimi i shoqërive paqësore dhe përfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet' dhe 'Objektivi 16.6.: Zhvillimi i institucioneve efektive, llogaridhënese dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet'.⁸

Në themel të konceptit të transparencës është supozimi kryesor se qeveria vepron në mënyrë të hapur. Kjo ka të bëjë ndër të tjera me transparencën e qeverisë për mënyrën si vepron, për veprimtarinë dhe shpenzimet e saj, për operacionet e saj dhe për vendimet që merr. Element kyç i transparencës është e drejta për akses tek informacioni që është në pronësi të autoriteteve publike. Megjithatë, transparenca përfshin edhe elementë të tjerë, si ofrimi i mundësive që takimet e institucioneve publike vendimmarrëse të jenë të hapura për publikun.⁹

Llogaridhënia presupozon se qeveria duhet të marrë përgjegjësinë për vendimet dhe veprimet e saj. Ajo ka dy dimensione: përgjegjësia për t'u përgjigjur – ose detyrimi i autoriteteve publike për t'i dhënë publikut informacione dhe shpjegime për veprimtaritë e tyre; dhe zbatimi ose mekanizmat, me anë të të cilave informacioni që merret mund të sigurojë që qeveria merr masa për çdo dështim. Llogaridhënia mund të jetë vertikale – drejtpërdrejtë me publikun – ose horizontale – mundësohet nëpërmjet mekanizmave që veprojnë ndërmjet institucioneve publike.¹⁰

● ● Transparenca

Më shumë se gjysma e shqiptarëve të anketuar i perceptojnë qeverinë qendrore (57.4%) dhe bashkitë (58.2%) si jo transparente. Kjo tendencë vihet re veçanërisht tek të anketuarit pa të ardhura të rregullta mujore.


Më shumë se gjysma e të anketuarve, 57.4% nuk besonin (d.m.th., “nuk ishin dakord” dhe “nuk ishin aspak dakord”) se qeveria qendrore është transparente. 41.4% e njerëzve të anketuar mendonin se qeveria qendrore ishte transparente (33.6% ishin dakord me pohimin dhe 7.7% ishin plotësisht dakord). Po ashtu, 58.2% e të anketuarve nuk u dakorduan ('nuk jam dakord' dhe 'nuk jam aspak dakord) se bashkia ishte transparente. Vetëm 8% e të anketuarve shprehën dakordësinë e tyre të plotë me pohimin 'bashkia është transparente', ndërsa 32.2% ishin paksa dakord.

● ●
8 Organizata e Kombeve të Bashkuara. (2019). Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Vizitoni: <https://www.un.org/sustainabledevelopment/peace-justice/>

9 Shpjegimi i koncepteve bazohet kryesisht në kumtesën “Standardet Ndërkombëtare për Transparencën dhe Llogaridhënien”. Qendra për Ligj dhe Demokraci (2014). Marrë nga adresa: http://www.law-democracy.org/live/wp-content/uploads/2014/04/Transparency-and-Accountability.final_Mar14.pdf

10 Po aty.

Figura 12: Perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore dhe vendore 2021



Baza: Për qeverinë qendrore (N=2500); për bashkitë (N=2500)

Të dhënat tregojnë se vihen re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore mes të anketuarve sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit arsimor, sektorit të punësimit, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, përkatësisë etnike si dhe përkatësisë politike. Të anketuarat femra prireshin më shumë të mendonin se qeveria qendrore (44%) dhe pushteti vendor (44%) janë transparente në krahasim me të anketuarit meshkuj (39% dhe 37% respektivisht). Të anketuarit më të rinj në moshë, veçanërisht ata të grupmoshës 18 deri në 25 vjeç (35%), ishin më pak të prirur ta konsideronin qeverinë qendrore si transparente.

Për sa i përket nivelit të të ardhurave, të anketuarit pa të ardhura të rregullta mujore nuk mendonin se qeveria qendrore dhe bashkitë janë transparente; në fakt, vetëm 32% e tyre ishin dakord me një nga dy pohimet. Në lidhje me dallimet mes të anketuarve sipas sektorit të punësimit, të dhënat sugjerojnë se ata që punojnë në sektorin publik prireshin më shumë të mendonin se qeveria qendrore (64%) dhe bashkitë (63%) janë transparente krahasuar me të punësuarit në sektorin privat, 36% e të cilëve kishin të njëjtin mendim për të dy pohimet.

Të anketuarit që janë anëtarë të partive politike prireshin më shumë t'i konsideronin qeverinë qendrore (63%) dhe atë vendore (61%) si transparente në krahasim me të anketuarit që nuk janë anëtarë të partive politike (38% dhe 37% përkatësisht).

Të anketuarit me të ardhura 50,001 deri në 70,001 lekë/muaj (49%) dhe ata të grupmoshës 66 vjeç e sipër (54%) ishin më shumë të prirur të mendonin se qeveria qendrore është transparente sesa grupet e tjera. Për më tepër, të anketuarit me të ardhura 50,001 deri në 70,001 lekë/muaj (48%) dhe ata me arsim universitar (44%) prireshin më shumë ta konsideronin pushtetin vendor si transparent.

Ndërkohë, të anketuarit që jetojnë në zonat rurale (38%) ishin më pak të prirur të binin dakord se qeverisja vendore është transparente krahasuar me banorët e zonave urbane (41%). *Për më shumë informacione për ndarjen demografike të përgjigjeve, shih Tabelën 10 në fund të këtij kapitulli.*


Transparenca në vite

Në Sondazhin e Opinionit 2021, perceptimi për transparencën në nivelin qendror dhe vendor të qeverisjes është rritur me 6 pp dhe 3 pp përkatësisht, krahasuar me 2020, duke shënuar kështu rritjen e dytë radhazi.

Në studimin e vitit 2021, perceptimi për transparencën e qeverisë qendrore është rritur me 6 pp krahasuar me 2020, duke sjellë një rritje totale prej 8 pp krahasuar me 2019.

Po ashtu, edhe perceptimi për transparencën e qeverisjes vendore ka pasur rritje në këtë studim – 3 pp krahasuar me 2020, dhe një rritje totale prej 4 pp që nga viti 2019.

Figura 13: Ndryshimi në transparencën e perceptuar të institucioneve 2016-2021



Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1647); 2017 (N=1636); 2018 (N=1644); 2019 (N=2492); 2020 (N=2495), 2021 (N=2500) bashkia: 2016 (N=1645); 2017 (N=1637); 2018 (N=1642); 2019 (N=2489); 2020 (N=2494); 2021 (N=2500).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.




Ushtrimi i të drejtës për informim

Shumica e shqiptarëve të anketuar (62.2%) ishin të ndërgjegjësuar se e drejta për informim është e garantuar me ligj. Në mënyrë të veçantë, shqiptarët e grupmoshës 26-35 vjeç (68%), ata me diplomë universitare (76%) dhe të anketuarit me të ardhura të rregullta mujore mbi 70, 001 lekë treguan nivel më të lartë ndërgjegjësimi.

E drejta për informim është një nga pikat kryesore të programeve të transparencës, prandaj është me rëndësi tejet të madhe të vlerësohet ndërgjegjësimi i qytetarëve në lidhje me të. Ligji Nr. 119/2014, “Për të Drejtën e Informimit”, një nga hapat më domethënës të ndërmarrë drejt përmirësimit të transparencës, parashikon të drejtën e marrjes së informacionit që prodhohet ose mbahet nga institucionet publike. Ai thotë se çdokush ka të drejtë të marrë informacione publike pa pasur nevojë të shpjegojë arsyen përse e ka kërkuar atë.

Shumica (62.2%) e të anketuarve thanë se ishin të ndërgjegjshëm se në Shqipëri e drejta për informim garantohet me ligj, ndërsa 37.8% nuk ishin të ndërgjegjësuar për këtë të drejtë.

Figura 14: Ndërgjegjësimi publik për ligjin për të drejtën e informimit në 2021



Baza: N = 2391

Nuk vihen re dallime të rëndësishme mes të anketuarve femra (61%) dhe atyre meshkuj (63%). Megjithatë, rezultatet e sondazhit nxjerrin në pah dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore mes kategorive demografike, si grupmosha, arsimi, vendbanimi, dhe të ardhurat.

Të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç (68%), ata me arsim universitar (76%), ata që banojnë në zonat urbane (65%) dhe ata me të ardhura të rregullta mujore mbi 70,001 ALL (79%) ishin më shumë të ndërgjegjësuar për të drejtën e informimit sesa grupet e tjera demografike.

Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare dhe ata me aftësi të kufizuara ishin më pak të ndërgjegjësuar (të dy këto grupe me 52%) për ligjin për të drejtën e informimit.


Në përgjithësi në 2021, përqindja e të anketuarve që raportuan se janë në dijeni se në Shqipëri e drejta për informim garantohej me ligj vazhdoi të binte (62% krahasuar me 64% në 2020), një rënie kumulative me 5 pp që nga 2019 kur ishte 67%.

Llogaridhënia

Më shumë se gjysma e të anketuarve nuk i konsideronin strukturat e qeverisë qendrore dhe vendore si të përgjegjshme (që japin llogari). Vetëm 37.5% thanë se e konsideronin qeverinë qendrore si të përgjegjshme dhe 38.6% e konsideronin bashkinë si të përgjegjshme. Njerëzit pa të ardhura të rregullta mujore ishin më pak të predispozuar për t'i konsideruar nivelin e qeverisjes qendrore dhe vendore si të përgjegjshme (27% dhe 31% përkatësisht).

60.9% e të anketuarve raportuan se ata nuk e konsideronin qeverinë qendrore si të përgjegjshme: ku 38.7% nuk ishin dakord me pohimin: 'Qeveria qendrore është e përgjegjshme', dhe 22.2% që nuk ishin aspak dakord me këtë pohim. Po ashtu, 59.6% e të anketuarve në 2021 thanë se nuk e konsideronin bashkinë si të përgjegjshme (nuk ishin dakord – 37.1%; dhe nuk ishin aspak dakord – 22.5%).

Figura 15: Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe vendore në 2021



Baza: Për qeverinë qendrore (N=2500); Për qeverinë vendore (N=2500).


Kur shqyrtojmë dallimet mes treguesve demografikë, nuk u vunë re dallime të rëndësishme mes grupmoshave dhe vendbanimit. Rezultatet tregojnë dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë, ku femrat (40%) ishin më shumë të prirura ta konsideronin qeverinë qendrore si të përgjegjshme (krahasuar me 35% të të anketuarve meshkuj). Po ashtu, 41% e femrave e perceptojnë bashkinë si të përgjegjshme, krahasuar me 36% të meshkujve. Sa i përket arsimit, të anketuarit me arsim universitar (42%) ishin më shumë të prirur ta konsideronin bashkinë si të përgjegjshme. Nga ana tjetër, të anketuarit pa të ardhura të rregullta mujore ishin më pak të prirur ta konsideronin qeverinë qendrore (27%) apo bashkinë (31%) si të përgjegjshme. *Shihni Tabelën 10 në fund të këtij kapitulli për të gjithë ndarjen demografike.*

Perceptimi i llogaridhënies së qeverisë qendrore dhe asaj vendore 2016–2021

Në 2021, përqindja e qytetarëve që mendojnë se qeveria vendore është e përgjegjshme është rritur për të dytin vit radhazi; me 3 pp krahasuar me 2020 (38% krahasuar me 35%), dhe 7 pp kumulative që nga viti 2019 (31%). Po ashtu, përqindja e të anketuarve që e konsideronin bashkinë si të përgjegjshme u rrit me 2 pp krahasuar me vitin e kaluar dhe 8 pp kumulative që nga viti 2019.

Në 2021, përqindja e të anketuarve të cilët mendojnë se qeveria vendore është e përgjegjshme është rritur për të dytin vit radhazi; me 3 pp krahasuar me 2020 (38% krahasuar me 35%), kumulative që nga viti 2019 (31%). Po ashtu, përqindja e të anketuarve që e konsideronin bashkinë si të përgjegjshme (39%) u rrit me 2 pp krahasuar me vitin e kaluar (37%) dhe 8 pp kumulative që nga viti 2019 (31%).

Figura 16: Ndryshimi për perceptimin e llogaridhënies (2016–2021)



Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1646); 2017 (N=1635); 2018 (N=1644); 2019 (N=2491); 2020 (N=2495); 2021 (N=2500), dhe bashkia: 2016 (N=1645); 2017 (N=1633); 2018 (N=1643); 2019 (N=2485); 2020 (N=2489); 2021 (N=2500).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


Llogaridhënia horizontale dhe vertikale

Përqindja e të anketuarve që ishin të ndërgjegjësuar për mekanizmat institucionalë që i kërkojnë llogari qeverisë është rritur për të gjitha institucionet e renditura për vitin 2021. Në përgjithësi, shqiptarët vazhdojnë të besojnë se organizatat ndërkombëtare (77%) i kërkojnë më shumë llogari qeverisë në krahasim me organizatat vendase. Të anketuarit priren të besojnë se mekanizmi më efektiv i llogaridhënies së brendshme është Kontrolli i Lartë i Shtetit (71.1%), ndjekur nga parlamenti (63.9%) dhe media (61.5%).

Llogaridhënia mund të klasifikohet si llogaridhënie horizontale dhe llogaridhënie vertikale, sipas llojit të kërkesës së llogarisë që bëhet dhe/ose personit, grupit apo institucionit para të cilit përgjigjet zyrtari publik. Llogaridhënia horizontale ushtrohet me anë të një rrjeti institucionesh dhe ka të bëjë me kapacitet e institucioneve shtetërore (si parlamenti dhe gjyqësori) për të mbikëqyrur politikën e qeverisë duke i kërkuar asaj informacione, duke kontrolluar zyrtarët dhe duke ndëshkuar shkeljet apo sjelljet e gabuara. Nga ana tjetër, llogaridhënia vertikale kuptohet si marrëdhënia mes institucioneve dhe qytetarëve. Kjo ka të bëjë me instrumentet me të cilat qytetarët, masmedia, dhe shoqëria civile kërkojnë zbatimin e standardeve të performancës së mirë nga zyrtarët e qeverisë.

Për sa i përket mekanizmave të llogaridhënies horizontale në vend, Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) vazhdon të konsiderohet si institucioni me rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (71.1%), ndjekur nga parlamenti (63.9%) dhe Avokati i Popullit (49.6%). Nga ana tjetër, deputetë të veçantë (47.2%), partitë e opozitës (46.4%), Komisioneri Kundër Diskriminimit (44.6%), dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave (43.1%) u konsideruan si më pak efektivë në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë.

Figura 17: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies horizontale 2021



Baza: N=2500 për të gjitha institucionet

Në përgjithësi, kur shqyrtojmë perceptimet e të anketuarve për llogaridhënien horizontale sipas treguesve demografikë, evidentohen pak dallime të konsiderueshme sipas gjinisë, grupmoshës dhe nivelit arsimor për pjesën më të madhe të institucioneve të listuara. Të anketuarat femra ishin më shumë të prirura në krahasim me meshkujt të mendonin se parlamenti (67%) e bën qeverinë të përgjegjshme. Të anketuarit e grupmoshës 66 vjeç e sipër (59%) ishin më të prirur se grupmoshat e tjera të mendonin se deputetë të veçantë i kërkojnë llogari qeverisë, ndërsa të anketuarit me diplomë universitare apo pasuniversitare (77%) prireshin më shumë të mendonin se KLSH mund t'i kërkojë llogari qeverisë. Rezultatet tregojnë dallime të konsiderueshme edhe për sa i përket punësimit, të ardhurave dhe vendbanimit. Të punësuarit në sektorin publik ishin më të predispozuar për të menduar se të gjitha institucionet e renditura (parlamenti, 75%; deputetë të veçantë, 55%; KLSH, 83%, partitë opozitare, 51%; Avokati i Popullit, 60%; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave, 54%; dhe Komisioneri Kundër Diskriminimit, 55%) mund t'i kërkojnë llogari qeverisë në krahasim me ata që punojnë në sektorin privat. Të anketuarit e papunë ishin më pak të prirur të besonin se partitë e opozitës (42%), deputetë të veçantë (43%), Avokati i Popullit (44%), Komisioneri Kundër Diskriminimit (42%), apo Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave (38%) mund t'i kërkojnë llogari qeverisë, ndërsa studentët ishin më të prirur ta konsideronin KLSH-në (67%) si më efektive në këtë rol.


Për më tepër, të anketuarit me të ardhura të rregullta mujore deri në 30,000 lekë dhe 30,001 deri në 50,000 lekë prireshin më shumë të besonin se parlamenti (67% secili grup) mund ta bëjë qeverinë të përgjegjshme. Po ashtu, të anketuarit me të ardhura 30,001 deri në 50,000 lekë/muaj ishin më të shumtë në përgjigjen se këtë rol muaj ta luajë KLSH (78%). Nga ana tjetër, të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë/muaj mendonin se deputetë të caktuar (54%) dhe partitë e opozitës (51%) ishin ndër mekanizmat horizontale që mund të kenë efekt në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë.

Të anketuarit nga zonat rurale në krahasim me ata nga zonat urbane besonin më shumë se parlamenti (68%) dhe partitë e opozitës (50%) mund t'i kërkojnë llogari qeverisë, ndërkohë që të anketuarit nga zonat urbane dhanë përgjigje më pozitive për të gjitha institucionet e renditura në listë.

Të anketuarit me aftësi të kufizuara ishin më pak të prirur të mendonin se parlamenti (62%), Kontrolli i Lartë i Shtetit (69%), Avokati i Popullit (48%), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave (41%) dhe partitë e opozitës (45%) i kërkojnë llogari qeverisë. Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare deklarorin më shpesh në krahasim me të tjerët se parlamenti (66%) dhe partitë opozitare e bëjnë qeverinë të përgjegjshme (50%). *Për të gjitha gjetjet sipas treguesve demografikë, shih Tabelën 11 në fund të këtij kapitulli.*

Sa i përket mekanizmave të llogaridhënies vertikale, media u perceptua se kishte rolin më të madh në kërkesën e llogarisë ndaj qeverisë (61.5%), ndjekur nga biznesi/shoqatat e biznesit (50.4%) dhe sindikatat (50.2%) dhe shoqëria civile (49.2%). Si për kontrast, plot 3/4 e të anketuarve (77%) besojnë se organizatat ndërkombëtare i kërkojnë llogari qeverisë.

Figura 18: Perceptimi për efektivitetin e mekanizmave të llogaridhënies vertikale 2021



Baza: N=2500 për të gjitha institucionet e renditura

Kur shqyrtohen përgjigjet sipas treguesve demografikë, vihen re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë, grupmoshës, nivelit arsimor apo sektorit të punësimit të të anketuarve, por nuk u vunë re dallime sipas vendbanimit. Femrat prireshin më shumë të besonin se sindikatat (52%) i kërkojnë llogari qeverisë. Të anketuarit e moshës 66 vjeç e sipër (83%) dhe ata me të ardhura mbi 70,001 lekë/muaj (84%) prireshin më shumë të mendonin se organizatat ndërkombëtare e bëjnë qeverinë të jetë e përgjegjshme. Për sa i përket nivelit arsimor, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar prireshin më shumë të besonin se media (65%) mund t'i kërkojë llogari qeverisë. Për ndarjen e plotë demografike të përgjigjeve, shih Tabelën 11 në fund të kapitullit.

Të anketuarit me aftësi të kufizuara ishin të mendimit se OSHC-të (52%) dhe biznesi/shoqatat e bizneseve (53%) i kërkojnë llogari qeverisë. Po ashtu, të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare prireshin më shumë se ata që nuk janë të një grupi pakice të deklarorin se OSHC-të (60%), sindikatat (57%), dhe organizatat ndërkombëtare (78%) i kërkojnë llogari qeverisë.

Krahasuar me 2020, të anketuarit prireshin më shumë të mendonin se ka mekanizma që bëjnë që qeveria të jetë e përgjegjshme. Për të gjitha institucionet e përfshira në pyetjen “Sipas jush, cila prej tyre e bën qeverinë më të përgjegjshme për veprimet/mosveprimet e saj?”, përqindja

e të anketuarve që thanë “Po” është rritur. Për më tepër, ka pasur një rritje në krahasim me 2019 për të gjitha institucionet në vend. Më konkretisht, parlamenti (+16 pp krahasuar me 2020, +10 pp krahasuar me 2019), sindikatat (+11 pp krahasuar me 2020, +9 pp krahasuar me 2019), KLSH (+10 pp krahasuar me 2020, +7 pp krahasuar me 2019) dhe biznesi/shoqatat e biznesit (+9 pp krahasuar me 2020, +11 pp krahasuar me 2019) kanë pasur një rritje të konsiderueshme në perceptimin e efektivitetit të tyre për sa i përket llogaridhënies.

Në gjashtë vitet e fundit, KLSH dhe media janë konsideruar si institucionet më efektive në vend që i kërkojnë llogari qeverisë. Që kur organizatat ndërkombëtare u përfshinë në 2019, ato janë konsideruar më së shumti si të afta për ta bërë qeverinë të japë llogari.

Tabela 9: Perceptimi i efektivitetit të mekanizmave të llogaridhënies (2016–2021)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Parlamenti	51%	63%	54%	54%	48%	64%
Deputetë të veçantë (individualisht)	X	X	X	44%	41%	47%
Kontrolli i Lartë i Shtetit	63%	67%	61%	64%	61%	71%
Partitë opozitare	51%	54%	43%	42%	38%	46%
Avokati i Popullit	54%	55%	59%	44%	44%	50%
Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	X	X	X	39%	42%	43%
Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	46%	45%	44%	41%	41%	45%
Organizatat e shoqërisë civile	46%	51%	49%	48%	45%	49%
Media	62%	65%	58%	58%	53%	62%
Bizneset / shoqata biznesi	43%	44%	40%	39%	41%	50%
Sindikatat	39%	46%	42%	41%	39%	50%
Organizatrat ndërkombëtare	X	X	X	79%	75%	77%

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 10: Ndarja demografike për transparencën dhe llogaridhënien

		Qeveria qendrore është transparente	Bashkia ime transparent	Qeveria qendrore është e përgjegjshme	Bashkia ime është e përgjegjshme
Gjithsej		41%	40%	38%	39%
Gjinia					
Meshkuj		39%	37%	35%	36%
Femra		44%	43%	40%	41%
Grupmosha					
18–25 vjeç		35%	37%	33%	33%
26–35 vjeç		41%	41%	37%	38%
36–45 vjeç		40%	40%	36%	39%
46–55 vjeç		43%	41%	40%	40%
56–65 vjeç		41%	37%	35%	37%
66 vjeç e sipër		54%	49%	48%	47%
Niveli arsimor					
Me arsim deri 8/9-vjeçar		38%	34%	35%	35%
Me arsim të mesëm		41%	40%	37%	38%
Me arsim universitar		44%	44%	40%	42%
Statusi i punësimit					
I/E punësuar	Gjithsej	45%	43%	41%	42%
	Spektori publik	64%	63%	62%	62%
	Spektori privat	36%	36%	33%	33%
I/E papunë		29%	29%	25%	29%
Student		36%	39%	33%	35%
Pensionist		53%	48%	47%	48%
Niveli i të ardhurave					
Pa të ardhura		32%	32%	27%	31%
Deri në 30,000 lekë		42%	40%	38%	40%
30,001–50,000 lekë		46%	45%	44%	44%
50,001–70,000 lekë		49%	48%	42%	43%
Mbi 70,001 lekë		41%	40%	35%	37%
Vendbanimi					
Urban		42%	41%	38%	39%
Rural		40%	38%	37%	37%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square , $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 11: Ndarja social-demografike e llogaridhënies horizontale dhe vertikale

	Parlamenti	Deputetë të veçantë	KLSH	Partitë e opozitës	Avokati i Popullit	Dhënave Personale	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi	Organizatrat e shoqërisë civile	Media	Bizneset / shoqata biznesi	Sindikatat	Organizatrat ndërkombëtare
Gjithsej (% për llogaridhënien)	64%	47%	71%	46%	50%	43%	45%	49%	62%	50%	50%	77%	
Gjinia													
Meshkuj	61%	48%	70%	46%	48%	41%	43%	48%	62%	50%	48%	78%	
Femra	67%	47%	72%	47%	51%	45%	46%	51%	61%	51%	52%	76%	
Grupmosha													
18-25 vjeç	61%	44%	71%	48%	53%	46%	48%	53%	61%	53%	51%	75%	
26-35 vjeç	63%	45%	72%	44%	49%	46%	45%	50%	62%	48%	52%	80%	
36-45 vjeç	65%	45%	73%	45%	51%	45%	45%	47%	60%	49%	47%	75%	
46-55 vjeç	66%	51%	71%	47%	47%	41%	46%	47%	63%	53%	51%	78%	
56-65 vjeç	61%	47%	67%	48%	45%	37%	39%	48%	59%	52%	45%	71%	
66 vjeç e sipër	69%	59%	68%	50%	53%	38%	41%	53%	65%	50%	56%	83%	
Niveli arsimor													
Me arsim deri 8/9-vjeçar	62%	47%	63%	44%	45%	37%	40%	48%	59%	51%	50%	73%	
Me arsim të mesëm	65%	47%	70%	47%	51%	42%	44%	49%	60%	49%	51%	78%	
Me arsim universitar	65%	48%	77%	46%	52%	48%	48%	50%	65%	52%	50%	79%	
Statusi i punësimit													
I/E punësuar	Gjithsej	66%	48%	76%	48%	52%	46%	46%	51%	64%	52%	50%	80%
	Spektori publik	75%	55%	83%	51%	60%	54%	55%	54%	66%	55%	54%	79%
	Spektori privat	61%	45%	72%	46%	48%	43%	43%	48%	62%	50%	47%	79%
I/E papunë	60%	43%	64%	42%	44%	38%	42%	46%	59%	47%	52%	71%	
Student	58%	48%	67%	47%	53%	48%	52%	50%	56%	48%	53%	72%	
Pensionist	67%	56%	64%	48%	53%	39%	42%	53%	62%	53%	55%	76%	
Niveli i të ardhurave													
Pa të ardhura	59%	44%	65%	43%	47%	41%	44%	48%	59%	49%	53%	72%	
Deri në 30,000 lekë	67%	50%	69%	49%	50%	41%	43%	51%	60%	49%	51%	78%	
30,001–50,000 lekë	67%	48%	78%	49%	54%	47%	47%	51%	67%	53%	52%	82%	
50,001–70,000 lekë	65%	51%	77%	47%	50%	48%	47%	49%	63%	57%	48%	78%	
Mbi 70,001 lekë	62%	54%	75%	51%	48%	44%	46%	52%	62%	63%	51%	84%	
Vendbanimi													
Urban	62%	48%	73%	45%	51%	45%	46%	48%	62%	50%	50%	78%	
Rural	68%	45%	67%	50%	46%	39%	42%	52%	60%	51%	50%	75%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur diferencat që vihen re mes kategorive të ndryshoreve janë statistikisht të konsiderueshme (testi Chi-kvadrat i pavarësisë, $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.3 KORRUPSIONI NË INSTITUCIONET PUBLIKE

Korrupsioni – abuzimi i postit publik për përfitime private – klasifikohet në korrupsionin i vogël (korrupsioni i nivelit të ulët) dhe korrupsionin e madh (korrupsioni i nivelit të lartë). Korrupsioni i nivelit të ulët i referohet abuzimit të pushtetit që i është besuar një zyrtari publik në marrëdhëniet me qytetarët; ndërkohë që korrupsioni i nivelit të lartë është abuzimi i pushtetit të nivelit të lartë që u sjell fitime një grupi të vogël njerëzish në kurriz të shumicës dhe u shkakton dëm serioz dhe të gjithanshëm individëve dhe shoqërisë.¹¹

Çdo vit, në sondazh bëhen të njëjtat pyetje për të matur nivelin e përhapjes së korrupsionit të nivelit të lartë dhe të ulët, nivelin e besimit në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit si dhe institucionin më të korruptuar; nëse kanë qenë dëshmitarë të ndonjë rasti korrupsioni në institucionet publike; cilin institucion rendisin si më të korruptuar; nëse kanë marrë shërbime prej qeverisë qendrore apo vendore; dhe nëse kanë paguar rryshfet tek ndonjë zyrtar publik.


Perceptimet për përhapjen e korrupsionit

Shumica e shqiptarëve mendojnë se korrupsioni i nivelit të lartë dhe ai i nivelit të ulët është 'i përhapur' dhe 'shumë i përhapur'. 83.1% e të anketuarve raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është 'i përhapur' dhe 'shumë i përhapur'; dhe 83.7% thanë se korrupsioni i nivelit të lartë është 'i përhapur' dhe 'shumë i përhapur'. Pesë institucionet të konsideruara si më të korruptuarat në 2021 ishin institucionet gjyqësore ndjekur nga institucionet e kujdesit shëndetësor, administrata publike, institucionet vendore dhe policia.

Të anketuarit u pyetën për të vlerësuar përhapjen e korrupsionit të nivelit të lartë dhe atij të nivelit të ulët në një shkallë me katër pikë nga 1 (aspak i përhapur) në 4 (shumë i përhapur). U bënë krahasime mes korrupsionit të nivelit të ulët dhe atij të lartë.

Shumica dërrmuese e të anketuarve (83.1%) raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur. Ndërkohë, 15.3% raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët nuk është i përhapur ose aspak i përhapur. Për sa i përket korrupsionit të nivelit të lartë në 2021, 83.7% e të anketuarve raportuan se ai është i përhapur ose shumë i përhapur me 14.4% të të anketuarve që raportojnë se korrupsioni i nivelit të lartë nuk është i përhapur ose aspak i përhapur.

Figura 19: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit 2021



Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët (N = 2500); Korrupsioni i nivelit të lartë (N = 2500).

11 Për një përkufizim të saktë të korrupsionit të nivelit të lartë dhe korrupsionit të nivelit të ulët shihni Fjalori i Korrupsionit i Transparency International: <https://www.transparency.org/en/corruptionary>

Për sondazhin e vitit 2021, krahasimet mes të anketuarve sipas gjinisë, grupmoshës, dhe nivelit arsimor nuk evidentuan dallime të rëndësishme për sa i përket perceptimit të përhapjes së korrupsionit të nivelit të ulët. Dallime të tilla janë të pranishme vetëm kur analizojmë statusin e punësimit, vendbanimin, përkatësinë në pakicat kombëtare dhe nivelin e të ardhurave. 86% e të anketuarve të papunë raportuan se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur; ndërsa ata që punojnë në sektorin privat (85%) prireshin më shumë të deklaronin se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur, në krahasim me punonjësit e sektorit publik (75%). Po ashtu, 87% e të anketuarve pa të ardhura të rregullta mujore mendonin se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur. Ndërkohë, për sa i përket vendbanimit, të anketuarit që jetojnë në zonat urbane (85%) prireshin më shumë të mendonin se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur në krahasim me ata që jetojnë në zonat rurale (78%). Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (74%) ishin më pak të prirur të mendonin se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur krahasuar me ata që nuk i përkasin pakicave kombëtare (84%).

Për sa i përket përhapjes së korrupsionit të nivelit të lartë, nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore tek të anketuarit sipas grupmoshave (84% për të dy llojet e korrupsionit). Dallimet ishin të pranishme sipas grupmoshës, nivelit arsimor, sektorit të punësimit dhe të ardhurave mujore. Të anketuarit e grupmoshës 56-65 vjeç (88%) prireshin më shumë të raportonin se korrupsioni i nivelit të lartë është i përhapur ose shumë i përhapur. Në lidhje me nivelin arsimor, të anketuarit me arsim të mesëm (89%) prireshin më shumë të mendonin se korrupsioni i nivelit të lartë është i përhapur ose shumë i përhapur në krahasim me të tjerët. Për më tepër, të punësuarit në sektorin publik (86%) prireshin më shumë ta konsideronin korrupsionin e nivelit të lartë si të përhapur ose shumë të përhapur krahasuar me të punësuarit në sektorin privat (72%). Përqindja më e madhe e të anketuarve pa të ardhura të rregullta mujore dhe ata me të ardhura mujore deri në 30,000 lekë/muaj (87% në të dy kategoritë) e konsideronin korrupsionin e nivelit të lartë si të përhapur ose shumë të përhapur, krahasuar me kategoritë e tjera të të ardhurave mujore. Po ashtu, të anketuarit nga zonat urbane (85%) prireshin më shumë të mendonin se korrupsioni i nivelit të lartë është i përhapur ose shumë i përhapur në krahasim me të anketuarit nga zonat rurale (81%).

Në 2021, përqindja e të anketuarve që mendojnë se korrupsioni i nivelit të ulët është shumë i përhapur ka rënë me 5 pp krahasuar me 2020 dhe vazhdoi me trendin në rënie që nga viti 2019 (-8 pp kumulative), ndërsa përqindja e atyre që raportojnë se është i përhapur u rrit paksa krahasuar me 2020 (+1 pp) duke evidentuar një rritje kumulative prej 4 pp krahasuar me 2019. Në 2021, përqindja e të anketuarve që thonë se korrupsioni i nivelit të ulët është i përhapur ose shumë i përhapur ra në krahasim me shifrën e vitit 2017 për herë të parë, (-4 pp në 29%).

Për sa i përket korrupsionit të nivelit të lartë, në 2021, të dhënat në përgjithësi (i përhapur dhe shumë i përhapur të marrë së bashku) mbetën të njëjta si në 2020 (-2 pp krahasuar me 2019), edhe pse në kontrast me të ato të viteve të mëparshme, shifra e ‘shumë i përhapur’ ishte më e ulët.

Tabela 12: Perceptimi i përhapjes së korrupsionit (2017–2021)

		2017	2018	2019	2020	2021
Korrupsioni i nivelit të ulët	I përhapur	54%	53%	50%	53%	54%
	Shumë i përhapur	33%	34%	37%	34%	29%
Korrupsioni i nivelit të lartë	I përhapur	48%	48%	43%	42%	47%
	Shumë i përhapur	40%	41%	43%	42%	37%

Baza: Korrupsioni i nivelit të ulët, 2017 (N=1641); 2018 (N=1644); 2019 (N=2494); 2020 (N=2499); Korrupsioni i nivelit të lartë, 2017 (N=1641); 2018 (N=1644); 2019 (N=2495); 2020 (N=2499); 2021 (N=2500)

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Të anketuarve iu kërkua të jepnin mendimin e tyre se cili ishte institucioni më i korruptuar në vitin 2021. Pesë institucionet të konsideruara si më të korruptuarat në 2021 ishin institucionet gjyqësore (21.5%), ndjekur nga institucionet e kujdesit shëndetësor (19.1%), administrata publike (10.1%), institucionet vendore (8.9%) dhe policia (7.1%).

Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit


Në 2021, përqindja e shqiptarëve që nuk kishin besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit të ulët ka rënë në 59.3% (nga 64.5% in 2020). Ndërkohë, përqindja e të anketuarve që nuk kanë besim në ndjekjen penale të korrupsionit të nivelit lartë është 68.4%, i njëjtë me vitin 2020.

Të anketuarve iu kërkua të vlerësonin nivelin e besimit në ndjekjen penale të çështjeve të korrupsionit duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh - nga 1 (kam shumë besim) në 4 (nuk kam aspak besim). Pati dallime mes korrupsionit të nivelit të ulët dhe korrupsionit të nivelit të lartë.

Për korrupsionin e nivelit të ulët, 59.3% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se ‘nuk kanë besim’ ose ‘nuk kanë aspak besim’, ndërsa 38.6% thanë se ‘kanë besim’ ose ‘kanë shumë besim’ në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit.

Për korrupsionin e nivelit të lartë, rezultatet tregojnë se 68.4% e të anketuarve thanë se ‘nuk kanë besim’ ose ‘nuk kanë aspak besim’ në ndjekjen penale të këtyre rasteve, ndërkohë që 29.4% thanë se ‘kanë besim’ ose ‘kanë shumë besim’.

Figura 20: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit 2021



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë (N=2500); Korrupsioni i nivelit të ulët (N=2500).

Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët nuk kishte dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë (femrat 41% dhe meshkujt 36%) dhe vendbanimit. Por u vunë re dallime të rëndësishme sipas grupmoshës, nivelit arsimor dhe


sektorit të punësimit. Të anketuarit e grupmoshës 18–25 vjeç (31%) kishin më pak besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët në krahasim me grupmoshat e tjera. Edhe të anketuarit me nivel arsimit të ulët dhe të mesëm (37% për të dy kategoritë) kishin më pak besim në krahasim me ata me arsim universitar (43%). Për më tepër, të punësuarit në sektorin publik (58%) kishin më shumë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët krahasuar me ata që janë të punësuar në sektorin privat (35%).

Për sa i përket ndjekjes penale të korrupsionit të nivelit të lartë, ndarja sipas treguesve demografikë tregon sërish se nuk ka dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 31% dhe meshkuj 28%) dhe vendbanimit. Nga ana tjetër, dallime u vunë re mes të anketuarve sipas grupmoshës, nivelit arsimor, sektorit të punësimit dhe nivelit të të ardhurave. Të anketuarit e moshës 66 vjeç e sipër (39%) prireshin më shumë të deklaronin se kishin besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë në krahasim me të anketuarit e grupmoshave të tjera. Po ashtu, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (33%) kishin më shumë besim në krahasim me ata me nivel më të ulët arsimor (28% për dy kategoritë e tjera). Për më tepër, të punësuarit në sektorin publik (47%) kishin më shumë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë se ata të sektorit privat (25%). Për sa i përket kategorive të të ardhurave mujore, të anketuarit me të ardhura 50,001–70,000 lekë/muaj (77%) ishin më pak të prirur të besonin në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë se ata me nivele të tjera të ardhurash mujore.

Siç tregohet në Figurën 21, në 2021 përqindja e të anketuarve që thanë se kishin besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët u rrit me 5 pp krahasuar me 2020 (34%). Kjo është shifra më e lartë që nga viti 2017, duke kapur kështu një trend të lehtë në rritje nga viti 2019 dhe duke u rikuperuar nga rënia në vitin 2020. Gjithsesi, përqindja e të anketuarve që deklaruan se kanë besim ose shumë besim në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë mbeti në vlera të njëjta me ato të vitit 2020 (+2 pp krahasuar me 2019).

Që nga viti 2017, kur u prezantua si pyetje në sondazh, të anketuarit vazhdojnë të raportojnë besim më të madh në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit të nivelit të ulët krahasuar me atë të nivelit të lartë.

Figura 21: Besimi në ndjekjen penale të rasteve të korrupsionit (2017–2021)



Baza: Korrupsioni i nivelit të lartë: 2017(N=1639),2018(N=1644),2019(N=2490),2020(N=2494),2021(N=2500); Korrupsioni i nivelit të ulët: 2017(N=1639),2018(N=1644),2019(N=2461),2020(N=2496),2021(N=2500).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


Përvoja personale me rastet e korrupsionit

Rezultatet e sondazhit të opinionit të vitit 2021 tregojnë se 11% e shqiptarëve kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në qeverinë qendrore dhe 18.5% kanë parë raste të korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore.


11% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se kanë qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në qeverinë qendrore, ndërsa përqindja e atyre që kanë qenë dëshmitarë të korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore ishte 18.5%.

Figura 22: Përvoja personale me korrupsionin 2021

Në nivel qeverie qendrore



Në nivel qeverie vendore



Baza: Qeveria qendrore (N=2489); qeverisja vendore (N= 2490)

Kur shqyrtohen përgjigjet sipas treguesve demografikë, nuk vihen re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë (femra, 10%, dhe meshkuj, 12%), sektorit të punësimit, vendbanimit, përkatësisë në pakice kombëtare apo aftësisë së kufizuar kur bëhet fjalë për përvojat personale me korrupsionin në nivel qeverie qendrore.


Rezultatet tregojnë se të anketuarit e grupmoshës 36-45 vjeç (13%) prireshin më shumë të deklaronin se kishin qenë dëshmitarë të korrupsionit në nivel qeverie qendrore krahasuar me ata të moshës mbi 66 vjeç (6%). Po ashtu, të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (14%) ishin më të prirur të raportonin se kishin parë raste korrupsioni krahasuar me ata të niveleve të tjera arsimore. Të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë/muaj (27%) ishin më të prirur se të anketuarit e tjerë të deklaronin se kishin qenë dëshmitarë të rasteve të korrupsionit në nivel qeverie qendrore.

Të anketuarit meshkuj (21%) ishin më të shumtë kur raportonin se kishin qenë dëshmitarë të korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore në krahasim me femrat (16%). Të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç (22%) prireshin më shumë të deklaronin se kishin parë raste korrupsioni në krahasim me ata të moshës mbi 66 vjeç (10%). Të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (21%) deklaronin më shpesh se kishin parë raste korrupsioni në nivel vendor në krahasim me ata me arsim të mesëm (17%). Për sa i përket sektorit të punësimit, të punësuarit në sektorin privat (20%) ishin më të prirur të pranonin se kishin qenë dëshmitarë të korrupsionit në

krahasim me ata që punojnë në sektorin publik (15%). Për më tepër, të anketuarit me të ardhura të rregullta mujore mbi 70,001 lekë/muaj (36%) prireshin më shumë të kishin qenë dëshmitarë të korrupsionit në njësitë e qeverisjes vendore krahasuar me ata me nivele të tjera të ardhurash mujore.

Në Figurën 23 tregohen ndryshimet në deklaratimet si dëshmitarë të korrupsionit në të dy nivelet e qeverisjes që nga viti 2015. Rezultatet në 2021 sugjerojnë se ka pasur një rënie të rasteve të ballafaqimit me korrupsionin në nivel qendror me 4 pp krahasuar me 2020 dhe 2019 (15% për të dy vitet). Ndërsa në nivel vendor, për 2021 pati një rënie si për 2020 (-4 pp) ashtu edhe për 2019 (-2 pp), me një rënie kumulative prej 6 pp.

Figura 23: Përvoja personale me korrupsionin në nivel qendror e vendor (2015–2021)



Baza: Për qeverinë qendrore: 2015 (N=1585), 2016 (N=1633), 2017 (N=1638), 2018 (N=1631), 2019 (2487), 2020 (N=2483), 2021 (N=2489). Për qeverinë vendore: 2015 (N=1571), 2016 (N=1633), 2017 (N=1639), 2018 (N=1631), 2019 (N=2487), 2020 (N=2483), 2021 (N=2490).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.



Përhapja e ryshfetit


Gjatë 2021, 38.9% (N=973) e qytetarëve të anketuar raportuan se kishin marrë shërbime nga institucionet publike në nivel qendror. Nga këta, 34.6% (N=337) thanë se u duhej të paguanin ryshfet zyrtarëve publikë. Ndërkohë, përqindja e shqiptarëve që kishin marrë shërbime nga institucionet e qeverisjes vendore në 2021 ishte 66.9% (N=1672) dhe përqindja e atyre që raportuan se u kishin paguar ryshfet zyrtarëve vendorë ishte 29.4% (N=491).

Në 2021, 38.9% (N=973) e qytetarëve të anketuar raportuan se kishin marrë shërbime nga institucionet publike në nivel qendror gjatë 2021, ndërsa 61.1% (N=1527) nuk kishin marrë shërbime. Mes të anketuarve që kishin marrë shërbime nga institucionet e nivelit qendror, 34.6% (N=337 nga 973) thanë se i kishin paguar ryshfet një zyrtari publik për atë shërbim.

Kur shqyrtohen përgjigjet sipas treguesve demografikë, nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë (femra, 33%, dhe meshkuj, 37%), nivelit arsimor, vendbanimit, apo nivelit të të ardhurave kur bëhet fjalë për dhënien e ryshfetit në nivelin qendror të qeverisjes. Të anketuarit e grupmoshës 36-45 vjeç (41%) prireshin më shumë të deklaronin se kishin paguar ryshfet krahasuar me ata të moshës mbi 66 vjeç (19%). Nga ana tjetër, të papunët (46%), të punësuarit në sektorin privat (37%), të anketuarit me aftësi të kufizuar (49%), dhe ata


që i përkasin një pakice kombëtare (42%) ishin më shumë të prirur të thonin se kishin paguar ryshfet për një shërbim në nivel qendror të qeverisjes. Po ashtu, të anketuarit që jetojnë në zonat rurale (40%) prireshin më shumë të deklarorin se kishin paguar ryshfet sesa të anketuarit që jetojnë në zonat urbane (32%).

Figura 24: Shërbimet e marra në nivel qendror 2021



Baza: N = 2500

Figura 25: Ryshfet i paguar në nivel qendror 2021




Baza: N = 973

Për sa i përket shërbimeve të marra nga njësitë e qeverisjes vendore, 66.9% (N=1672) e të anketuarve thanë se kanë marrë shërbime, ndërkohë 33.1% (N=828) nuk kishin marrë shërbime. Mes të anketuarve që kishin marrë shërbime në nivel vendor, 29.4% (N=491) raportuan se i kishin dhënë ryshfet një zyrtari publik për atë shërbim.


Të dhënat tregojnë se të anketuarit e papunë (38%) dhe të punësuarit në sektorin privat (31%) prireshin më shumë të deklarorin se kishin paguar ryshfet për marrjen e një shërbimi në nivel vendor. Nuk u evidentuan dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore mes treguesve demografikë sipas gjinisë (femra 28% dhe meshkuj 31%), grupmoshës, nivelit arsimor, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, apo përkatësisë në një pakice kombëtare.

Figura 26: Shërbimet e marra në nivel vendor 2021



Baza: N = 2500

Figura 27: Ryshfet i paguar në nivel vendor 2021




Baza: N=1672

Krahasuar me 2020, përqindja e të anketuarve që deklaruan se kishin paguar ryshfet në institucione të nivelit qendror ishte më e lartë në 2021 (35% krahasuar me 32%), që mund të rezultuar si nga rënia në total e numrit të përdoruesve të shërbimeve (N=973 krahasuar me 1046) ashtu edhe nga rritja në numrin e atyre që deklarojnë se kanë paguar ryshfet (N=337 krahasuar me 329).

Nga ana tjetër, përqindja e të anketuarve që thonë se kanë paguar ryshfet gjatë marrjes së një shërbimi në nivel vendor ka rënë (29% krahasuar me 32% in 2020).

Figura 28: Përhapja e ryshfetit (2016–2021)



Baza: Niveli vendor: 2016 (N=838); 2017 (N=916); 2018 (N=924); 2019 (N=1744); 2020 (N=1575), 2021 (N=1672). Niveli qendror: 2016 (N=406); 2017 (N=561); 2018 (N=648); 2019 (N=1518); 2020 (N=1046), 2021 (N=973).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Arsyeja kryesore për dhënien e ryshfetit, sipas të anketuarve, ishte se u ishte kërkuar një gjë e tillë (44.9%); 24.8% thanë se kishin dhënë ryshfet për të marrë shërbime më të mira në të ardhmen, dhe 15% raportuan se kishin paguar ryshfet për të shprehur mirënjohjen e tyre të zyrtari që u kishte shërbyer. Mes atyre që zgjedhën përgjigjen ‘tjetër’, një përgjigje e zakonshme ishte “nëse paguan ryshfet, shërbimi do të ishte më i shpejtë”.

Tabela 13: Arsyet e pagimit të ryshfetit 2021

	N	%
Ma kërkuan ryshfetin	261	45%
E dhashë vetë, që të marr një shërbim më të mirë herës tjetër	144	25%
E dhashë vetë, si mirënjohje për shërbimin e marrë	87	15%
Tjetër*	89	15%
Gjithsej	581	100%

*Tjetër: “Nuk të shërbejnë nëse nuk u jep ryshfet”; “për të marrë shërbim më të shpejtë”.

Vetëm 31 të anketuar (5.3%) nga ata që kishin paguar ryshfet thanë se e kishin raportuar një gjë të tillë tek autoritetet. Të anketuarit që nuk e kishin denoncuar ryshfetin (94.7%), përmendën si arsye kryesore përgjigjen “Është e kotë të raportosh, askush nuk i kushton rëndësi” (44.5%), ndjekur nga përgjigje të tjera si “Të paguash ryshfet është diçka e zakonshme” (32.3%). Vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve (3%) thanë se “Nuk dija se ku/kujt duhet t’i drejtohesha”. Për më tepër 7% e të anketuarve u përgjigjën se kishin frikë nga hakmarrja nëse do të merrnin nismën për ta raportuar dhënien e ryshfetit.

4.4 NDIKIMI POLITIK

Vlerësimi i ndikimit politik në proceset e vendimmarrjes është me rëndësi jashtëzakonisht të madhe për shkak të potencialit të këtij ndikimi në vendimet politike dhe përfitimin e grupeve të interesit. Kjo minon pavarësinë e institucioneve publike dhe funksionimin e shoqërisë demokratike dhe dëmton besimin e qytetarëve tek qeveria. Për të gjashtin vit radhazi, të anketuarve iu kërkua të vlerësonin në një shkallë prej pesë pikësh nga 1 (nuk ndikon aspak) në 5 (ndikon jashtëzakonisht shumë) – sipas mendimit të tyre, sa ndikojnë interesat politike në agjendën e nëntë institucioneve – prokuroria, gjykatat, policia, ushtria, institucionet e shëndetit publik, institucionet arsimore, media, institucionet fetare, dhe organizatat e shoqërisë civile.

Interesat politike në agjendën e institucioneve


Prokuroria dhe gjykatat u konsideruan si institucionet më shumë të ndikuara politikisht.

Ndërkohë, institucionet fetare u perceptuan si institucionet më pak të ndikuara politikisht.

69.6% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se institucionet fetare ishin institucionet më pak të ndikuara politikisht. Pas institucioneve fetare, institucionet që u konsideruan si më të pavarurat nga ndikimi politik ishin organizatat e shoqërisë civile (49.4%), forcat e armatosura (44.5%), institucionet e arsimit publik (40%), dhe institucionet e kujdesit shëndetësor (36.3%).

Prokuroria dhe gjykatat u perceptuan si institucionet më të ndikuara politikisht. 48.3% e pjesëmarrësve në sondazh e konsideronin prokurorinë si shumë të ndikuar (20.2%) ose jashtëzakonisht të ndikuar (37.4%) nga interesat politike. Vetëm 22.4% e të anketuarve e konsideronin prokurorinë si aspak të ndikuar apo pak të ndikuar nga interesat politike. 49.1% e të anketuarve i konsideronin gjykatat si jashtëzakonisht të ndikuara ose shumë të ndikuara nga interesat politike. Vetëm 22.3% e pjesëmarrësve në sondazh mendonin se gjykatat nuk janë aspak të ndikuara ose pak të ndikuara nga interesat politike.

Figura 29: Perceptimi për ndikimin e interesave politike në agjendën e institucioneve 2021 (%)



Baza: Prokuroria (N=2495); Gjykatat (N=2495); Policia (N=2492); Forcat e armatosura (N=2475); Kujdesi shëndetësor (N=2490); Arsimi (N=2490); Media (N=2493); Institucionet fetare (N=2492); OSHC-të (N=2495).

Krahasimi demografik për perceptimin e ndikimit politik tek institucionet

Lidhja mes treguesve demografikë dhe perceptimit për ndikimin politik tek institucionet ndryshonte sipas llojit të institucionit. Gjithsesi, punonjësit e sektorit publik ishin më pak të prirur për të raportuar se agjenda e institucioneve publike ndikohet nga politika.

Të anketuarit meshkuj prireshin më shumë të deklarorin se prokuroria (52%), policia (42%), media (41%), dhe institucionet e kujdesit shëndetësor (35%) ishin ‘shumë’ ose ‘jashtëzakonisht të ndikuara’ nga politika, sesa femrat (45%, 36%, 35% dhe 29% përkatësisht). Të anketuarit e grupmoshës 66 vjeç e sipër prireshin më shumë të deklarorin se prokuroria (56%), gjykatat (59%), organizatat e shoqërisë civile (27%) janë ‘shumë të ndikuara’ ose ‘jashtëzakonisht të ndikuara’ nga politika. Të anketuarit e grupmoshës ‘46-55 vjeç’ ishin më pak të prirur të raportorin se prokuroritë (43%) janë ‘shumë të ndikuara’ ose ‘jashtëzakonisht të ndikuara’ nga politika. Ndërsa të anketuarit që i përkasin grupmoshës ‘26-35 vjeç’ ishin më pak të prirur të deklarorin se organizatat e shoqërisë civile (17%) janë ‘shumë të ndikuara’ ose ‘jashtëzakonisht të ndikuara’ nga politika dhe të anketuarit e grupmoshës 18-25 vjeç prireshin më pak të raportorin se gjykatat (45%) janë ‘shumë të ndikuara’ ose ‘jashtëzakonisht të ndikuara’ nga politika.

Punonjësit e sektorit publik prireshin më shumë të deklarorin se institucionet e listuara nuk janë ‘aspak’ ose ‘pak të ndikuar’ nga politika në krahasim me ata që punojnë në sektorin privat. Ky ishte pikërisht rasti me organizatat e shoqërisë civile (57%), institucionet fetare (75%), forcat e armatosura (54%), institucionet e kujdesit shëndetësor (50%).

Të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë/muaj prireshin më shumë se grupet e tjera të raportorin si shumë të madh ose jashtëzakonisht të madh ndikimin politik tek prokuroria (62%), mediat (41%), gjykatat (59%), policia (51%), institucionet e kujdesit shëndetësor (39%) dhe institucionet e arsimit publik (37%). Nga ana tjetër, të anketuarit me të ardhura nga 30,001 deri në 50,000 lekë/muaj ishin më pak të prirur të raportorin si shumë të madh ose jashtëzakonisht të madh ndikimin politik tek institucionet e listuara. Të anketuarit nga zonat urbane prireshin më shumë të deklarorin se të gjitha institucionet ishin shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga politika krahasuar me të anketuarit që jetojnë në zonat rurale. Të anketuarit me aftësi të kufizuara ishin më shumë të prirur të deklarorin se forcat e armatosura (32%), institucionet e kujdesit shëndetësor (35%), institucionet e arsimit publik (35%), institucionet fetare (14%) dhe OSHC-të (19%) ishin shumë ose jashtëzakonisht të ndikuara nga politika. Ashtu siç ishin të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare kur bëhet fjalë për institucionet e kujdesit shëndetësor (47%) dhe mediat (48%). Për të gjitha gjetjet sipas treguesve demografikë shih Tabelën 15 në fund të këtij kapitulli.

Krahasimi vjetor i ndikimit të interesave politike

Në 2021, perceptimi për ndikimin e politikës në agjendën e institucioneve publike ka pësuar rënie për pothuajse të gjitha institucionet e vlerësuara. Ky perceptim është rritur vetëm për OSHC-të, edhe pse fare pak (+1 pp), e dhënë që është, gjithsesi, 3 pp më e ulët krahasuar me 2019. Nëse do ta krahasonim me 2020, përqindja e të anketuarve që i konsiderojnë prokurorinë, gjykatat, policinë, forcat e armatosura, sistemin e kujdesit shëndetësor, sistemin arsimor dhe mediat si shumë të ndikuara ose jashtëzakonisht të ndikuara ra me 10, 7, 6, 3, 5, 4 dhe 4 pp përkatësisht. Kjo shifër ishte pothuajse e pakonsiderueshme për institucionet fetare (-1 pp), edhe pse më e lartë me të njëjtën vlerë krahasuar me 2019 (+1 pp). Rënia e perceptimit për ndikimin politik tek prokuroria dhe gjykatat mund të evidentohet që nga viti 2017, ndërsa për institucionet e tjera, si policia dhe mediat, rënia ka nisur që në sondazhin e vitit 2019.

Tabela 14: Institucionet që perceptohen si “shumë të ndikuara” ose “jashtëzakonisht shumë të ndikuara” nga politika (2016–2021)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Prokuroria	X	67%	60%	59%	58%	48%
Gjykatat	X	70%	63%	61%	56%	49%
Policia	46%	47%	48%	44%	45%	39%
Forcat e armatosura	33%	29%	33%	30%	29%	26%
Sistemi shëndetësor	41%	34%	36%	33%	37%	32%
Sistemi arsimor	38%	29%	34%	33%	34%	30%
Media	45%	37%	39%	45%	42%	38%
Institucionet fetare	9%	9%	12%	10%	12%	11%
OSHC-të	20%	26%	24%	23%	19%	20%

Baza: Në rendin sipas listës: 2016 (N= 1633, 1621, 1621, 1626, 1629, 1628, 1630, 1628); 2017 (N= 1615, 1616, 1611, 1608, 1615, 1613, 1612, 1614, 1615); 2018 (N= 1628, 1631, 1624, 1614, 1626, 1633, 1629, 1628, 1632); 2019 (N=2488); 2020 (N= 2490); 2021 (N= 2495, 2495, 2492, 2475, 2490, 2490, 2493, 2492, 2495).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 15: Ndarja demografike e institucioneve të ndikuara shumë ose jashtëzakonisht shumë 2021

	Prokuroria	Gjykatat	Policia	Forcat e armatosura	Sistemi shëndetësor	Sistemi arsimor	Mediat	Institucionet fetare	OSHC-të	
GJITHSEJ (% e 'shumë ose jashtëzakonisht shumë' të ndikuara)	48%	49%	39%	26%	32%	30%	38%	11%	20%	
Gjinia										
Meshkuj	52%	52%	42%	28%	35%	32%	41%	11%	21%	
Femra	45%	46%	36%	24%	29%	27%	35%	11%	18%	
Grupmosha										
18-25 vjeç	47%	45%	39%	25%	32%	31%	35%	11%	20%	
26-35 vjeç	48%	49%	40%	26%	32%	28%	39%	10%	18%	
36-45 vjeç	48%	48%	38%	26%	31%	30%	36%	11%	20%	
46-55 vjeç	43%	46%	37%	25%	32%	30%	43%	12%	20%	
56-65 vjeç	52%	53%	39%	26%	32%	29%	39%	10%	18%	
66 vjeç e sipër	56%	59%	41%	31%	35%	30%	41%	16%	27%	
Niveli arsimor										
Me arsim deri 8/9-vjeçar*	48%	48%	38%	27%	32%	30%	43%	15%	22%	
Me arsim të mesëm	49%	50%	39%	25%	32%	29%	37%	9%	18%	
Me arsim universitar	47%	48%	38%	25%	31%	30%	37%	10%	20%	
Statusi i punësimit										
I/E punësuar	Gjithsej	44%	46%	36%	23%	30%	27%	37%	10%	18%
	Sektori publik	30%	33%	25%	17%	23%	22%	30%	7%	14%
	Sektori privat	51%	52%	41%	26%	33%	29%	41%	10%	20%
I/E papunë	55%	55%	46%	31%	35%	36%	40%	14%	19%	
Student	45%	44%	41%	30%	35%	34%	33%	10%	22%	
Pensionist	53%	53%	37%	28%	33%	28%	39%	15%	22%	
Niveli i të ardhurave										
Pa të ardhura	53%	52%	44%	29%	34%	34%	38%	13%	21%	
Deri në 30,000 lekë	51%	51%	40%	30%	34%	30%	41%	13%	21%	
30,001–50,000 lekë	40%	42%	31%	17%	24%	23%	34%	7%	16%	
50,001–70,000 lekë	47%	49%	37%	25%	29%	27%	37%	10%	17%	
Mbi 70,001 lekë	62%	59%	51%	29%	38%	37%	41%	8%	19%	
Vendbanimi										
Urban	46%	47%	37%	23%	29%	27%	36%	10%	18%	
Rural	54%	55%	44%	32%	38%	35%	44%	13%	24%	

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p < 0.05$).

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyrues (8/9-vjeçar).

4.5 PJESËMARRJA QYTETARE

Angazhimi i qytetarëve në proceset e vendimmarrjes ndihmon në forcimin e qeverisjes së mirë dhe bën të mundur pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në demokraci. Pyetjet e sondazhit të përfshira në këtë kapitull nuk ndryshojnë nga ato të sondazhit të mëparshëm të opinionit të vitit 2020. Ato matin interesin e të anketuarve për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes dhe mundësitë e ofruara nga institucionet publike për të mundësuar pjesëmarrjen e qytetarëve, duke bërë dallimin mes nivelit qendror dhe atij vendor të qeverisjes. Për më tepër, të anketuarit u pyetën për pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset dhe takimet konsultuese, përdorimin e portalit të konsultimeve ‘konsultimipublik.gov.al’; pjesëmarrjen në demonstrata/ tubime dhe për nënshkrimin e peticioneve, përfshirjen në punë vullnetare për të mirën e komunitetit. Në fund, ata u pyetën edhe nëse kanë ndërmend të largohen nga vendbanimi i tyre, brenda apo jashtë Shqipërisë.




Pjesëmarrja në vendimmarrje

Interesi i qytetarëve për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucioneve publike ra edhe më shumë në 43.5% në vitin 2021 (48.6% në 2020). Për më tepër, pjesa më e madhe e qytetarëve thanë se u mungojnë mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucioneve publike në vitin 2021. Gjithsesi, ata vazhdimisht raportuan mundësi më të mëdha pjesëmarrjeje në nivel qeverisjeje vendore sesa në nivel qendror.

43.5% e të anketuarve raportuan se ishin të interesuar për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes së institucioneve publike. Krahasuar me 2020 (48.6%), përqindja e të anketuarve të interesuar për të qenë aktivë në qeverisjen e vendit ka rënë me 5.1 pikë.

Figura 30: Interesi për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse së institucioneve publike 2021




Baza: N = 2500

Të anketuarit që kishin më shumë gjasa të jenë qytetarë aktivë i përkasin grupmoshave 26–35 vjeç (50%) apo 36–45 vjeç (49%); kanë arsim universitar ose pasuniversitar (57%); apo që jetojnë në zonat rurale (47%) sesa në zonat urbane (42%). Këta njerëz janë në marrëdhënie pune (50%), më së shumti në sektorin publik (65%) dhe kanë të ardhura të rregullta mujore në nivelin 50,001 deri në 70,000 lekë (58%). Përkatësia politike është një tjetër karakteristikë, duke qenë se 63% e të anketuarve që ishin të interesuar në procese të tilla ishin anëtarë të partive politike. Të anketuarit e moshës 66 vjeç e sipër (23%), ata që kanë arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (31%), të papunët (36%), ata me të ardhura deri në 30,000 lekë/muaj (32%) apo që kanë aftësi të kufizuara (30%) ishin më pak të interesuar për të qenë aktivë në proceset e vendimmarrjes. Dallimet gjinore ishin të parëndësishme nga pikëpamja statistikore (femra 42% dhe meshkuj 45%). Shihni Tabelën 17 në fund të kapitulli më shumë hollësi për ndarjen demografike.

72.2% e të anketuarve mendonin se mundësitë për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes në nivel të qeverisjes qendrore nuk janë të mjaftueshme – ashtu si me rezultatet e sondazhit të 2020 (72%). Edhe në nivel vendor, 61.9% e të anketuarve besonin se nuk kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes publike, sërish njësoj si me rezultatet e sondazhit 2020 (61.2%).

Figura 31: Mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen e institucioneve publike 2021



Baza: Për qeverinë qendrore (N=2490); Për qeverinë vendore (N=2494).


Gjinia (femra 28% dhe meshkuj 28% për qeverinë qendrore; femrat 37% dhe meshkuj 39% për qeverinë vendore), vendbanimi, dhe përkatësia në një grup etnik duket se nuk luajnë rol në vlerësimin nga të anketuarit për mundësitë për të marrë pjesë në vendimmarrjen në nivel vendor apo qendror. Gjithsesi, vihen re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore mes të anketuarve sipas grupmoshës, nivelit arsimor, statusit të punësimit dhe nivelit të të ardhurave.

Të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç prireshin më shumë për të raportuar se kishin mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrjen qendrore (34%) dhe atë vendore (46%); siç ishin edhe të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (40% për nivelin qendror dhe 52% për nivelin vendor), krahasuar me të anketuarit që kanë arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (17% për nivelin qendror dhe 25% për nivelin vendor). Të anketuarit e punësuar, veçanërisht ata në sektorin publik kishin prirjen të raportonin më shpesh për mundësitë e mjaftueshme në të dy nivelet – 45% për nivelin qendror dhe 63% nivelin vendor. Të anketuarit me të ardhura mujore prej 50,001 deri në 70,000 lekë ishin më pozitivë për mundësitë e mjaftueshme për pjesëmarrje në vendimmarrjen qendrore (40%) dhe atë vendore (51%), krahasuar me ata që kanë të ardhura mbi 70,000 lekë/muaj (37% për nivelin qendror dhe 44% për atë vendor). Të anketuarit me aftësi të kufizuara ishin më pak të prirur të mendonin se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes si në nivelin qendror (14%) ashtu edhe atë vendor (19%).

Në përgjithësi, perceptimet e të anketuarve për mundësitë e mjaftueshme për pjesëmarrje në vendimmarrjen vendore ishin dukshëm më të mëdha se për nivelin qendror. *Shihni Tabelën 17 në fund të kapitullit për informacione më të hollësishme.*

Në Figurën 32 tregohen ndryshimet në përqindjen e të anketuarve që raportuan se kanë mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje si në nivel qendror ashtu edhe atë vendor gjatë periudhës 2016-2021. Perceptimi për pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë qendrore në 2021 ka mbetur pak a shumë i njëjtë si në sondazhin e 2020, d.m.th., me një rënie të vogël prej 1 pp që nga 2019. Për të njëjtën periudhë kohore, 2019-2021, mundësitë e perceptuara për të marrë pjesë në vendimmarrjen e nivelit vendor kanë pësuar një rënie graduale (41% në 2019, 39% në 2020 dhe 38% në 2021), edhe pse këto mundësi kanë qenë vazhdimisht më të mëdha sesa për pjesëmarrjen në vendimmarrjen qendrore gjatë gjithë viteve 2016–2021.

Figura 32: Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje (2016–2021)



Baza: Qeveria qendrore: 2016 (N=1633); 2017 (N=1634); 2018 (N=1630); 2019 (N=2480); 2020 (N = 2482); 2021 (N = 2490). Qeveria vendore , 2016 (N=1634); 2017 (N=1630); 2018 (N=1638); 2019 (N=2463); 2020 (N = 2491); 2021 (N = 2494).

Shënim: Në 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


Proceset e konsultimit

9.7% e shqiptarëve të anketuar thanë se ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga institucionet publike në nivel qendror dhe 17.8% në nivel vendor në vitin 2021. 7.4% të anketuarve kanë marrë pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga qeveria qendrore dhe 14.5% nga njësitë e qeverisjes vendore. Një përqindje më e madhe e të anketuarve (16.6% në 2021 krahasuar me 12.9% në 2020) kishin përdorur portalin ‘www.konsultimipublik.gov.al’ për t’u informuar ose konsultuar për projektligje apo projekt strategjitë/planet e veprimit në nivel qendror.

9.7% e të anketuarve raportuan se ishin ftuar të merrnin pjesë në proceset e konsultimit të organizuar nga institucionet publike në nivel qendror dhe 17.8% në nivel vendor në vitin 2021.

Siç tregohet në Figurën 33 më poshtë, raportimi për ftesa për pjesëmarrje në proceset e konsultimit në nivel vendor ka qenë vazhdimisht më i madh sesa për nivelin qendror të qeverisjes që nga viti 2016. Gjithsesi, ftesat për të marrë pjesë në konsultimet publike kanë pësuar një rënie të vazhdueshme në të dy nivelet e qeverisjes për tre vitet e fundit.

Figura 33: Ftesat për të marrë pjesë në proceset e konsultimit (2016–2021)




Baza: Niveli vendor: 2016 (N=1624), 2017 (N=1635), 2018 (N=1629), 2019 (N=2482), 2020 (N=2486); 2021 (N=2494). Niveli qendror: 2016 (N=1631), 2017 (N=1635), 2018 (N=1630), 2019 (N=2483), 2020 (N=2486), 2021 (N=2494).

Shënim: Në 2019, metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


Pjesëmarrja e qytetarëve në konsultimet publike mbeti shumë e ulët në 2021. Pavarësisht ftesës, 7.4% e të anketuarve raportuan se kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit të organizuara nga qeveria qendrore, krahasuar me 8.3% në 2020. 14.5% e të anketuarve raportuan se kishin marrë pjesë në proceset e konsultimit vendor, ndërsa 15.9% kishin marrë pjesë në 2020.

Figura 34: Pjesëmarrja në takime konsultimi 2021

Në qeverisjen qendrore



Në qeverisjen vendore



Baza: Qeveria qendrore (N=2442); Qeveria vendore (N=2463).

Arsyeja kryesore për mungesën e pjesëmarrjes ishte mosbesimi ndaj takimeve konsultuese (29.3%). Kjo arsye ndiqej nga pritshmëria që duhet të marrin pjesë të tjerët (22.6%), dhe besimi se nuk ka mekanizma konsultimi (22.3%). Arsye të tjera si mungesa e informacionit për temën që do

të diskutohej (9.8%) dhe vështirësitë për të ndjekur takimet e konsultimit (10%) u përmendën më pak si arsye për mospjesëmarrje në proceset e konsultimit.


Tabela 16: Arsyet për mospjesëmarrje në takimet e konsultimit në vitin 2021

	N	%
Mendoj që duhet të shkojnë të tjerët	475	22.6%
Nuk besoj tek këto procese konsultuese	618	29.3%
Nuk kam pasur informacion mbi temën që diskutohej	206	9.8%
Nuk kisha mundësi të shkoja tek vendi i takimit ose të aksesoja online takimin konsultues	210	10%
Mendoj se nuk ka mekanizma apo procese konsultuese	469	22.3%
Tjetër*	128	6.1%

* Përgjigje të shpeshta në kategorinë “tjetër” ishin: nuk dija kohën, vendin dhe arsyen e takimit konsultues, mungesa e ftesës për pjesëmarrje, vetëvlerësimi i ulët i njerëzve, mungesa e arsimit të nevojshëm për të ndjekur këto takime, mungesa e interesit, apo mosha e thyer.

16.6% e të anketuarve kishin përdorur portalin ‘www.konsultimipublik.gov.al’ për të marrë informacione ose për të dhënë mendimin e tyre për nismat ligjore apo projekt-strategjitë/planet e veprimit, përqindje më e lartë se 12.9% në 2020.

Figura 35: Përdorimi i portalit “konsultimipublik.gov.al” 2021



Baza: N = 2500

Të anketuarit në grupmoshën 26-35 vjeç (24%), ata me arsim universitar ose pasuniversitar (26%), të punësuarit në sektorin publik (30%), ata me të ardhura 50,001 deri në 70,000 lekë/muaj (31%) dhe mbi 70,000 lekë/muaj (32%), prireshin më shumë të deklaronin se kishin përdorur portalin 'www.konsultimipublik.gov.al'. Të anketuarit me aftësi të kufizuara ishin shumë më pak të prirur për ta përdorur këtë portal (8%). Dallimet sipas gjinisë ishin të pakonsiderueshme (femra 17% dhe meshkuj 16%) nga pikëpamja statistikore. *Shihni Tabelën 18 për më shumë informacione për dallimet sipas karakteristikave demografike.*



Pohimet për pjesëmarrjen qytetare

Shumica e shqiptarëve (71.7%) besojnë se qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse vendimet e qeverisë janë të mira apo të këqija. Gjithsesi, 63.2% e të anketuarve i konsideronin dëgjesat publike vendore si ngjarje formale, ndërkohë, 40.3% besojnë se institucionet publike marrin në konsideratë sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile. 38.8% janë dakord se këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin dhe 33% konstatuan se prioritetet e qytetarëve reflektohen në buxhetin e bashkisë.

71.7% e të anketuarve (71.2% në 2020) ishin plotësisht dakord ose përgjithësisht dakord me pohimin 'një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq.' Nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore në perceptimet e të anketuarve sipas gjinisë (femra 70% dhe meshkuj 74%), grupmoshës, nivelit arsimor apo vendbanimit. Pensionistët (77%), të punësuarit në sektorin publik (76%), të anketuarit me të ardhura 30,001–50,000 lekë/muaj (76%), dhe ata që banojnë në bashki të mëdha (74%),¹² prireshin më shumë të ishin dakord me këtë pohim.

40.3% e të anketuarve ishin plotësisht dakord ose përgjithësisht dakord me pohimin 'sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile merren në konsideratë' (38% në 2020). Të anketuarit e moshës 66 vjeç e sipër (46%), ata me arsim universitar ose pasuniversitar (44%), të punësuarit në sektorin publik (61%), të anketuarit me të ardhura mujore 50,000 deri në 70,000 ALL (50%), dhe ata që banojnë në bashki të mëdha (43%) prireshin më shumë të ishin dakord me këtë pohim. Si për kontrast, brezi i ri, d.m.th., 18-25 vjeç (34%), ata me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (36%), të papunët (28%) dhe ata pa të ardhura të rregullta mujore (29%) ishin më pak të prirur të binin dakord me pohimin. Dallimet sipas gjinisë ishin të parëndësishme nga pikëpamja statistikore (femra 41% dhe meshkuj 40%).

63.2% e të anketuarve të këtij sondazhi (64.8% në 2020) ishin dakord ose përgjithësisht dakord se 'dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale'. Nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 63% dhe meshkuj 63%), grupmoshës, nivelit të të ardhurave, vendbanimit apo madhësisë së bashkisë. Po të marrim në konsideratë karakteristikat e tjera, të punësuarit në sektorin privat (67%) prireshin më shumë të ishin dakord me këtë pohim se sa të anketuarit e punësuar në sektorin publik (55%). Po ashtu, të anketuarit me diplomë të shkollës së lartë (66%) prireshin më shumë të ishin dakord sesa ata me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (59%).




¹² Sipas popullsisë rezidente, bashkitë ndahen në bashki të vogla (<=50,000), të mesme (50,000-<=100,000), të mëdha (>100,000).

Një përqindje më e madhe e të anketuarve (38.8%) krahasuar me sondazhin e vitit 2020 (34.6%) ishin dakord ose përgjithësisht dakord se ‘këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin’. Punonjësit e sektorit publik (62%), të anketuarit me të ardhura 50,001 deri në 70,000 lekë/muaj (46%) apo ata me arsim universitar (43%) prireshin më shumë të ishin dakord me këtë pohim. Nga ana tjetër, të anketuarit e papunë (32%), studentët (33%), ata me aftësi të kufizuara (31%), anëtarët e pakicave kombëtare (35%) dhe të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,001 ALL (29%) ishin të gjithë më pak të prirur të binin dakord me këtë pohim. Dallimet sipas gjinisë të parëndësishme nga pikëpamja statistikore (femra 40% dhe meshkuj 38%).

Një përqindje e përafërt (33%) e të anketuarve si në 2020 (32%) ishin dakord ose përgjithësisht dakord se ‘buxheti i bashkisë ku ata banojnë reflekton prioritetet e qytetarëve’. Treguesit demografikë të të anketuarve që prireshin më shumë të ishin dakord me këtë pohim janë ata me arsim universitar (38%), ata të punësuar në sektorin publik (56%), ata me të ardhura mujore 50,001 deri në 70,000 lekë (41%) dhe ata që banojnë në zonat urbane (35%). Të anketuarit me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (27%), të papunët (22%) dhe ata pa të ardhura (25%) ishin më pak të prirur të binin dakord me pohimin. Sërish nuk kishte dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 34% dhe meshkuj 32%). *Shihni Tabelën 19 për të dhëna më të hollësishme për dallimet sipas treguesve demografikë.*

Figura 36: Pohimet për përfaqësimin vendor dhe angazhimin qytetar 2021




Baza: Buxheti i bashkisë (N=2500); këshilltarët përfaqësojnë komunitetin (N=2500); dëgjesat publike (N=2500); sugjerimet merren në konsideratë (N=2500); qytetarët kanë njohuri të mjaftueshme (N=2500).

Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni

Një numër më i madh qytetarësh (27.1%) kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në vitin 2021 krahasuar me 22% në 2020. Të anketuarit në grupmoshën 18-25 vjeç dhe ata me arsim universitar apo pasuniversitar, studentët, të anketuarit e punësuar me të ardhura mujore 50,001 deri në 70,000 lekë dhe anëtarët e partive politike ishin më të predispozuar për të raportuar se kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo të kenë nënshkruar një peticion në vitin 2021.

27.1% e të anketuarve kanë marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo kanë nënshkruar një peticion në 2021, duke shënuar një rritje krahasuar me 2020 (+5 pp).

Figura 37: Pjesëmarrja në një demonstratë/tubim apo nënshkrimi i një peticioni në 2021



Baza: N = 2500

Analiza e gjetjeve sipas treguesve demografikë të të anketuarve, si gjinia (femra 27% dhe meshkuj 27%), aftësia e kufizuar, përkatësia në pakice kombëtare, sektori i punësimit dhe vendbanimi nuk evidentoi dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore. Të anketuarit që prireshin më shumë të merrnin pjesë në demonstrata dhe peticione në 2021 i përkisnin grupmoshës 18-25 vjeç (35%), ishin studentë (35%), kishin arsim universitar ose pasuniversitar (34%), ishin anëtarë të partive politike (38%) dhe kishin kryesisht të ardhura mujore prej 50,001-70,000 lekë (32%). Brezat më të vjetër në moshë, veçanërisht të anketuarit 66 vjeç e sipër (9%), ata me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (22%) dhe ata me të ardhura deri në 30,000 lekë/muaj (20%) ishin përkatësisht më pak të prirur të kishin marrë pjesë në një demonstratë/tubim apo të kishin nënshkruar një peticion në 2021. Përkatësia në një parti politike nuk bën dallime të rëndësishme në pjesëmarrjen e të anketuarve të këtij sondazhi në demonstratë/tubim apo për nënshkrimin e një peticioni në 2021.

‘Interesi i përbashkët i komunitetit ku jetoj’ (53.2%) ishte arsyeja më e shpeshtë për pjesëmarrjen në një demonstratë/tubim apo për nënshkrimin e një peticioni në 2021 (53.9% në 2020). Arsyeja


e dytë më e shpeshtë (26.7%) ishte ‘interesi personal’ (25.7% në 2020), ndjekur nga ‘Militantizmi (për mbështetje politike)’ (13.8% në 2021 dhe 11.8% në 2020), dhe ‘Presioni i shokëve/të njohurve’ (3.4% në 2021 dhe 6.6% në 2020). 2.8% e të anketuarve shprehën arsye të palistuarra për pjesëmarrjen në një protestë/tubim apo për nënshkrimin e një peticioni.

Gatishmëria për t’u angazhuar në punë vullnetare

Shumica e shqiptarëve të anketuar (65.1%) ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare. Brezi i ri, studentët, të diplomuarit universitarë dhe të punësuarit në sektorin publik prireshin më shumë të raportonin se janë të gatshëm për t’u angazhuar në punë vullnetare për të mirën e komunitetit.

65.1% e të gjithë të anketuarve thanë se ishin të gatshëm të angazhoheshin në punë vullnetare për të mirën e komunitetit. Në 2021, përqindja e të anketuarve që deklaruan vullnetin e tyre për t’i shërbyer komunitetit vullnetarisht vazhdoi tendencën saj në rënie (65% krahasuar me 66% në 2020), duke kontribuar kështu në një rënie kumulative prej 13 pp krahasuar me të dhënat e 2019 (78%).

Figura 38: Gatishmëria për t’u angazhuar në punë vullnetare 2021



Baza: N = 2488


Treguesit demografikë të të anketuarve që janë më të prirur të bëjnë punë vullnetare përfshijnë grupmoshën 18-25 vjeç (75%), studentët (71%) ata me diplomë universitare (76%), ata të punësuar më së shumti në sektorin publik (81%) dhe ata me të ardhura 50,001-70,000 lekë (76%) në muaj. Karakteristikat sipas gjinisë (femra 67% dhe meshkuj 64%), vendbanimit dhe përkatësisë në pakice kombëtare nuk evidentuan dallime të të rëndësishme nga pikëpamja statistikore në vullnetin e pjesëmarrësve për t’u angazhuar në punë vullnetare.

Largimi nga vendbanimi aktual

41% e qytetarëve shqiptarë shprehën dëshirën për të shkuar në një shtet tjetër në 2021. Përqindja e atyre që duan të lëvizin brenda vendit ishte 4% në 2021. Të anketuarit e grupmoshës 18-25 vjeç, veçanërisht studentët, ata me diplomë universitare dhe ata të punësuar në sektorin privat prireshin më shumë të shprehnin dëshirën në 2021 për t'u larguar nga Shqipëria.

Një përqindje më e vogël të anketuarish (41%) raportuan se donin të shkonin në një shtet tjetër në 2021 krahasuar me 2020 (44%) – që gjithësi përfaqëson rreth 2/5 e popullsisë rezidente në Shqipëri. Dëshira për migrim të brendshëm ishte rreth 4% në 2021, krahasuar me 4.8% në 2020. Ndërkohë, 54.9% e të anketuarve nuk donin të largoheshin nga vendbanimi i tyre aktual.

Figura 39: Largimi nga vendbanimi aktual 2021



Baza: N = 2495

Dëshira për të migruar brenda vendit nuk ndryshonte ndjeshëm sipas gjinisë (femra 4% dhe meshkuj 4%). Përveç brezave më të vjetër se 66 vjeç që ishin më pak të gatshëm për të migruar (1%), të gjithë të anketuarit e tjerë nën 65 vjeç kishin prirje të ngjashme për t'u larguar drejt një qarku tjetër në vend (4% deri në 5%). Të anketuarit me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (5%), studentët (6%) dhe ata me aftësi të kufizuara (5%) ishin më të prirur të lëviznin brenda vendit.

Nga ana tjetër, profilet demografike të të anketuarve që prireshin më shumë të largoheshin nga Shqipëria, ishin kryesisht të grupmoshës 18-25 vjeç (64%), me arsim universitar (49%), ata të punësuar në sektorin privat (47%), studentët (61%), dhe ata pa të ardhura të rregullta mujore (52%). Të anketuarit më të vjetër në moshë, veçanërisht ata të moshës mbi 66 vjeç (7%), dhe të anketuarit me aftësi të kufizuara (24%) prireshin më shumë të deklarorin se nuk donin të largoheshin nga vendi. Nuk u raportuan dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 40% dhe meshkuj 42%), vendbanimit apo përkatësisë etnike.

Arsyet kryesore për largimin drejt një shteti tjetër ishin: faktorët ekonomikë (N=305; dëshira për një jetë më të mirë (N=229); pasuar nga qeverisja e keqe, korrupsioni, apo mungesa e drejtësisë (N=55); dhe nevoja për një arsim më të mirë (N=47). Arsye të tjera më pak të përmendura ishin siguria dhe krimi, bashkimi familjar me anëtarë të familjes që jetojnë jashtë vendit dhe shërbime më të mira shëndetësore.

Tabela 17: Ndarja demografike – interesi dhe mundësitë e mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje 2021

		Interesi për të marrë pjesë në proceset e vendimmarrjes	Mundësi të mjaftueshme për të marrë pjesë në vendimmarrje	
			Qeveria qendrore	Qeveria vendore
Gjithsej		44%	28%	38%
Gjinia				
Femra		42%	28%	37%
Meshkuj		45%	28%	39%
Grupmosha				
18-25 vjeç		48%	30%	39%
26-35 vjeç		50%	34%	46%
36-45 vjeç		49%	31%	44%
46-55 vjeç		41%	26%	35%
56-65 vjeç		31%	17%	25%
66 vjeç e sipër		23%	14%	22%
Niveli arsimor				
Me arsim deri 8/9-vjeçar		31%	17%	25%
Me arsim të mesëm		39%	23%	33%
Me arsim universitar		57%	40%	52%
Statusi i punësimit				
I/E punësuar	Gjithsej	50%	34%	45%
	Sektori publik	65%	45%	63%
	Sektori privat	43%	28%	37%
I/E papunë		36%	22%	31%
Student		49%	28%	36%
Pensionist		25%	15%	20%
Niveli i të ardhurave				
Pa të ardhura		37%	21%	29%
Deri në 30,000 lekë		32%	23%	29%
30,001 – 50,000 lekë		53%	32%	46%
50,001 – 70,000 lekë		58%	40%	51%
Mbi 70,001 lekë		51%	37%	44%
Vendbanimi				
Urban		42%	28%	38%
Rural		47%	28%	37%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square , $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 18: Ndarja demografike e proceseve të konsultimeve në 2021

		Ftesa për të marrë pjesë në konsultime në 2021		Pjesëmarrja në konsultime në 2021		Përdorimi i portalit www.konsultimipublik.gov.al
		Në nivel qendror	Në nivel vendor	Në nivel qendror	Në nivel vendor	
Gjithsej		10%	18%	7%	14%	17%
Gjinia						
Femra		11%	18%	8%	15%	17%
Meshkuj		9%	17%	7%	14%	16%
Grupmosha						
18-25 vjeç		11%	16%	8%	12%	18%
26-35 vjeç		12%	22%	10%	19%	24%
36-45 vjeç		11%	21%	9%	17%	18%
46-55 vjeç		9%	17%	7%	13%	17%
56-65 vjeç		7%	14%	4%	10%	7%
66 vjeç e sipër		2%	8%	1%	7%	4%
Niveli arsimor						
Me arsim deri 8/9-vjeçar		5%	11%	3%	9%	8%
Me arsim të mesëm		7%	14%	5%	11%	13%
Me arsim universitar		16%	26%	13%	22%	26%
Statusi i punësimit						
I/E punësuar	Gjithsej	13%	23%	10%	18%	22%
	Sektori publik	22%	42%	20%	35%	30%
	Sektori privat	8%	15%	5%	11%	17%
I/E papunë		7%	12%	5%	10%	12%
Student		10%	13%	7%	12%	17%
Pensionist		3%	9%	1%	8%	5%
Niveli i të ardhurave						
Pa të ardhura		7%	11%	5%	10%	12%
Deri në 30,000 lekë		5%	10%	2%	8%	9%
30,001 – 50,000 lekë		13%	25%	10%	20%	21%
50,001 – 70,000 lekë		17%	29%	16%	24%	31%
Mbi 70,001 lekë		21%	27%	15%	23%	32%
Vendbanimi						
Urban		11%	19%	8%	16%	18%
Rural		8%	15%	5%	12%	14%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 19: Ndarrja demografike e pohimeve për pjesëmarrjen/angazhimin qytetar në 2021

	Një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq	Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë	Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale	Këshilltarët e bashkisë e përfaqësojnë komunitetin	Buxheti i bashkisë ku unë banoj reflekton prioritetet e qytetarëve	
Gjithsej (% e dakordësisë)						
Gjinia						
Femra	70%	41%	63%	40%	34%	
Meshkuj	74%	40%	63%	38%	32%	
Grupmosha						
18-25 vjeç	68%	34%	65%	35%	30%	
26-35 vjeç	72%	43%	64%	38%	35%	
36-45 vjeç	72%	42%	62%	44%	33%	
46-55 vjeç	70%	39%	63%	38%	33%	
56-65 vjeç	71%	38%	65%	35%	29%	
66 vjeç e sipër	80%	46%	60%	43%	37%	
Niveli arsimor						
Me arsim deri 8/9-vjeçar	69%	36%	59%	36%	27%	
Me arsim të mesëm	73%	40%	66%	37%	32%	
Me arsim universitar	71%	44%	63%	43%	38%	
Statusi i punësimit						
I/E	Gjithsej	74%	45%	64%	43%	37%
punësuar	Sektori publik	76%	61%	55%	62%	56%
	Sektori privat	73%	38%	67%	35%	29%

	Një qytetar i thjeshtë ka njohuri të mjaftueshme për të kuptuar nëse një vendim i qeverisë është i mirë apo i keq	Sugjerimet që vijnë nga shoqëria civile dhe grupet e interesit mbi projektligjet, në përgjithësi, merren në konsideratë	Dëgjesat publike vendore janë ngjarje formale	Këshilltarët e bashkisë përfaqësojnë komunitetin	Buxheti i bashkisë ku unë banoj reflekton prioritetet e qytetarëve
Gjithsej (% e dakordësisë)					
I/E papunë	64%	28%	61%	32%	22%
Student	67%	34%	67%	33%	35%
Pensionist	77%	46%	60%	41%	37%
Niveli i të ardhurave					
Pa të ardhura	66%	29%	64%	31%	25%
Deri në 30,000 lekë	71%	39%	63%	38%	31%
30,001 – 50,000 lekë	76%	47%	66%	45%	40%
50,001 – 70,000 lekë	74%	50%	61%	46%	41%
Mbi 70,001 lekë	76%	43%	68%	29%	30%
Vendbanimi					
Urban	71%	41%	63%	40%	35%
Rural	74%	40%	64%	35%	28%
Madhësia e bashkisë					
E vogël	71%	39%	66%	41%	30%
E mesme	66%	33%	61%	37%	33%
E madhe	74%	43%	63%	39%	34%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbanuar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.6 KËNAQSHMËRIA ME OFRIMIN E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Që nga viti 2013, sondazhi i opinionit publik ka matur në një kapitull të veçantë kënaqshmërinë e qytetarëve me ofrimin e shërbimeve publike. Numri i shërbimeve të listuara ka ndryshuar me kalimin e viteve. Në 2021, lista u rrit me një shërbim tjetër duke arritur në total 17 shërbime publike bazë dhe administrative. Në shërbimet bazë përfshihen shërbimet e shëndetit publik, shërbimet e arsimit publik (përfshirë atë parashkollor), furnizimi me ujë të pijshëm, transporti publik, shërbimet e pastrimit (të qytetit, fshatit, përfshirë edhe mbledhjen e mbetjeve), shërbimet e emergjencave (zjarrfikësja, ambulanca etj.), shërbimet gjyqësore, shërbimet e policisë. Për të vlerësuar më mirë kënaqshmërinë me shërbimet e emergjencave, ato u ndanë në “Shërbimet e emergjencave: ambulanca” dhe “Shërbimet e emergjencave: zjarrfikësja”, duke bërë të mundur një vlerësim të veçantë për të dy. Në shërbimet administrative bëjnë pjesë shërbimet e ndihmës sociale, shërbimet e punësimit (Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive AKPA, ish-SHKP), shërbimet e pronësisë (Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK, ish-Hipoteka dhe ALUIZNI), shërbimet e gjendjes civile, shërbimet e sigurimeve shoqërore (Instituti i Sigurimeve Shoqërore ISSH), shërbimet e transportit rrugor (Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor DPSHTRR), regjistrimi dhe licencimi i biznesit (Qendra Kombëtare e Biznesit QKB), lejet e ndërtimit. Për të vlerësuar lehtësinë e marrjes së shërbimeve administrative, në këtë sondazh u fut një pyetje e re.

Pyetjet e tjera u fokusuan në ankesat e të anketuarve për shërbimin e ofruar, kanalet për të bërë ankesa si platforma e bashkëqeverisjes www.shqiperiaqeduam.al, dhe përgjigja nga ofruesit e shërbimeve publike. Të anketuarit e këtij sondazhi u pyetën nëse kishin vizituar sportelet e Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe të jepnin vlerësimin e tyre se sa të kënaqur ishin me shërbimin që kishin marrë. Në këtë pjesë jepet edhe vlerësimi i qytetarëve të pyetur.



Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë

41.9% e qytetarëve ishin të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë në 2021. Shërbimi arsimor, shërbimi i pastrimit dhe shërbimi i emergjencave mjekësore u raportuan më së shumti si të kënaqshme, ndërsa shërbimi policor, transporti publik, dhe shërbimet gjyqësore ishin më pak të kënaqshme.


Mesatarisht,¹³ 41.9% e të anketuarve ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me shërbimet publike bazë që kishin marrë qytetarët (38% në 2020; 41.5% në 2019), ndërsa 52.2% ishin ‘të pakënaqur’ dhe ‘shumë të pakënaqur’ më shërbimet e ofruara. Kënaqshmëria mesatare për shërbimet publike bazë u rikuperua në 2021 dhe arriti nivelin që kishte para pandemisë të raportuar në 2019.

53.3% e të anketuarve raportuan se ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me shërbimet e arsimit publik, përfshirë atë parashkollor, ndjekur nga 48.3% e të anketuarve që ishin të kënaqur me shërbimin e pastrimit, përfshirë edhe mbledhjen e mbetjeve. Niveli i kënaqësisë me shërbimin e emergjencave mjekësore ishte më i lartë (46%) se ai për shërbimet shëndetësore publike në përgjithësi (42%). Shërbimi policor (37.4%), transporti publik (32.6%) dhe shërbimet gjyqësore (27.2%) mbetën si shërbimet publike bazë me vlerësimin më të ulët nga qytetarët shqiptarë gjatë 2021. Për vlerësimin e të gjitha shërbimeve publike bazë shihni Figurën 40.



13 Mesatarja e vlerësimit të kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet publike bazë të marra së bashku.

Figura 40: Kënaqshmëria me shërbimet publike bazë 2021



Baza: Kujdesi shëndetësor (N = 2471); Arsimi (N = 2429); Ujësjetllësi (N = 2486); Transport publik (N = 2480); Pastrimi (N = 2477); Emergjencat - ambulanca (N = 2429); Emergjencat - zjarrfikësja (N = 2391); Gjyqësori (N = 2406); Policia (N = 2404).

Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative


Më shumë se gjysma e të anketuarve (54%) që kishin përdorur një shërbim administrativ ishin të kënaqur me shërbimin e ofruar në 2021. Shërbimi i gjendjes civile, sigurimet shoqërore dhe transporti rrugor u konsideruan më së shumti si të kënaqshme, ndërsa shërbimi i hipotekës, i punësimit dhe i lejeve të ndërtimit ishin më pak të kënaqshme.

Mesatarisht,¹⁴ 37% e të gjithë të anketuarve ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike administrative, duke shënuar kështu nivelin më të lartë të kënaqshmërisë në tre vitet e fundit (33% në 2020 dhe 34.5% në 2019).

60.3% e të anketuarve ishin të kënaqur ose shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga gjendja civile, ndjekur nga 45.4% e të anketuarve që ishin të kënaqur me shërbimet e sigurimeve shoqërore dhe ato të transportit rrugor (40.3%). Shërbimet e ofruara nga hipoteka (30.2%), zyrat e punës (28.2%) dhe ato për lejet e ndërtimit (27.1%) morën vlerësimin më të ulët në 2021. *Shih Figurën 41 për vlerësimin e të gjitha shërbimeve administrative.*

14 Përqindja i referohet nivelit mesatar të kënaqshmërisë mes të anketuarve për të gjitha shërbimet publike administrative të marrë së bashku.

Figura 41: Kënaqshmëria me shërbimet publike administrative 2021



Baza: Ndihma sociale (N = 2346); Punësimi (N = 2340); Hipoteka (N = 2358); Gjendja civile (N = 2396); Sigurimet shoqërore (N = 2368); Transporti rrugor (N = 2350); Regjistrimi i biznesit (N = 2331); Lejet e ndërtimit (N = 2337).

Pas analizimit të përgjigjeve të përdoruesve aktualë të shërbimeve publike administrative, mesatarisht,¹⁵ 54% thanë se ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me shërbimet administrative të ofruara, e dhënë mjaft e lartë krahasuar me nivelin në përgjithësi të kënaqshmërisë (37%) të raportuar nga të gjithë të anketuarit në këtë sondazh.

Shërbimet administrative më të përdorura nga të anketuarit në sondazhin e vitit 2021 ishin shërbimi i gjendjes civile (55%), shërbimet e sigurimeve shoqërore (39%) dhe shërbimet e transportit rrugor (31%). Shërbimet më pak të përdorura ishin lejet e ndërtimit (15%) dhe regjistrimi i biznesit (14%).

Niveli i kënaqshmërisë së të anketuarve që kishin përdorur shërbimet e gjendjes civile (72%), shërbimet e sigurimeve shoqërore (64%), regjistrimin dhe licencimin e biznesit (61%), lejet e ndërtimit (48%) ishte shumë më e lartë sesa niveli i përgjithshëm i raportuar nga të gjithë të anketuarit e këtij sondazhi, respektivisht (55%, 45%, 33%, 27% përkatësisht). U vu re një dallim më i vogël midis nivelit të kënaqësisë së përdoruesve me shërbimet e punësimit (35%) e pronësisë (hipotekat) (42%), dhe vlerësimit të të gjithë të anketuarve. *Shihni Tabelën 20 për më shumë informacione.*



15 Përqindja i referohet nivelit mesatar të kënaqshmërisë për të gjitha shërbimet publike administrative të marrë së bashku mes të anketuarve që kishin përdorur shërbimet në vitin 2021.

Tabela 20: Përdorimi dhe kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative 2021

	Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë 2021	% e të anketuarve që përdorën shërbimin në 2021	Niveli i kënaqshmërisë mes atyre që kishin përdorur shërbimin në 2021
Shërbimet e asistencës sociale	32%	22%	49%
Shërbimet e punësimit	28%	27%	35%
Shërbimet e pronësisë	30%	28%	42%
Shërbimet e gjendjes civile	60%	55%	72%
Shërbimet e sigurimeve shoqërore	45%	39%	64%
Shërbimet e transportit rrugor	40%	31%	60%
Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	33%	14%	61%
Lejet e ndërtimit	27%	15%	48%

*Shënim: Shifrat e trasha tregojnë përmirësim prej >5 p.p. krahasuar me nivelin e përgjithshëm të kënaqshmërisë.



Krahasimi demografik për kënaqshmërinë me ofrimin e shërbimeve publike

Të anketuarit me arsim universitar ose pasuniversitar, ata të punësuar në sektorin publik, ata me të ardhura 50,001-70,000 lekë/muaj, dhe ata që banojnë në zonat urbane ishin më të kënaqur me ofrimin e shërbimeve publike bazë dhe ato administrative. Të anketuarit e papunë dhe ata që jetojnë në zonat rurale ishin më pak të prirur të ishin të kënaqur me këto shërbime.

Analiza e treguesve demografikë për ofrimin e shërbimeve publike bazë mbështetet në nivelin e kënaqshmërisë së të gjithë të anketuarve, ndërsa analiza për ofrimin e shërbimeve publike administrative bazohet vetëm në nivelin e kënaqshmërisë së përdoruesve aktualë të këtyre shërbimeve. Dallimet sipas gjinisë nuk ishin të rëndësishme nga pikëpamja statistikore për 15 nga 17 vlerësimet e shërbimeve publike bazë dhe ato administrative. Të anketuarat femra prireshin më shumë të ishin ‘të kënaqura’ ose ‘shumë të kënaqura’ me arsimin publik (56%) dhe shërbimet e sigurimeve shoqërore (68%), në krahasim me të anketuarit meshkuj (51% dhe 60% përkatësisht).

Të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar prireshin më shumë të ishin të kënaqur me arsimin publik (45%), shërbimet e emergjencës mjekësore dhe të zjarrfikëses (51% secili), policinë (43%), shërbimet gjyqësore (31%) dhe me pjesën më të madhe të shërbimet administrative si asistenca sociale (64%), punësimi (41%), pronësia (49%), gjendja civile (75%) dhe sigurimet shoqërore (70%). Nga ana tjetër, të anketuarit me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar ishin më pak të prirur të ishin të kënaqur me shërbimet e punësimit (27%), asistencën sociale (41%), sigurimet shoqërore (50%), gjendjen civile (63%) dhe shërbimet e emergjencës mjekësore (40%). Punonjësit e sektorit publik prireshin më shumë të ishin të kënaqur me të gjitha shërbimet bazë dhe administrative të vlerësuara në këtë sondazh, d.m.th., 16 nga 17 shërbime. Nga ana tjetër, të

anketuarit e papunë ishim më pak të prirur të ishin të kënaqur me të gjitha shërbimet publike bazë dhe pjesën më të madhe të shërbimeve publike administrative, veçanërisht me shërbimet gjyqësore (19%), punësimin (23%), policinë (26%), kujdesin shëndetësor (28%) dhe transportin publik (27%).

Kur analizohen sipas nivelit të të ardhurave, të anketuarit me të ardhura 50,001 deri në 70,000 lekë/muaj prireshin më shumë të ishin të kënaqur me shumicën e shërbimeve publike, veçanërisht me gjendjen civile (80%), sigurimet shoqërore (74%), kujdesin shëndetësor (52%), emergjencën mjekësore (59%) dhe shërbimet e policisë (49%). Si për kontrast, të anketuarit që thanë se nuk kishin të ardhura të rregullta mujore ishin më pak të prirur të ishin të kënaqur me shumicën e shërbimeve, veçanërisht me shërbimet gjyqësore (21%), punësimin (24%), shërbimet e policisë (29%) dhe ato të kujdesit shëndetësor (31%). Të anketuarit nga zonat urbane prireshin më shumë të ishin të kënaqur me ujësjellësin (47%), shërbimet e emergjencës mjekësore dhe zjarrfikësen (47% secili), transportin publik (34%), shërbimet gjyqësore (28%), shërbimet e policisë (39%) dhe gjendjen civile (75%), krahasuar me të anketuarit nga zonat rurale (41%, 44%, 40%, 29%, 24%, 33% dhe 66% përkatësisht). *Shihni Tabelën 23 të dhëna më të hollësishme për treguesit demografikë për vlerësimet e shërbimeve publike.*

Të anketuarit që thanë se kishin aftësi të kufizuara ishin më pak të prirur të ishin të kënaqur me pjesën më të madhe të shërbimeve publike, si transportin publik (23%), shërbimet e policisë (27%), kujdesin shëndetësor (29%), ujësjellësin (34%), emergjencën mjekësore (34%), zjarrfikësen (31%), arsimin publik (41%), sigurimet shoqërore (48%), transportin rrugor (48%), gjendjen civile (66%), regjistrimin dhe licencimin e biznesit (31%) dhe lejet e ndërtimit (20%). Të anketuarit e pakicave kombëtare ishin po ashtu më pak të prirur të ishin të kënaqur me transportin publik (26%), ujësjellësin (37%), arsimin publik (42%) dhe gjendjen civile (68%).

Tendencat vjetore të kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve publike, 2016–2021

Niveli i kënaqshmërisë për shërbimet publike u përmirësua për pjesën më të madhe të shërbimeve publike bazë dhe administrative në 2021, krahasuar me 2020. Gjendja civile, sigurimet shoqërore, hipoteka, zyrat e punësimit dhe ato të lejeve të ndërtimit morën vlerësimet më të mira që nga përfshirja e tyre në sondazh.

Vlerësimet u përmirësuan pak ose mjaft mirë për tetë nga nëntë shërbimet publike bazë në 2021 krahasuar me 2020. Shërbimet e pastrimit, shërbimet e shëndetit publik dhe transporti publik patën një ndryshim të papërfillshëm (-/+ 1 pp) në nivelin e kënaqshmërisë me to, ndërsa përmirësim u vu re për shërbimet e arsimit publik, furnizimin me ujë, shërbimet e urgjencës mjekësore, zjarrfikësen, shërbimet e policisë dhe shërbimet gjyqësore. Niveli i kënaqshmërisë për shërbimet e policisë, arsimit publik, ujësjellësit dhe transportit publik u përmirësuan për herë të parë në vitin 2021, duke përmbytur kështu rënien e evidentuar në vitet 2016-2020.

Të gjitha shërbimet publike administrative kanë një përmirësim në nivelin e kënaqshmërisë me ofrimin e shërbimeve krahasuar me rezultatet e vitit 2020, bazuar në vlerësimin e të gjithë të anketuarve. Shumica e tyre tejkaluan edhe normat e para-pandemisë së vitit 2019 si dhe rënien ose mosndryshimin në 2020, me përjashtim të transportit rrugor dhe regjistrimit dhe licencimit të biznesit, ndërsa shërbimi i punësimit vazhdoi me rritjen që kishte nisur në 2020.

Në 2021, pesë nga tetë grupet e shërbimeve, përkatësisht gjendja civile, sigurimet shoqërore, hipoteka, punësimi dhe lejet e ndërtimi shënuan rezultatet e tyre më të mira për sa i përket vlerësimit të kënaqshmërisë që nga përfshirja e tyre në sondazh, ku shërbimi i gjendjes civile ishte i pari që kaloi shifrën 60%. *Shihni Tabelën 21 për të dhëna më të hollësishme.*

Tabela 21: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike (2016–2021)

	2016	2017	2018	2019*	2020	2021
Shërbimet publike bazë						
Shërbimet e shëndetit publik	47%	42%	41%	44%	41%	42%
Shërbimet e arsimit publik	58%	54%	50%	48%	49%	53%
Furnizimi me ujë	72%	56%	50%	47%	42%	45%
Transporti publik	55%	50%	37%	36%	32%	33%
Shërbimet e pastrimit	61%	57%	49%	51%	49%	48%
Shërbimet e emergjencave	55%	53%	44%	47%	40%	X
Shërbimet e emergjencave mjekësore	X	X	X	X	X	46%
Zjarrfikësja	X	X	X	X	X	45%
Shërbimet gjyqësore	21%	15%	19%	20%	20%	27%
Shërbimet e policisë	66%	50%	40%	41%	33%	37%
Shërbimet administrative (të gjithë të anketuarit)						
Shërbimet e asistencës sociale	34%	34%	31%	30%	28%	32%
Shërbimet e punësimit	18%	19%	17%	22%	23%	28%
Shërbimet e pronësisë	X	X	26%	26%	26%	30%
Shërbimet e gjendjes civile	X	X	X	57%	55%	60%
Shërbimet e sigurimeve shoqërore	X	X	X	42%	40%	45%
Shërbimet e transportit rrugor	X	X	X	43%	38%	40%
Regjistrimi dhe licencimi i biznesit	35%	36%	32%	35%	29%	33%
Lejet e ndërtimit	X	X	24%	24%	24%	27%

Shënim: Përqindjet me numra të trasha tregojnë normat më të larta të raportuara për kënaqshmërinë gjatë viteve 2016–2021.

*Që nga viti 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


** Në sondazhin e vitit 2021 shërbimet e emergjencës u ndanë në emergjencë mjekësore dhe zjarrfikës.

Vlerësimi i procesit të ofrimit të shërbimeve publike administrative

45.7% e përdoruesve të shërbimeve administrative konstatuan se procesi ishte i lehtë, krahasuar me 41.6% që e vlerësuan atë si të vështirë. Të anketuarit e rinj në moshë, ata me arsim universitar apo pasuniversitar dhe të punësuarit në sektorin publik prireshin më shumë ta konsideronin të lehtë procesin e ofrimit të shërbimeve.

45.7% e të anketuarve që kishin përdorur shërbimet publike administrative raportuan se procesi për marrjen e shërbimit ishte shumë i lehtë ose i lehtë, krahasuar me 41.6% të përdoruesve që thanë se procesi ishte i vështirë ose shumë i vështirë.

Figura 42: Marrja e shërbimeve publike administrative 2021



Baza: N = 2452


Të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç (56%) prireshin më shumë të mendonin se marrja e shërbimeve publike administrative ishte e lehtë, krahasuar me personat e grupmoshës 55-65 vjeç (35%). Për sa i përket nivelit arsimor, ata me arsim universitar ose pasuniversitar (58%) prireshin më shumë ta konsideronin procesin të lehtë ose shumë të lehtë sesa të anketuarit që kanë mbaruar vetëm arsimin e detyrueshëm (31%). Të punësuarit, veçanërisht në sektorin publik (66%) dhe ata me të ardhura 50,001 deri në 70,000 lekë/muaj prireshin më shumë ta konsideronin procesin të lehtë sesa të papunët (32%) dhe personat pa të ardhura të rregullta mujore (37%). Dallimet sipas gjinisë (femra 47% dhe meshkuj 45%) ishin të parëndësishme nga pikëpamja statistikore në vlerësimin e ofrimit të shërbimeve publike administrative, ndërsa anëtarët e pakicave kombëtare (36%) dhe personat me aftësi të kufizuara (28%) ishin më pak të prirur ta konsideronin procesin të lehtë ose shumë të lehtë.

Paraqitja e ankesave

15.1% e të anketuarve kishin bërë ankesë tek institucionet publike që ofronin shërbime në 2021. Studentët dhe të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë/muaj prireshin më shumë të bënin ankesa. Të anketuarit e moshës mbi 56 vjeç dhe ata që jetojnë me të ardhura deri në 30,000 lekë/muaj ishin më pak të prirur të paraqisnin ankesa.

15.1% e të anketuarve bënë një ankesë për shërbimin e marrë tek institucioni publik që ofronte shërbimin krahasuar me 12% që raportuan në sondazhin e vitit 2020. Sipas treguesve demografikë, të anketuarit e grupmoshës 26-45 vjeç (18%), studentët (19%) apo të anketuarit me arsim universitar (17%), dhe ata që kanë të ardhura mbi 70,000 lekë/muaj (25%) prireshin më shumë të paraqisnin një ankesë sesa të anketuarit e moshës 56 vjeç e sipër (8%), pensionistët (7%) dhe ata me arsim më pak se arsim i mesëm (12%). Është interesante të theksohet se, të anketuarit që kanë të ardhura deri 30,000 lekë/muaj (12%) ishin më pak të prirur të bënin ankesë se të anketuarit e papunë (15%) apo që nuk kanë fare të ardhura (16%). Nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 15% dhe meshkuj 15%), sektorit të punësimit, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, apo përkatësisë në pakicat kombëtare.

Figura 43: Përqindja e të anketuarve që kishin paraqitur ankesë tek institucionet (2016–2021)



Baza: 2016 (N = 1627); 2017 (N = 1639); 2018 (N = 1628); 2019 (N = 2491); 2020 (N = 2488); 2021 (N = 2494).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Normat e raportimit të ankesave për një shërbim të marrë prej institucioneve publike kanë qenë vazhdimisht të ulëta gjatë viteve 2016–2021. Të dhënat më të ulëta për bërjen e ankesave gjatë 2019-2021 u raportuan në 2020 (12%) dhe më të lartat në vitin 2019 (17%).


Platforma e bashkëqeverisjes ‘shqiperiaqeduam.al’

Platformën online ‘www.shqiperiaqeduam.al’ e kanë përdorur një numër më i madh të anketuarish për të bërë ankesë në 2021 (16.1% në 2021 vs. 12% në 2020). Gjithsesi, raportohet se janë trajtuar më pak ankesa nga platforma në 2021 (32.2% përkundër 44% në 2020). Studentët, të anketuarit nga zonat rurale dhe të anketuarit me aftësi të kufizuar prireshin më shumë të raportonin se kishin bërë ankesë te platforma shqiperiaqeduam.al.

Të anketuarit e këtij sondazhi raportuan ritme më të mëdha përdorimi (16.1%) të platformës online ‘www.shqiperiaqeduam.al’ për paraqitjen e ankesave, krahasuar me 12% në 2020. 83.9% e të anketuarve nuk kishin bërë asnjë ankesë në këtë platformë në vitin 2021.

Kur shqyrtohen përgjigjet sipas treguesve demografikë, nuk vihen re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 17% dhe meshkuj 16%), nivelit arsimor, sektorit të punësimit apo nivelit të të ardhurave. Studentët (21%) dhe të anketuarit e grupmoshës 46-55 vjeç (20%) prireshin më shumë të bënin ankesa tek platforma shqiperiaqeduam.al, sesa të anketuarit e moshës mbi 65 vjeç (6%). Banorët e zonave rurale (20%) dhe ata që deklaruan se kanë aftësi të kufizuar (19%) prireshin më shumë të paraqisnin një ankesë nëpërmjet kësaj platforme.

Figura 44: A keni bërë ndonjë ankesë tek platforma e bashkëqeverisjes 'www.shqiperiaqeduam.al'? 2021?



Baza: N = 2488

Nga të anketuarit që kishin bërë ankesë nëpërmjet platformës online shqiperiaqeduam.al, 32.2% thanë se ankesa e tyre ishte zgjidhur. Krahasuar me sondazhin e vitit 2020, përqindja e të anketuarve, ankesa e të cilëve është zgjidhur nga platforma (44%), është ulur me 12 pikë përqindje. Edhe shifra e vitit 2021 ka qenë më e ulët se rezultatet e vitit 2019, kur 37% e ankesave të të anketuarve ishin zgjidhur nga kjo platformë.

Të anketuarit meshkuj (34%), ata të grupmoshës 26-35 vjeç (41%), me diplomë universitare apo pasuniversitare (38%), të punësuar në sektorin publik (51%) dhe ata që banojnë në zonat urbane (35%) raportojnë më shpesh se ankesa e tyre është zgjidhur. Të anketuarit e këtij sondazhi me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (23%), të anketuarit e papunë (17%), banorët e zonave rurale (28%), të anketuarit me aftësi të kufizuara (24%) dhe ata që i përkisnin një pakice kombëtare (8%) raportojnë më rrallë se ankesat e tyre ishin zgjidhur përmes platformës.

Trajtimi i ankesave të qytetarëve nga institucionet në Shqipëri


26.2% e të anketuarve besojnë se institucionet i trajtojnë ankesat e qytetarëve. Punonjësit e sektorit publik dhe qytetarët e grupmoshës 26-35 vjeç prireshin më shumë të besonin se institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve.

26.2% e qytetarëve shqiptarë besojnë se institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e tyre, krahasuar me 25% që raportuan të njëjtën gjë në sondazhin e vitit 2020. Krahasimet demografike tregojnë se të anketuarit me arsim universitar (32%) prireshin të besonin se institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve më shumë se të anketuarit me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (19%). Po ashtu, të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç (33%) dhe mbi 65 vjeç (32%) ishin më optimistë se të anketuarit e grupmoshës 56-65 vjeç (18%). Punonjësit e sektorit publik (48%) dhe të anketuarit me të ardhura të rregullta mbi 70,000 lekë/muaj (38%) prireshin më shumë të besonin

se institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve. Të anketuarit e papunë (14%), si dhe anëtarët e pakicave kombëtare (18%), ishin më pak të prirur të besonin se ankesat e qytetarëve trajtohen siç duhet nga institucionet. Dallimet sipas gjinisë (femra 26% dhe meshkuj 26%) ishin të parëndësishme nga pikëpamja statistikore.

Në retrospektivë, viti 2017 vazhdon ende të jetë viti me përqindjen më të lartë të raportuar të të anketuarve (29%) që besonin se institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve. Besimi në aftësinë e institucioneve për të trajtuar siç duhet ankesat e qytetarëve ra në 2018 me 6 pp (23%) dhe ka ndryshuar fare pak me një rritje kumulative prej +2 pp mes viteve 2019 dhe 2021. Ndërkohë, opsioni ‘Nuk e di’ vazhdon të zgjidhet nga një përqindje e konsiderueshme të anketuarish.

Figura 45: Institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat e qytetarëve 2016-2021¹⁶



Baza: 2016 (N = 1259); 2017 (N = 1599); 2018 (N = 1565); 2019 (N = 2464); 2020 (N = 2475); 2021 (N = 2478).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


Sportelet e shërbimit në ADISA

Më shumë të anketuar (36.9%) vizituan sportelet e shërbimit ADISA në 2021, krahasuar me vitin e kaluar (29%). Vlerësimi i kënaqshmërisë u rrit në 76.9% krahasuar me 73% të raportuar në vitin 2020. Femrat, të punësuarit në sektorin publik dhe të anketuarit me të ardhura mbi 70,001 lekë/muaj prireshin më shumë të raportonin se ishin të kënaqur me shërbimin e ofruar në sportelet e ADISA-s.

36.9% e të anketuarve raportuan se kishin vizituar sportelet e shërbimit ADISA në 2021, krahasuar me 29% në 2020, një rritje prej gati 8 pp kur bëhet fjalë për marrjen e shërbimit, që tejkaloi edhe rritjen prej 5 pp në sondazhet e viteve 2019 (24%) dhe 2020, nga ku kemi një rritje kumulative prej 13 pp që nga viti 2019.

16 Gjatë viteve 2016–2020, me pyetjen e sondazhit matej nëse institucionet ‘i dëgjonin’ dhe ‘i trajtonin’ siç duhet ankesat e qytetarëve. Në sondazhin e 2021 pyetja u thjeshtua dhe u bë “institucionet i trajtojnë siç duhet ankesat që vijnë nga qytetarët”, duke ruajtur të njëjtin kuptim për qëllime krahasimi mes viteve.

Figura 46: Të anketuarit që kanë vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2021




Baza: N = 2489

Kur shqyrtohen përgjigjet sipas treguesve demografikë, nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë (femra 36% dhe meshkuj 38%) dhe vendbanimit. Të anketuarit e grupmoshës 46-55 vjeç (43%), ata me arsim universitar ose pasuniversitar (46%), ata që punojnë në sektorin publik (48%), të papunët (36%) dhe të anketuarit me të ardhura të rregullta mbi 70,000 lekë/muaj (56%) prireshin më shumë të deklaronin se kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA në 2021. E njëjta gjë vlen edhe me të anketuarit me aftësi të kufizuara (38%) dhe ata që i përkasin një pakice kombëtare (38%). Nga ana tjetër, pjesëmarrësit e moshës mbi 66 vjeç (18%), ata me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (29%) dhe ata që kanë të ardhura deri në 30,000 lekë/muaj (27%) ishin më pak të prirur që të deklaronin se kishin vizituar sportele shërbimi ADISA.

76.9% e të anketuarve që kishin vizituar një sportel shërbimi ADISA thanë se ishin ‘shumë të kënaqur’ (23.5%) ose ‘të kënaqur’ (53.4%) me shërbimin që kishin marrë. Vlerësimi për kënaqshmërinë me shërbimin e marrë është 4 pp më i lartë se në vitin 2020 (73%) dhe është rritur që nga hera e parë që u mat në sondazhin e vitit 2019 (69%).

Figura 47: Kënaqshmëria me sportelet e shërbimit ADISA në 2021 (%)



Baza: N = 916

Të anketuarit që ishin më të prirur për të qenë të kënaqur me shërbimet nga ADISA ishin ata me arsim universitar ose pasuniversitar (81%), të punësuarit e sektorit publik (89%) dhe ata me të ardhura 50,001-70,000 lekë/muaj (85%). Të anketuarat femra (81%) prireshin më shumë të ishin të kënaqura me shërbimin se meshkujt (73%). Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare ishin më pak të prirur të shprehnin se kënaqësinë me shërbimet nga ADISA (60%) se ata që nuk bëjnë pjesë në pakice kombëtare (78%). Treguesit e tjerë demografikë, si grupmosha, statusi i punësimit, dhe vendbanimi nuk evidentuan dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore.


Siguria në jetën e përditshme

71.6% e shqiptarëve të anketuar nuk ndihen të sigurtë në jetën e përditshme. Të papunët, brezat e rinj, punonjësit e sektorit privat, ata pa të ardhura si dhe të anketuarit me të ardhurat më të larta prireshin më shumë për të raportuar pasiguri në jetën e përditshme. Arsyet kryesore të ndjenjës së pasigurisë ishin kriminaliteti, shëndetësia pa cilësi e standard, padrejtësia, pasiguria e vendit të punës dhe fatkeqësitë natyrore.

71.6% e të anketuarve thanë se në përgjithësi nuk ndjehen të sigurtë në jetën e përditshme, përqindje e rritur nga 70% e raportuar në 2020. Kur shqyrtohen përgjigjet sipas treguesve demografikë, brezi i ri, d.m.th., të grupmoshës 18-25 vjeç (79%), ishin më të prirur të deklaronin se nuk ndjeheshin të sigurt, ashtu si edhe të anketuarit e papunë (80%), të punësuarit në sektorin privat (74%), njerëzit pa të ardhura (82%) si dhe ata me nivelin më të lartë të të ardhurave me mbi 70,001 lekë/muaj (71%). Nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë (femra 71% dhe meshkuj 72%), nivelit arsimor, vendbanimit, aftësisë së kufizuar apo përkatësisë në pakice kombëtare.

Në Figurën 48 tregohet perceptimi i qytetarëve për sigurinë siç raportohet në sondazhet e viteve 2016-2021. Kjo tregon një trend në rënie të vazhdueshme që nga 2017, edhe pse në 2021 evidentohet rënia më e vogël në perceptimet e qytetarëve për sigurinë në jetën e përditshme (-2 pp), krahasuar me rëniet më të theksuara prej mbi -5 pp gjatë 2017 dhe 2020.

Figura 48: Perceptimi për sigurinë në jetën e përditshme (2016–2021)



Baza: 2016 (N=1608); 2017 (N=1615); 2018 (N=1629); 2019 (N=2500); 2020 (N=2492); 2021 (N = 2490).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

73% e të anketuarve, 13 pp më shumë se në 2020 (59%) raportuan kriminalitetin si faktorin kryesor për ndjenjën e pasigurisë në jetën e përditshme, ndjekur nga shëndetësia pa cilësi e standarde (43%) dhe padrejtësia (35%). Pasiguria e vendit të punës (33%) dhe fatkeqësitë natyrore si tërmeti dhe pandemia (22%) ishin disa nga arsyet e tjera të raportuara për pasigurinë në jetën e përditshme gjatë 2021. Në Tabelën 22 jepet renditja e plotë e faktorëve për ndjenjën e pasigurisë në jetën e përditshme gjatë viteve 2016–2021.

Tabela 22: Faktorët për ndjenjën e pasigurisë (2016–2021)

Faktorët për ndjenjën e pasigurisë	2016	2017	2018	2019*	2020	2021
Kriminaliteti (vjedhjet, grabitjet)	49%	58%	71%	67%	59%	73% (N=1290)
Shëndetësia pa cilësi e standard	11%	30%	50%	49%	49%	43% (N=766)
Pasiguria e vendit të punës	X	42%	52%	36%	41%	33% (N=590)
Padrejtësia	11%	32%	45%	36%	37%	35% (N=630)
Ndjenja e pasigurisë për shkak të fatkeqësive natyrore (p.sh., tërmetet, pandemia)	X	X	X	X	27%	22% (N=388)
Politika	5%	29%	45%	28%	23%	17% (N=309)
Pabarazia në pasuri	3%	23%	23%	16%	18%	15% (N=274)
Ndotja	3%	12%	20%	17%	12%	16% (N=276)
Përdorimi i lëndëve narkotike	6%	23%	29%	15%	9%	13% (N=223)
Trafiku	7%	11%	13%	13%	8%	13% (N=238)
Dhuna në familje	3%	15%	19%	7%	6%	9% (N=151)
Mungesa e lirisë së fjalës	1%	5%	11%	4%	3%	3% (N=51)
Mungesa e konfidencialitetit dhe mbrojtjes kur raportohen shkeljet	1%	6%	12%	3%	3%	4% (N=70)
Diskriminimi për shkak të gjinisë, besimit fetar, pasurisë, etj.	X	5%	7%	3%	1%	1% (N=26)

Baza: 2016 (N=1608); 2017 (N=1615); 2018 (N=1629); 2019 (N=1613); 2020 (N=1713); 2021 (N=1776).

Shënim: Lejohen disa përgjigje; përqindjet nuk plotësojnë koeficientin 100%.

* Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Tabela 23: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike bazë sipas karakteristikave demografike 2021

Shërbimet publike (të gjithë të anketuarit)										
	Shëndetësia	Arsimi	Furnizimit me ujë	Transporti publik	Pastrimi	Emergjencia: ambulanca	Emergjencia: zjarrfikësja	Gjyqësori	Policia	
GJITHSEJ (% e kënaqshmërisë)	42%	53%	45%	33%	48%	46%	45%	27%	37%	
Gjinia										
Femra	43%	56%	47%	33%	50%	48%	47%	29%	39%	
Meshkuj	41%	51%	43%	32%	47%	44%	43%	26%	35%	
Grupmosha										
18–25 vjeç	37%	49%	41%	31%	44%	42%	39%	26%	32%	
26–35 vjeç	45%	54%	47%	31%	48%	49%	47%	28%	39%	
36–45 vjeç	43%	56%	44%	33%	49%	45%	45%	29%	39%	
46–55 vjeç	44%	53%	43%	32%	45%	48%	45%	27%	37%	
56–65 vjeç	36%	54%	44%	32%	49%	43%	44%	25%	39%	
66 vjeç e sipër	45%	53%	55%	42%	59%	49%	50%	26%	35%	
Niveli arsimor										
Me arsim deri 8/9-vjeçar	40%	48%	44%	31%	43%	40%	41%	24%	34%	
Me arsim të mesëm	39%	52%	44%	32%	48%	45%	42%	26%	35%	
Me arsim universitar	47%	59%	49%	35%	53%	51%	51%	31%	43%	
Statusi i punësimit										
I/E punësuar	Gjithsej	46%	59%	48%	33%	51%	51%	50%	29%	41%
	Spektori publik	63%	75%	63%	46%	63%	67%	66%	42%	57%
	Spektori privat	40%	52%	42%	29%	46%	45%	43%	25%	36%
I/E papunë	28%	39%	37%	27%	37%	33%	31%	19%	26%	
Student	39%	48%	41%	29%	43%	43%	43%	33%	38%	
Pensionist	43%	56%	53%	41%	57%	47%	48%	29%	39%	
Niveli i të ardhurave										
Pa të ardhura	31%	40%	37%	28%	39%	36%	35%	21%	29%	
Deri në 30,000 lekë	41%	52%	45%	33%	50%	43%	43%	26%	34%	
30,001–50,000 lekë	46%	62%	50%	38%	52%	52%	49%	31%	43%	
50,001–70,000 lekë	52%	61%	52%	33%	56%	59%	58%	33%	49%	
Mbi 70,001 lekë	41%	49%	43%	25%	46%	50%	53%	37%	46%	
Vendbanimi										
Urban	41%	54%	47%	34%	50%	47%	47%	28%	39%	
Rural	45%	51%	41%	29%	45%	44%	40%	24%	33%	

* Përqindja llogaritet si shuma e përqindjes së të anketuarve “të kënaqur” dhe “shumë të kënaqur”.

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

Tabela 24: Kënaqshmëria me ofrimin e shërbimeve publike administrative sipas karakteristikave demografike 2021

Shërbimet administrative (vetëm përdoruesit)								
	Asistenca sociale	Punësimi	Pronat	Gjendja civile	Sigurimet shoqërore	Transporti rrugor	Regj. e licencimit i biznesit	Lejet e ndërtimit
GJITHSEJ (% e kënaqshmërisë)	49%	35%	42%	72%	64%	60%	61%	48%
Gjinia								
Femra	51%	37%	44%	75%	68%	59%	56%	50%
Meshkuj	48%	33%	40%	70%	60%	60%	64%	46%
Grupmosha								
18–25 vjeç	50%	28%	56%	73%	68%	68%	68%	52%
26–35 vjeç	64%	37%	45%	74%	71%	62%	65%	55%
36–45 vjeç	46%	38%	38%	70%	70%	49%	61%	46%
46–55 vjeç	50%	34%	34%	72%	59%	56%	52%	45%
56–65 vjeç	38%	34%	44%	72%	58%	70%	54%	39%
66 vjeç e sipër	49%	43%	39%	71%	56%	61%	58%	36%
Niveli arsimor								
Me arsim deri 8/9-vjeçar	41%	27%	42%	63%	50%	54%	47%	36%
Me arsim të mesëm	47%	33%	35%	74%	67%	56%	60%	46%
Me arsim universitar	64%	41%	49%	75%	70%	64%	66%	56%
Statusi i punësimit								
I/E punësuar	Gjithsej	56%	41%	44%	77%	70%	64%	53%
	Spektori publik	79%	67%	60%	84%	85%	73%	72%
	Spektori privat	43%	28%	37%	72%	65%	60%	48%
I/E papunë	43%	23%	29%	61%	51%	49%	41%	33%
Student	50%	36%	56%	71%	68%	52%	80%	70%
Pensionist	49%	34%	44%	68%	57%	59%	50%	37%
Niveli i të ardhurave								
Pa të ardhura	42%	24%	38%	63%	52%	48%	45%	34%
Deri në 30,000 lekë	44%	28%	32%	68%	60%	54%	60%	43%
30,001–50,000 lekë	61%	46%	53%	78%	72%	65%	71%	60%
50,001–70,000 lekë	64%	53%	51%	80%	74%	67%	63%	53%
Mbi 70,001 lekë	75%	50%	21%	74%	69%	52%	67%	38%
Vendbanimi								
Urban	50%	33%	44%	75%	66%	61%	61%	51%
Rural	48%	40%	38%	66%	60%	55%	59%	41%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi “Arsim deri 9-vjeçar” përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.7 FATKEQËSITË NATYRORE

Ndikimi i vazhdueshëm i pandemisë COVID-19 si dhe përpjekjet për rindërtim pas tërmetit shkatërrues të nëntorit 2019 janë dy nga ngjarjet më të rëndësishme që nxisin debatin dhe perceptimin e publikut për fatkeqësitë natyrore. Prandaj, kapitulli ‘Fatkeqësitë natyrore’, i prezantuar për herë të parë në Sondazhin e Opinioneve të Besimit në Qeverisje 2020 u aplikua edhe në edicionin e 2021.


Pjesëmarrësve të këtij sondazhi iu kërkua të vlerësonin duke përdorur një shkallë prej katër pikësh - nga 1 (shumë i kënaqur) në 4 (shumë i pakënaqur), sa të kënaqur ishin me katër aspekte që kishin të bënin me pandeminë COVID-19: Transparenca në vendimmarrje nga qeverisja qendrore; transparenca në vendimmarrje nga qeverisja vendore; mundësia e marrjes së shërbimeve online (p.sh. konsultim online, mësimi online, etj.), dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut. Pyetjet e tjera u përqendruan në veprimet e qeverisë në lidhje me tërmetin. Më konkretisht, pjesëmarrësve në sondazh iu kërkua të thonin sa të kënaqur ishin me zbatimin e programeve të rindërtimit pas tërmetit (p.sh., ofrimi i strehimit, vlerësimi i dëmit, rindërtimi) si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor.

Qeverisja gjatë pandemisë COVID-19

Më shumë se gjysma e të anketuarve ishin të pakënaqur me transparencën e vendimmarrjes së qeverisë qendrore (52.1%) dhe qeverisjes vendore (52.9%). Shqiptarët ishin të ndarë në opinionet e tyre për sa i përket ofrimit të shërbimeve alternativave online, ndërsa 52.6% e tyre ishin të pakënaqur me respektin e treguar për të drejtat dhe liritë e njeriut gjatë pandemisë COVID-19.

Më pak se gjysma e të anketuarve të këtij sondazhi raportuan se ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me transparencën e vendimmarrjes së qeverisë gjatë pandemisë COVID-19, si ajo qendrore (46.1%) ashtu edhe ajo vendore (45.1%). 44.4% e të anketuarve ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut nga institucionet gjatë periudhës në vazhdimësi të pandemisë COVID-19. dhe 48.4% ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me ofrimin e shërbimeve alternative online për të njëjtën periudhë.

Figura 49: Kënaqshmëria e qytetarëve me trajtimin e krizave dhe qeverisjen gjatë pandemisë COVID-19 2021



Baza: Transparenca e qeverisë qendrore (N=2496); Transparenca e qeverisë vendore (N=2496); Alternativat online për marrjen e shërbimeve (N=2495); dhe respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut (N=2495).

Nuk u evidentuan dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 48% dhe meshkuj 44%) për sa i përket kënaqshmërisë së tyre me transparencën e vendimmarrjes në nivel qendror gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Ndërsa një përqindje më e madhe femrash (48%) sesa meshkujsh (42%) raportuan se ishin të kënaqur me transparencën e vendimmarrjes në nivel vendor për të njëjtën periudhë, të anketuarat femra duken më 'të kënaqura' ose 'shumë të kënaqura' në krahasim me meshkujt (52% me 45%) për ofrimin e alternativave online për marrjen e shërbimeve dhe për respektin e treguar për të drejtat dhe liritë e njeriut (femra 47% dhe meshkuj 42%) gjatë pandemisë COVID-19.

Të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (61%), ata me arsim universitar apo pasuniversitar (49%), të punësuarit në sektorin publik (67%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë prireshin më shumë të deklaronin se ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me transparencën e vendimmarrjes në nivel qendror. E njëjta gjë vlen për nivelin e kënaqshmërisë me transparencën në nivel vendor; të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (57%), ata me arsim universitar apo pasuniversitar (48%), ata të punësuar në sektorin publik (66%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001 deri në 70,000 lekë (51%) prireshin më shumë të deklaronin se ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur'.

Për më tepër, të anketuarit në grupmoshën 26-35 vjeç (52%), ata me arsim universitar (55%), të punësuarit në sektorin publik (69%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001 deri në 70,000 lekë (58%) ishin më të prirur të deklaronin se ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur' me ofrimin e alternativave online për marrjen e shërbimeve.

Për sa i përket nivelit të kënaqshmërisë me respektin e treguar për të drejtat dhe liritë e njeriut, të anketuarit e moshës mbi 66 vjeç (56%), të punësuarit në sektorin publik (64%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001 deri në 70,000 lekë (52%) kishin më shumë gjasa të deklaronin se ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur'.

Të anketuarit që raportuan se nuk kanë të ardhura të rregullta mujore prireshin më shumë për të shprehur pakënaqësinë me transparencën e vendimmarrjes si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor (36% për të dy kategoritë), me ofrimin e alternativave online për marrjen e shërbimeve (40%), dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut (35%). Shihni në Tabelën 26 për ndarjen demografike të të anketuarve në lidhje me kënaqshmërinë me qeverisjen gjatë fatkeqësive natyrore.

Të anketuarit që thanë se kishin aftësi të kufizuara prireshin më shumë për të shprehur pakënaqësinë me transparencën e vendimmarrjes. 61% e të anketuarve me aftësi të kufizuara raportuan se ishin 'të pakënaqur' ose 'shumë të pakënaqur' me transparencën në nivel qendror; me një përqindje më të vogël, 36%, që thanë se ishin 'të kënaqur' ose 'shumë të kënaqur'. Po ashtu, për transparencën në nivel vendor, 60% e të anketuarve me aftësi të kufizuara raportuan se ishin 'të pakënaqur' ose 'shumë të pakënaqur' me transparencën e vendimmarrjes së këtij niveli. Po ashtu, ata prireshin më shumë të shprehnin pakënaqësinë me ofrimin e alternativave online për marrjen e shërbimeve (60%) dhe respektin e treguar nga institucionet publike për të drejtat dhe liritë e njeriut (63%).

Rezultatet tregojnë se të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare ishin më pak të prirur të ishin 'shumë të kënaqur' ose 'të kënaqur' me transparencën e qeverisë qendrore (36%), atë të qeverisë vendore (39%), ofrimin e alternativave online për marrjen e shërbimeve (36%) dhe respektin e treguar nga institucionet publike për të drejtat dhe liritë e njeriut (35%).

Përgjigja e qeverisë pas tërmetit

Pothuajse gjysma e popullsisë së anketuar ishte e pakënaqur me zbatimin e programit të rindërtimit të pas tërmetit të 2019 nga qeveria qendrore (49.2%) dhe pushteti vendor (50.8%). Pakënaqësia ishte më e theksuar te grupmosha 56-65 vjeç, të papunët, punonjësit e sektorit privat dhe personat me aftësi të kufizuara.


Më pak se gjysma e të anketuarve të këtij sondazhi raportuan se ishin ‘të kënaqur’ ose ‘shumë të kënaqur’ me zbatimin nga qeveria qendrore të programit të rindërtimit të pas tërmetit të 2019, – konkretisht, 40.2% – ndërkohë që 38.8% raportuan të njëjtën gjë për zbatimin nga qeveria vendore.

Figura 50: Kënaqshmëria e qytetarëve me zbatimin nga ana e qeverisë të programit të rindërtimit të pas tërmetit 2021

Qeveria qendrore



Qeveria vendore



● Shumë i/e kënaqur ● I/E kënaqur ● I/E pakënaqur ● Shumë i/e pakënaqur ● Nuk e di/ Refuzim

Baza: Qeveria qendrore (N=2377); Qeveria vendore (N=2377)

Kënaqshmëria me zbatimin nga qeveria qendrore të programit të rindërtimit pas tërmetit ishte më e theksuar tek femrat (43%) sesa tek meshkujt (37%), te të anketuarit me arsim universitar apo pasuniversitar (46%), të punësuarit në sektorin publik (61%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë (51%). Po ashtu, niveli i kënaqshmërisë me zbatimin nga qeveria vendore i programeve të rindërtimit të pas tërmetit ishte më i mirë tek të anketuarat femra (41%) se sa tek meshkujt (36%), si dhe mes të anketuarve me arsim universitar apo pasuniversitar (44%), të punësuarit në sektorin publik (60%), dhe ata me të ardhura mujore 50,001-70,000 lekë (49%). *Shihni Tabelën 25 për ndarjen demografike të vlerësimit të qeverisjes gjatë fatkeqësive natyrore.*

Personat me aftësi të kufizuara prireshin më shumë të shprehnin pakënaqësinë e tyre me zbatimin nga qeveria qendrore të programit të saj të rindërtimit pas tërmetit. Më konkretisht, 64% e të anketuarve me aftësi të kufizuara thanë se ishin ‘të pakënaqur’ ose ‘shumë të pakënaqur’ me përgjigjen e qeverisë qendrore krahasuar me të anketuarit që nuk janë me aftësi të kufizuara (48%). E njëjta përgjigje u dha edhe për vlerësimin e programit të rindërtimit të njëjësive të qeverisjes vendore. 68% e të anketuarve me aftësi të kufizuara raportuan se ishin ‘të pakënaqur’ ose ‘shumë të pakënaqur’ me zbatimin e programeve të rindërtimit nga qeveria vendore, krahasuar me 49% të të anketuarve që nuk janë me aftësi të kufizuara.

Nuk pati dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore mes të anketuarve që i përkasin një pakice kombëtare apo jo për sa i përket vlerësimit të përgjigjes pas tërmetit si për qeverinë qendrore ashtu edhe për atë vendore.

Tabela 25: Ndarja demografike e kënaqshmërisë me qeverisjen gjatë fatkeqësive natyrore 2021

Shërbimet administrative (vetëm përdoruesit)							
		Transparenca e vendimarrjes qendrore	Transparenca e vendimarrjes vendore	Ofrimi i shërbimeve online	Respekti për të drejtat dhe liritë	Përgjigjia e qeverisë qendrore pas tërmetit	Përgjigjia e qeverisë vendore pas tërmetit
Gjithsej (% të kënaqur dhe shumë të kënaqur)		46%	45%	49%	44%	40%	39%
Gjinia							
Femra		48%	48%	52%	47%	43%	41%
Meshkuj		44%	42%	45%	42%	37%	36%
Grupmosha							
18–25 vjeç		41%	41%	48%	40%	37%	37%
26–35 vjeç		45%	45%	52%	44%	41%	40%
36–45 vjeç		46%	45%	49%	45%	43%	41%
46–55 vjeç		45%	45%	47%	44%	39%	37%
56–65 vjeç		46%	44%	44%	43%	34%	33%
66 vjeç e sipër		61%	57%	45%	56%	48%	46%
Niveli i arsimit							
Me arsim deri 8/9-vjeçar		43%	41%	37%	39%	33%	33%
Me arsim të mesëm		45%	46%	49%	45%	39%	38%
Me arsim universitar		49%	48%	55%	48%	46%	44%
Statusi i punësimit							
I/E punësuar	Gjithsej	50%	49%	54%	48%	45%	44%
	Spektori publik	67%	66%	69%	64%	61%	60%
	Spektori privat	42%	41%	49%	42%	39%	37%
I/E papunë		34%	33%	37%	33%	30%	28%
Student		39%	39%	47%	41%	31%	32%
Pensionist		57%	54%	44%	52%	44%	43%
Niveli i të ardhurave							
Pa të ardhura		36%	36%	40%	35%	30%	29%
Deri në 30,000 lekë		48%	47%	46%	45%	39%	37%
30,001–50,000 lekë		51%	51%	55%	49%	47%	45%
50,001–70,000 lekë		54%	51%	58%	52%	51%	49%
Mbi 70,001 lekë		40%	40%	56%	48%	39%	33%
Vendbanimi							
Urban		46%	46%	50%	46%	41%	40%
Rural		45%	43%	44%	41%	38%	37%

Shënim: Ngjyrat përfaqësojnë rastet kur dallimet që vihen re mes treguesve demografikë janë të rëndësishme nga pikëpamja statistikore (testi Chi-Square, $p \leq 0.05$).

Shënim: Grupi "Arsim deri 9-vjeçar" përfshin të anketuarit pa arsim, me arsim fillor dhe ata që kanë mbaruar arsimin e detyruar (8/9-vjeçar).

4.8 PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT


Digjitalizimi i shërbimeve publike i bën këto shërbime më të lehta për t'u përdorur, më efikase dhe transparente për qytetarët, gjë që bën të bjerë niveli i korrupsionit dhe të rritet kënaqshmëria e qytetarëve me shërbimin e ofruar.¹⁷ Platforma e qeverisjes elektronike e-Albania, e krijuar në vitin 2012, ofron 1212 shërbime për individë dhe biznese.¹⁸ Në këtë pjesë të sondazhit, të anketuarit iu përgjigjën pyetjeve në lidhje me njohuritë dhe përdorimin e faqeve të internetit të bashkive dhe portalit e-Albania.

Faqja e internetit e bashkive

Në 2021, 59.7% e të anketuarve shprehën se bashkia e tyre kishte një faqe interneti (63.2% në 2020). 40.7% e tyre e kishin përdorur faqen e internetit të bashkisë së tyre (39.3% në 2020).

59.7% e të anketuarve ishin në dijeni se bashkia e tyre kishte një faqe interneti – përqindje më e vogël se në 2020 (63.2%), ndërkohë 38.6% thanë se nuk e dinin. Nuk u vunë re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve, ku femrat (60%) dhe meshkujt (59%) kanë të njëjtat gjasa që të jenë dijeni për ekzistencën e faqes së internetit të bashkisë së tyre. U vunë re dallime të rëndësishme sipas grupmoshës së të anketuarve, nivelit arsimor, statusit të punësimit, sektorit të punësimit, të ardhurave mujore të rregullta, nivelit arsimor, dhe aftësisë së kufizuar. Të anketuarit që kishin më shumë gjasa të dinin se bashkia e tyre kishte faqe interneti ishin të rinjtë të grupmoshës 26–35 vjeç (78%), studentët (76%), ata me arsim universitar (83%), të punësuarit (71%), veçanërisht ata në sektorin publik (80%), të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë/muaj (84%) dhe banorët nga zonat urbane (63%). Të anketuarit me aftësi të kufizuara (30%) ishin më pak të prirur të thonin se kishin dijeni që bashkia e tyre kishte faqe interneti.

Figura 51: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? 2021




Baza: N = 2500

17 Shihni raportin, Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (March 2018) Embracing Digitalisation: How to use ICT to strengthen Anti-Corruption, marrë nga: <https://www.giz.de/de/downloads/giz2018-eng ICT-to-strengthen-Anti-Corruption.pdf>

18 E-Albania. (n.d.). Statistika për dhjetor 2021. Marrë nga: <https://e-albania.al/Pages/Statistics/statistika.pdf>

Në periudhën 2019–2021, përqindja e të anketuarve që thanë se bashkia e tyre kishte faqe interneti e kaloi pragun prej 60% (63% në 2020), ku rezultati i vitit 2021 qëndroi 6 pp më lartë se ai i vitit 2019 (54%).

Figura 52: A e dini se bashkia juaj ka një faqe interneti? (2015–2021)



Baza: 2015 (N=1565), 2016 (N=1618), 2017 (N=1640), 2018 (N=1638), 2019 (N=2493), 2020 (N=2500), 2021 (N=2500).


Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Cilësia dhe arsyet e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë

Në vitin 2021, 40.7% e shqiptarëve të anketuar raportuan se e përdornin faqen e internetit të bashkisë së tyre dhe arsyeja kryesore e përdorimit ishte se “marr informacione për programet/aktivitetet në qytetin tim”. Të anketuarit më të rinj, ata me diplomë universitare apo pasuniversitare, të punësuarit, veçanërisht punonjësit e sektorit publik, të anketuarit me të ardhura të rregullta nga 50,001-70,000 lekë/muaj kishin më shumë gjasa të deklarorin se e përdornin faqen e bashkisë në krahasim me grupet e tjera.

Mes të anketuarve që kishin dijeni se bashkia e tyre kishte faqe interneti, më shumë se gjysma e tyre (59.3%) raportuan se nuk e kanë përdorur atë, ndërsa 40.7% e kanë përdorur faqen e internetit.

Figura 53: Përqindja e të anketuarve që përdorin faqen e internetit të bashkisë 2021



Baza: N=1493

Nuk u evidentuan dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë (femra 41% dhe meshkuj 40%), vendbanimit, aftësisë së kufizuar dhe përkatësisë në një pakice kombëtare. Dallime të tilla u evidentuan, gjithsesi, sipas grupmoshës, nivelit arsimor dhe statusit të punësimit. Të anketuarit 26-35 vjeç (44%), ata me diplomë universitare e pasuniversitare (46%), të punësuarit (45%) veçanërisht ata në sektorin publik (63%) dhe ata me të ardhura mujore të rregullta 50.001-70.000 lekë/muaj (50%) prireshin më shumë të deklaronin se e kishin përdorur faqen e internetit të bashkisë së tyre.

Në 2021, përqindja e të anketuarve (40.7%) që kishin përdorur faqen e internetit të bashkisë ishte pak më e madhe se në 2020 (39.3%).

Në Tabelën 26 tregohet se arsyeja kryesore për përdorimin e faqeve të bashkive nga përdoruesit ishte “marr informacione për programet/aktivitetet në qytetin tim” (48.2%), ndjekur nga “marr informacione për llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen ato” (45.2%), “ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve” (19.1%) dhe “marr informacion për buxhetin e bashkisë” (17.9%).

Tabela 26: Arsyeja e përdorimit të faqes së internetit të bashkisë 2021

	N	%
Marr informacion për buxhetin e bashkisë	109	17.9%
Ndjek vendimet e këshillit, lexoj procesverbalet e mbledhjeve	116	19.1%
Dërgoj ankesa, komente te një drejtori / staf bashkiak	77	12.7%
Marr informacion mbi llojet e shërbimeve që ofrohen dhe se si mund të aksesohen	275	45.2%
Marr informacion mbi programet / aktivitetet në qytetin tim	260	48.2%
Tjetër*	16	2.6%

* Si ato për të marrë informacione për një projekt shkolle, vende pune dhe/ose për të lexuar informacionet më të fundit.

E-qeverisja në Shqipëri


89.4% e të anketuarve në 2021 thanë se kishin dijeni se administrata shtetërore ofronte shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (93% në 2020). 80.1% e tyre konfirmuan se kishin marrë shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (74% në 2020). Një përqindje më e madhe e të anketuarve i vlerësuan shërbimet elektronike si funksionale, të lehta për t'u përdorur, dhe që u ofronin mundësi qytetarëve të shprehnin mendimet/sugjerimet e tyre, krahasuar me 2020.

Shumica dërrmuese e të anketuarve të këtij sondazhi (89.4%) raportuan se kishin dijeni se administrata shtetërore ofronte shërbime elektronike nëpërmjet portalit e-Albania (93% në 2020).

Nuk pati dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 89% dhe meshkuj 90%). Grupmoshat më të reja, veçanërisht të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç (97%); ata me diplomë universitare ose pasuniversitare (98%); të punësuarit (94%),

veçanërisht të punësuarit në sektorin publik (96%); ata me të ardhura individuale mbi 70 001 lekë/muaj (97%); dhe banorët e zonave urbane (91%) ishin më në dijeni për portalin e-Albania. Të anketuarit që raportuan se kishin aftësi të kufizuar (79%) kishin më pak gjasa se të anketuarit pa aftësi të kufizuara (90%) të kishin dijeni për portalin e-Albania. Po ashtu, të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (83%) ishin më pak të prirur të deklaronin se kishin dijeni për shërbimet e e-Albania në krahasim me ata që nuk i përkasin asnjë pakice kombëtare (90%).


Figura 54: Dijenia për portalin e-Albania 2021



Baza: N = 2495

Mes të anketuarve që ishin në dijeni të portalit e-Albania, 80.1% raportuan se kanë marrë shërbime elektronike nëpërmjet këtij portali në vitin 2021. Krahasuar me rezultatet e vitit 2020 (74%), përdorimi i shërbimeve elektronike nëpërmjet e-Albania është rritur me 5 pp.

Figura 55: A keni marrë ndonjë shërbim elektronik nëpërmjet portalit e-Albania? 2021




Baza: N = 2230

Kur shqyrtohen përgjigjet sipas treguesve demografikë, nuk vihen re dallime të rëndësishme nga pikëpamja statistikore sipas gjinisë së të anketuarve (femra 80% dhe meshkuj 80%), aftësisë së kufizuar apo vendbanimit. Dallime të tilla u evidentuan sipas grupmoshës së të anketuarve, nivelit të tyre arsimor, statusit të punësimit, dhe përkatësisë në një pakice kombëtare. Të anketuarit e grupmoshës 26-35 vjeç (89%); studentët (92%); ata me arsim universitar apo pasuniversitar (91%); të punësuarit (85%), veçanërisht punonjësit e sektorit publik (90%); dhe të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,001 ALL (97%) prireshin më shumë të deklarorin se kishin marrë shërbime nëpërmjet portalit. Të anketuarit që i përkasin një pakice kombëtare (69%) ishin më të pakët si përqindje që deklaruan se kishin marrë shërbime nëpërmjet portalit.

Të anketuarve të këtij sondazhi iu kërkua të vlerësonin shërbimet elektronike të ofruara duke përdorur këto kritere: funksionaliteti, lehtësia për t'u përdorur dhe mundësia për të dhënë mendime/sugjerime. Pothuajse nëntë në dhjetë të anketuar thanë se shërbimet elektronike të marra nga portali ishin funksionale (92.6%) dhe se kursejnë kohë (89.6%). Për sa i përket aksesit, më shumë se gjysma e të anketuarve (69%) thanë se shërbimet e ofruara nga portali e-Albania janë të thjeshta për t'u përdorur. Të dhënat tregojnë se 52.4% e të anketuarve ishin në dijeni se portali i ofron qytetarëve mundësinë për të dhënë mendime/sugjerime.

Figura 56: Cilësia e vlerësimit të shërbimeve elektronike nëpërmjet portalit e-Albania 2021



Baza: Funksionale (N=1765); e lehtë për t'u përdorur (N=1742); Mundësi për komente/sugjerime (N=1738); kursen kohë (N=1744).

Në 2021, përqindja e të anketuarve që e vlerësonin portalin e-Albania si funksional (93%) është rritur me 5 pp, krahasuar me 2020 (88%). Po ashtu, përqindja e të anketuarve që thonë se portali e-Albania të jep mundësinë për të bërë komente/sugjerime (52%) është rritur me 3 pp krahasuar me vitin e kaluar (49%).

Në 2021, të anketuarit që raportuan se kishin përdorur shërbime elektronike u pyetën nëse i kanë aksesuar ato vetë apo me ndihmën e të tjerëve. Të dhënat tregojnë se shumica e qytetarëve (70%) i kanë marrë vetë shërbimet elektronike, ndërsa 30% e kanë bërë këtë me ndihmën e të tjerëve.

4.9 PËRFSHIRJA GJINORE DHE SOCIALE

Pjesëmarrja e grave në politikë në Shqipëri është rritur ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit, kryesisht për shkak të kuotës gjinore të përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.¹⁹ Një tjetër faktor është se gratë në Shqipëri prirën më shumë të ndjekin studime universitare, në krahasim me burrat. Pavarësisht këtyre arritjeve, ato vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në vendimmarrje dhe pritshmëritë për to janë që ato të mbajnë barrën e kujdesit për fëmijët dhe për punët në shtëpi.²⁰ Në kapitullin për përfshirjen gjinore dhe sociale analizohen perceptimet e qytetarëve për dallimet gjinore për sa i përket aksesit të shërbimit publik dhe aftësinë për të mbajtur poste publike. Ashtu si në sondazhet e viteve të kaluara, të anketuarit u pyetën nëse ata janë trajtuar ndryshe nga institucionet/zyrtarët publikë për shkak të gjinisë, grupmoshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësive fizike apo për arsye të tjera. Të anketuarve iu kërkua të shprehin mendimin e tyre mbi tre pohime kryesore, për sa i përket konsideratave gjinore në qeverisje. Këto pohime janë analizuar në të gjithë këtë kapitull. Në përfundim, të anketuarve iu kërkua të shprehnin perceptimet e tyre në lidhje me rritjen e pjesëmarrjes së grave në këshillat bashkiakë dhe ndikimin e tyre në qeverisjen vendore.



Perceptimi për barazinë gjinore në shoqërinë shqiptare

60.6% e popullsisë së anketuar ishin dakord se në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave, një përqindje më e madhe se në 2020 (45%) dhe 2019 (54%). Meshkujt prireshin të ishin më shumë dakord krahasuar me femrat se ka barazi mes burrave dhe grave.

Pjesëmarrësit e këtij studimi u pyetën për të dhënë mendimin e tyre se sa ishin dakord me tre pohimet për barazinë gjinore në Shqipëri duke përdorur një shkallë prej 4 pikësh – nga 1 (plotësisht dakord) në 4 (aspak dakord).


Pohimi 1: “Në shoqërinë shqiptare ka barazi mes burrave dhe grave”

60.6% e të anketuarve raportuan se ishin ‘dakord’ ose ‘plotësisht dakord’ me këtë pohim. Në krahasim me gratë, burrat ishin më shumë të prirur për të rënë dakord me pohimin, me 63.5% e të anketuarve meshkuj krahasuar me 57.8% të femrave.



- 19 Instituti i Statistikave INSTAT. (2019). Burrat dhe gratë në Shqipëri 2019. fq. 55–57. Marrë nga adresa http://www.instat.gov.al/media/6413/burra-dhe-gra_2019.pdf
- 20 Dauti, M. dhe Zhllima, E. (2016). Perceptimet dhe Qëndrimet Publike ndaj Barazisë Gjinore në Shqipëri. Tiranë: UNDP https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/STUDIMI_PERCEPTIMET_SHQIP.pdf

Figura 57: Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare 2021




Baza: N=2493

Nga krahasimi demografik evidentohet se përgjigjet e të anketuarve nuk ndryshonin sipas grupmoshave, që do të thotë se të anketuarit e të gjitha moshave kishin prirje drejt të njëjtit perceptim për barazinë gjinore në Shqipëri. Dallimet ndërmjet nivelit arsimor të të anketuarve nxjerrin në pah se të anketuarit me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar kishin më pak gjasa (54%) të ishin të kënaqur me këtë pohim, krahasuar me ata me arsim të mesëm (64%) ose me arsim universitar (60%). Për sa i përket statusit të punësimit, të dhënat tregojnë se të anketuarit e punësuar (63%) prireshin më shumë të ishin dakord se ka barazi gjinore në shoqërinë shqiptare në krahasim me të papunët (53%).

61% e pjesëmarrësve në këtë sondazh ishin dakord se ka barazi mes burrave dhe grave – një përqindje më e lartë se në vitin 2020 (45%) dhe 2019 (54%). Në vitin 2021, krahasuar me rezultatet e vitit 2020, ka pasur një rritje me 19 pp mes të anketuarave femra (58% kundrejt 39%) dhe 14 pp mes të anketuarave meshkuj (64% kundrejt 50%) që deklarojnë se ka barazi mes meshkujve dhe femrave.

Figura 58: 'Barazia mes burrave dhe grave në shoqërinë shqiptare' (2016–2021)



Baza: 2016 (N=1636); 2017 (N=1623); 2018 (N=1636); 2019 (N=2487); 2020 (N=2497); 2021(N=2493).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.


Aksesi te shërbimet publike sipas gjinive

Rreth 75% e shqiptarëve besonin se burrat dhe gratë kanë të njëjtin akses te shërbimet publike. Edhe pse në perceptimet e burrave dhe grave nuk ka ndryshime të rëndësishme, qytetarët mbi 56 vjeç priren të mendojnë më shpesh se ka barazi gjinore në aksesin e shërbimeve publike në krahasim me grupmoshat më të reja.

Pohimi 2: “Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike”

74.8% e të anketuarve të këtij sondazhi thanë se ishin ‘dakord’ ose ‘plotësisht dakord’ me këtë pohim. Të anketuarit meshkuj dhe femra priren të mendojnë njësoj, përkatësisht me 75.8% dhe 73.8%. Për sa i përket dallimeve mes grupmoshave, të dhënat tregojnë se të anketuarit e grupmoshës 56–65 vjeç (79%) dhe 66 vjeç e sipër (82%) prireshin më shumë të besonin se burrat dhe gratë kanë akses të njëjtë në shërbimet publike krahasuar me grupmoshat e tjera. Nga ana tjetër, të anketuarit me arsimin 8/9-vjeçar (69%) dukej se ishin më pak dakord me pohimin e mësipërm krahasuar me të anketuarit me nivele të tjera arsimimi (arsim të mesëm 77% dhe arsim universitar 76%).

Figura 59: ‘Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike’ 2021




Baza: N=2494

Nga ana tjetër, të dhënat tregojnë se të anketuarit e papunë (66%) dhe ata pa të ardhura të rregullta mujore (68%) ishin më pak të prirur të ishin dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim. Të anketuarit që punojnë në sektorin privat (73%) ishin më të paktë në përqindje që u shprehën se ishin dakord me këtë pohim, krahasuar me të punësuarit në sektorin publik (84%).

Në vitet 2019-2021, përqindja e grave që janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim është rritur dukshëm. Në 2021, kjo shifër u rrit me 6 pp krahasuar me 2020, dhe me 8 pp krahasuar me

2019. Ndërkohë, përqindja e burrave që janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim vazhdoi të rritet (1 pp krahasuar me 2020), duke arritur një rritje kumulative prej 5 pp krahasuar me vitin 2019. Për më tepër, të dhënat tregojnë se hendeku gjinor është ngushtuar me 2 pp, më e vogla që nga sondazhi i vitit 2016. Shih Figurën 60 për shpërndarjen e të dhënave në vite.

Figura 60: ‘Në Shqipëri, burrat dhe gratë kanë akses të barabartë në shërbimet publike’ (2016–2021)



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1619); 2018 (N=1624); 2019 (N=2487); 2020 (N=2496); 2021(N=2494).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.



Ofrimi i shërbimeve publike


Shumica e shqiptarëve të anketuar (76.6%) besonin se nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.

Pohimi 3: “Në Shqipëri, nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave.”

76.6% e të anketuarve në këtë sondazh raportuan se janë ‘dakord’ ose ‘plotësisht dakord’ me këtë pohim – përqindje më e lartë se në 2020 (67.8%). Krahasimet demografike tregojnë se burrat dhe gratë janë njësoj dakord me pohimin (77.1% dhe 76.1% përkatësisht).

Për më tepër, të anketuarit e punësuar (78%) prireshin më shumë të ishin dakord me këtë pohim sesa të papunët (68%). Po ashtu, të anketuarit e punësuar në sektorin publik (87%) prireshin të ishin dakord se nëpunësit civilë respektojnë barazinë gjinore, në krahasim me të punësuarit e sektorit privat (74%). Të anketuarit me të ardhura të rregullta mujore 50,001 deri në 70,000 lekë (82%), dhe anëtarët e pakicave kombëtare (78%) prireshin më shumë të deklarorin se ishin dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim në krahasim me të anketuarit e tjerë. Gjithsesi, të anketuarit me aftësi të kufizuara (64%) ishin më pak të prirur të binin dakord me pohimin se ata që nuk kanë aftësi të kufizuara (78%).


Figura 61: 'Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave' 2021



Baza: N=2494

Në vitet 2019-2021, përqindja e burrave dhe grave që janë dakord ose plotësisht dakord me këtë pohim është rritur ndjeshëm. Në 2021, u rrit me 7 pp dhe 11 pp përkatësisht krahasuar me 2020, dhe me 6 pp dhe 12 pp krahasuar me 2019. Për më tepër, të dhënat tregojnë se hendeuku gjinor është ngushtuar me 1 pp, më e vogla që nga sondazhi i vitit 2016. *Shih Figurën 62 për shpërndarjen e të dhënave në vite.*

Figura 62: 'Nëpunësit civilë i shërbejnë me të njëjtin përkushtim dhe etikë grave dhe burrave' (2016–2021)



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1614); 2018 (N=1636); 2019 (N=2487); 2020 (N=2492); 2021 (N=2494).

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Diskriminimi nga institucionet apo nëpunësit publikë

Rreth 1 në 8 shqiptarë raportuan se janë trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik në 2019 për shkak të gjinisë, grupmoshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, statusit me aftësi të kufizuar, apo për diçka tjetër, pothuajse e njëjtë si në 2020 (12%) si dhe 2019 (13%). Nga ata që kishin vuajtur diskriminimin në vitin 2021, shumica ishin trajtuar ndryshe për shkak të moshës apo gjinisë së tyre.

Të anketuarit u pyetën nëse ishin trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar apo për diçka tjetër. Në total, 11.8% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se janë trajtuar ndryshe për shkak të gjinisë (3.7%), moshës (4.6%), përkatësisë etnike (1.3%), orientimit seksual (0.2%), aftësisë të kufizuar (1.2%), apo për arsye të tjera (0.8%). 88.2% e pjesëmarrësve të këtij studimi raportuan se nuk janë trajtuar ndryshe.

Tabela 27: Diskriminim nga institucioni 2021

Gjatë vitit 2021, a jeni trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës civil?	N	%
Nuk jam trajtuar ndryshe	2197	88.2%
Jam trajtuar ndryshe për shkak të*	294	11.8%
Gjinisë	92	3.7%
Moshës	115	4.6%
Përkatësisë etnike	33	1.3%
Orientimi seksual	5	0.2%
Aftësisë së kufizuar	30	1.2%
Tjetër**	19	0.8%

Baza: N = 2491

*Shuma totale e të anketuarve sipas gjinisë, moshës, etnisë, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar dhe të tjera.

**Tjetër: Për shembull, diskriminim për shkak të origjinës, gjendjes ekonomike, bindjeve politike.

Për diskriminimin gjinor, gratë (6%) raportuan më shumë se burrat (2%) se ishin përballur me diskriminim. Për më tepër, të anketuarit në grupmoshën 36-45 vjeç (6%), ata me arsim universitar (4%), të papunët (6%), të punësuarit në sektorin privat (5%), të anketuarit me të ardhura mujore mbi 70,001 ALL (6%) deklaruan më shpesh se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë, në krahasim me grupet e tjera demografike.

Për sa i përket diskriminimit për shkak të moshës, femrat (5%), ata të moshës 18-25 vjeç (11%), ata me arsim deri në nivelin 8/9-vjeçar (6%), studentët (12%), dhe punonjësit e sektorit privat (3%) raportuan më shpesh se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të moshës, krahasuar me grupet e tjera.


Në 2021, përqindja e të anketuarve që raportuan se ishin trajtuar ndryshe nga një institucion apo nëpunës publik për shkak të gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, orientimit seksual, aftësisë së kufizuar apo për diçka tjetër ishte e njëjtë si me vitin 2020 (12%) ashtu edhe me 2019 (13%).

Gratë në procesin e vendimmarrjes

81.8% shqiptarëve të anketuar ishin të mendimit se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik. Gratë, të rinjtë, ata të grupmoshës 18-25 vjeç dhe të anketuarit me arsim universitar dhe pasuniversitar ishin më të predispozuar të deklaronin se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik.

Të anketuarit u pyetën nëse mendonin se “se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik”. 81.8% e të anketuarve zgjodhën përgjigjen ‘Po’, ndërkohë, 9.9% zgjodhën përgjigjen ‘Jo’ dhe një përqindje më e vogël, 8.3%, thanë se ‘nuk e dinë’. Krahasuar me studimin e vitit 2020, përqindja e të anketuarve të këtij sondazhi që thanë se “se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik” vazhdoi me trendin e tij në rritje (+2 pp), duke kapur një rritje kumulative prej 5 pp krahasuar me 2019.

Figura 63: ‘Gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik’ (2016–2021)




Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1628); 2018 (N=1632); 2019 (N=2486); 2020 (N=2498); 2021 (N=2496)

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Të anketuarat femra (88%) prireshin më shumë të thonin se “se gratë janë po aq të afta sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik” krahasuar me meshkujt (75%).

Figura 64: ‘Dallimet gjinore në perceptimin se gratë janë po aq të afta sa edhe sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik’, 2021



Baza: N= 2496

Të anketuarit e grupmohës 18-25 vjeç (85%), me arsim universitar apo pasuniversitar (89%), studentët (86%), të punësuarit në sektorin publik (90%), dhe ata me të ardhura mujore mbi 70,001 lekë/muaj (92%) prireshin më shumë të mendonin se gratë janë po aq të afta sa edhe sa edhe burrat për të mbajtur çdo post publik.




Ndikimi i grave në qeverisjen vendore

Në 2021, 6 në 10 shqiptarë mendojnë se rritja e numrit të grave në këshillat bashkiakë do të ketë ndikim pozitiv në qeverisjen vendore, përqindje e ngjashme me atë të vitit 2020. Gratë, në krahasim me burrat, ishin dakord me këtë pohim.

Të anketuarit u pyetën nëse besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. 64.4% e pjesëmarrësve në studim ishin dakord me këtë pohim. Një përqindje më e vogël, 17.8% tha se kjo rritje nuk ka ndikim pozitiv dhe një përqindje e ngjashme (17.7%) u përgjigjën se nuk e dinin.

Në 2021, përqindja e të anketuarve që besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore vazhdoi të rritet (64% krahasuar me 62% raportuar në 2020) duke kapur edhe këtu një rritje kumulative prej 3 pp krahasuar me të dhënat e vitit 2019 (61%).

Figura 65: 'Ndikimi pozitiv i rritjes së përfaqësimit të grave në këshillat bashkiakë' (2016–2021)



Baza: 2016 (N=1635); 2017 (N=1631); 2018 (N=1633); 2019 (N=2486); 2020 (N=2498); 2021 (N=2494)

Shënim: Në 2019 metoda e kampionimit u ndryshua për të kaluar në kampion përfaqësues kombëtar.

Të anketuarit meshkuj (53%) ishin më pak të prirur të besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore krahasuar me të anketuarat femra (75%). Të anketuarit me arsim deri në nivel 8/9-vjeçar (59%), krahasuar me ata me arsim të mesëm (62%) dhe arsim universitar apo pasuniversitar (71%), ishin më pak të prirur të besonin se rritja e pranisë së grave në këshillat bashkiakë ka ndikim pozitiv në qeverisjen vendore. Të punësuarit e sektorit privat (63%) ishin më mosbesues sesa të punësuarit në sektorin publik (75%).

5. Shtojca 1: Karakteristikat e kampionit (2013–2021)

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Gjinia									
Meshkuj	45%	49%	50%	43%	51%	52%	49%	50.5%	50.6%
Femra	55%	50%	50%	57%	49%	48%	51%	49.4%	49.3%
Tjetër (shtuar në 2020)								<0.1% ²¹	0.1% ²²
Grupmosha									
18–25	14%	23%	22%	18%	19%	16%	19%	17.4%	15.2%
26–35	14%	22%	25%	23%	23%	23%	26%	26.7%	25.4%
36–45	14%	18%	16%	19%	19%	19%	20%	19.7%	21.9%
46–55	19%	18%	17%	18%	19%	20%	16%	16.6%	17%
56–65	20%	10%	11%	13%	11%	13%	12%	12.4%	12.5%
Mbi 66	18%	7%	8%	9%	9%	9%	7%	7.2%	8.1%
Vendbanimi									
Urban			81%	51%	50%	50%	70%	72.8%	70.7%
Rural			19%	49%	50%	50%	30%	27.2%	29.3%
Niveli arsimor									
Pa arsim ose/dhe me arsim fillor	1%	1%	3%	6%	5%	7%	4%	4%	4.1%
Me arsim 8/9-vjeçar	14%	15%	12%	19%	17%	23%	18%	18.3%	17%
Me arsim të mesëm	40%	41%	40%	50%	50%	46%	44%	41.9%	42.9%
Me arsim universitar apo pasuniversitar	44%	42%	43%	24%	28%	24%	33%	35.3%	35.8%
Statusi i punësimit									
I/E punësuar	40%	46%	45%	43%	46%	46%	54%	57.3%	56.8%
I/E papunë	20%	25%	28%	35%	34%	32%	25%	23.8%	20.6%

21 1 person u përgjigj 'Tjetër'.

22 2 persona u përgjigjën 'Tjetër'.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Student	8%	10%	9%	8%	7%	6%	7%	6.5%	7%
Pensionist	26%	9%	11%	12%	12%	12%	11%	10.9%	11.5%
Tjetër	3%	5%	7%	2%	1%	4%	3%	0.4%	3.2%
Sektori i punësimit									
Sektori publik				32%	29%	28%	25%	27.7%	27.7%
Sektori privat				64%	71%	69%	72%	70.4%	68.9%
Tjetër				4%		3%	3%	2%	3.4%
Të ardhurat e rregullta mujore individuale (Neto)									
Nuk kam të ardhura			34%	33%	37%	32%	29%	28.1%	24.7%
Deri në pagën minimale ²³			21%	25%	24%	28%	25%	19.0%	27.4%
Mbi pagën minimale –50,000 lekë			29%	28%	25%	28%	28%	31.6%	25.7%
50,001–70,000 lekë			6%	4%	5%	4%	7%	12%	13.9%
Mbi 70,001 lekë			2%	1%	2%	<1%	2%	2.5%	2.5%
A i përkisni ndonjë pakice kombëtare?									
Po					9%	7%	6%	4.4%	5.8%
Greke					3.2%	2.7%	1.5%	1.1%	1.4%
Maqedonase					1.6%	1.1%	0.9%	0.6%	0.8%
Arumune					<0.1%	0.2%	0.2%	<0.1%	0.1%
Rome					2.3%	2.4%	1.5%	1.1%	1.7%
Egjiptiane					0.9%	0.2%	0.9%	0.4%	0.8%
Malazeze					0%	0%	0.1%	0.1%	0.1%
Boshnjake					0.2%	<0.1%	0.2%	0.2%	0.1%
Serbe					0%	0%	<0.1%	<0.1%	0%
Bullgare					<0.1%	0.1%	0.3%	0.1%	<0.1%
Jo					90%	92%	93%	93.5%	92.8%



23 Deri në 24,000 lekë në 2015–2020, dhe deri në 30,000 lekë në 2021.

	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
A jeni simpatizant i ndonjë partie politike?									
Po					40%	36%	35%	33.6%	40.6%
PS					15.5%	16.1%	12.3%	11.9%	13.6%
PD					8.5%	9.2%	8.1%	8.4%	9.4%
LSI					3.4%	1.2%	2.1%	2.4%	2%
Tjetër					0.7%	0.4%	0.3%	0.3%	0.2%
Jo					52%	58%	60%	58.8%	54.2%
A jeni anëtar i ndonjë partie politike?									
Po					16%	12%	13%	10.4%	12.5%
PS					6.9%	6.6%	4.6%	4.1%	4.6%
PD					2.6%	3%	2.9%	1.9%	2.6%
LSI					2.2%	0.8%	0.9%	1.1%	0.8%
Tjetër					0.6%	<0.1%	0.2%	<0.1%	0.2%
Jo					75%	81%	82%	81.2%	81.6%



sondazh i opinionit publik

2021
BESIMI NË QEVERISJE